INTOSAI

Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik

XXI INCOSAI

Seria : botime KLSH - 04/2014/25

Janar 2014

Ndërkombëtare Revista e Auditimit të Jashtëm Publik

Seria : botime KLSH - 04/2014/25

Përktheu:

Fatos Çoçoli
Dëshira Huqi

Redaktoi:
Bujar Leskaj

Faqosja
Kozma Kondakçiu

ISBN : 978-9928-159-20-5

Shtypur “Mirgeeralb”

Janar 2014

Vol 41, No.1

Ndërkombëtare Revista e Auditimit të jashtëm Publik

Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik botohet 4 herë në vit, (Janar, Prill, Korrik dhe Tetor) në gjuhët Arabe, Angleze, Frënge, Gjermane dhe Spanjolle, në emër të INTOSAI-t (Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit). Revista, që është dhe organi kryesor i INTOSAI-t, i dedikohet zhvillimit të procedurave dhe teknikave të auditimit të qeverisë. Opinionet dhe mendimet e shprehura janë ato të botuesve apo kontribuesve individualë dhe jo domosdoshmërisht, reflektojnë pikëpamjet apo politikat e organizatës. Botuesit ftojnë për botimin e artikujve, raporteve të veçanta dhe lajmeve, të cilat duhet të dërgohen pranë:

Zyra e Shteteve të Bashkuara për Përgjegjshmërinë në Qeverisje GAO
Rr.441 G, NW, Dhoma 7814
Washington, D.C. 20548
U.S.A.
(tel: 202-512-4707; fax: 202-512-4021;
e-mail: intosaijournal@gao.gov)

Duke qenë se, kjo Revistë përdoret si një mjet mësimor, artikujt që pranohen më së shumti janë ato që trajtojnë aspekte pragmatike të auditimit të sektorit publik. Këto përfshijnë studime, ide mbi metodologjitë e reja në auditim, apo detaje mbi programet e trajnimit të auditimit. Artikujt që kanë të bëjnë kryesisht me teori, nuk janë të përshtatshëm.

Revista shpërndahet tek anëtarët e INTOSAI-t dhe palë të tjera të interesuara, pa pagesë. Është gjithashtu në format elektronik në http://www.intosaijournal.org ose http://www.intosai.org, si dhe duke kontaktuar Revistën në adresën: spel@gao.gov.

Artikujt në Revistë shënjohen me Indeksin e Kontabilistëve, botuar nga Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publikë të Çertifikuar dhe janë të përfshirë në Përmbajtjen e Menaxhimit.

Artikuj të veçantë përfshihen në abstraktet e botuara nga Shërbimet e Menaxhimit Anbar, Uembli, Angli, si dhe Universiteti Ndërkombëtar Microfilms, Ann Arbor, Miçigan, SH.B.A.

I nderuar lexues,

Ky botim, Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik, Janar 2014, volumi 41, Nr.1, vjen pranë jush si pjesë e kolanës së botimeve te KLSH-së, të cilat kanë arritur në 25 përgjatë viteve 2012, 2013 dhe gjysmës së parë të vitit 2014. Këto botime përfshijnë kryesisht botimin e Standarteve të ndryshme të fushës së Auditimit, midis të cilave mund të veçojmë "Udhëzues për Auditimin Financiar", "Udhëzues për Auditimin e Përputhshmërisë ", etj si edhe botime te tjera që lidhen me veprimtarinë e KLSH-së, Konferencat shkencore të realizuara në dy vitet e fundit dhe Revista shkencore "Auditimi Publik" (janë botuar deri tani shtatë numra të saj).

Në bazë të standardit ISSAI 20, Parimi 8 për komunikimin me publikun dhe në publik të informacionit dhe gjetjeve të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve), KLSH publikon këtë botim të numrit special të Revistës Ndërkombëtare të INTOSAI-t "Auditimi i Jashtëm Publik", (International Journal of Government Auditing), janar 2014. Ky edicion special i revistës, i kushtohet tërësisht punimeve dhe mesazheve qendrore të Kongresit INCOSAI XXI të tetorit 2013 në Pekin, Kinë. INCOSAI XXI konsiderohet një nga kongreset më të rëndësishëm të komunitetit të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, pas atij të Limës në 1977 dhe të Meksikos në vitin 2007, duke evidentuar edhe një herë rëndësinë e motos së INTOSAI-t, "Experentia Mutua Omnibus Prodest".

Me shpërthimin e krizës globale ekonomike dhe financiare të vitit 2009, roli i SAI-ve në shëndoshjen dhe qëndrueshmërinë e financave publike të vendeve të tyre mori përmasa të reja. Po ashtu, përgjegjësia e SAI-ve dhe pritshmëritë e qytetarëve ndaj kontributeve të tyre janë sot më të mëdha. Kongresi dhe Deklarata e Pekinit morën përsipër t'ju përgjigjen këtyre pritshmërive dhe mesazhi qendror i tyre është se, SAI-t me auditimet e tyre duhet të vihen në shërbim të qeverisjes kombëtare.

Botimi përfshin intervistat e Presidentit të ri të INTOSAI-t, Liu Jayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe ish-Presidentit të INTOSAI-t, z. Terrence Nombembe, Auditues i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, të përqëndruara në vlerat që shpalosin SAI-t dhe INTOSAI, si dhe në të ardhmen e rolit të tyre në raport me

qëndrueshmërine e financave publike të çdo vendi, me OKB-në, me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve, etj. Ai përmban Deklaratën e Pekinit, një nga dokumentet më të rëndësishëm të auditimit të jashtëm publik botëror, që përbën një orientim dhe program të plotë për çdo SAI modern sot, si dhe raportimet për aktivitetet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Përhershëm të INTOSAI-t, të grupeve të tij të punës, arritjeve të tyre dhe problematikave të hasura e sfidave për të ardhmen.

Numri Special i revistës së INTOSAI-t "Auditimi i Jashtëm Publik", janar 2014, vjen tani në formatin e tij në shqip, jo vetëm për komunitetin e audituesve publikë të Shqipërisë, por edhe për çdo qytetar që dëshiron të dijë më shumë për rolin dhe sfidat e sotme të institucioneve kushtetuese që japin garancinë e përdorimit të fondeve publike- institucioneve supreme të auditimit, SAI-ve. Qytetari pret sot më shumë përgjegjshmëri dhe angazhim nga institucionet publike, përballë pasojave të krizës ekonomike dhe financiare botërore. SAI-t dhe organizata e tyre botërore INTOSAI, janë të gatshme të përballen me këtë pritshmëri dhe sfidë dhe ky botim i sjellë në vëmendje të lexuesit shqiptar nga KLSH, e dokumenton më së miri këtë.

Bujar LESKAJ

Përmbajtja

- Editorial……. 9
- INCOSAI XXI, një shikim i shpejtë……. 25
- Mbi Bordin e 64 Drejtues……. 31
- Lista e ISSAI-ve, INTOSAI GOV's dhe Dokumentet zyrtare të miratuara nga INCOSAI XXI……. 33
- Organigrama Organizative e INTOSAI-t……. 35
- INCOSAI në Foto……. 37
- AlSAI në INCOSAI në Foto……. 41
- Sesioni i Parë Plenar i Përgjithshëm: Fokusi në Qeverisjen e Mirë……. 45
- Sesioni i Dytë Plenar i Përgjithshëm: INCOSAI XXI, Temat e Kongresit……. 49
- Sesioni i Tretë Plenar i Përgjithshëm: Miratimi i Deklaratës së Pekinit……. 53
- Fituesi i çmimit Elmer Staats 2013……. 57
- Fjalimi i pranimit të Çmimit të 11, Elmer Staats ……. 59
- Raporti mbi Qëllimin 1: Përgjegjshmëria dhe Standartet Profesionale……. 61
- Raporti mbi Qëllimin 2: Ngritja e Kapaciteteve Institucionale……. 81
- Raporti mbi Qëllimin 3: Shkëmbimi i Njohurive……. 93
- Raporti mbi Qëllimin 4: Komiteti i Financave dhe Administrimit……. 117
- Deklarata e Pekinit……. 126
- Ftesë për në INCOSAI XXII……. 141
- Mbi Bordin e 65 Drejtues……. 143



INTOSAI SOT DHE NESËR

Katër pyetje për INTOSAI-n e së shkuarës dhe të së ardhmes,
Krvetarëve të Bordit Dreitues te INTOSAI-t

Në Kongresin e XXI të INCOSAI-t, Tetor 2013, drejtuesi në ikje Terence Nombembe në të djathtë, Audituesi i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, i dorëzon simbolin që përfaqëson kryesinë e Bordit Drejtues të INTOSAI-t, z.Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës

Editorial

Pyetja 1: Cilat janë sipas mendimit tuaj sfidat më të mëdha dhe mundësitë që hasin SAI-t në ditët e sotme?

Liu Jayi: Qeverisja e mirë kombëtare dhe siguria janë aspiratat e përbashkëta të njerëzve në të gjithë botën dhe këtë mision e ndajnë të gjitha SAI-t.

Liu Jiayi,
Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe Kryetari aktual i Bordit Drejtues të INTOSAI-t

Në ditët e sotme, me zhvillimin global të ekonomisë, çështjet globale ndryshimet klimaterike, energjia dhe burimet e sigurisë, siguria ekonomike, siguria mjedisore,

siguria ushqimore, ndershmëria dhe eficienca e qeverive, si dhe përpjekjet anti-korrupsion – janë bërë më akute, duke vendosur kërkesa më të mëdha për t'u përballuar dhe sfida të reja për SAI-t. Sfida më e madhe nga të gjitha, besoj se është promovimi dhe shërbimi ndaj qeverisjes së mirë kombëtare.

Së pari, duke qenë se në këtë periudhë të re zhvillimesh pretendohet një rol më i madh dhe i rëndësishëm në qeverisjen e mirë, kërkohet gjithashtu edhe zgjerimi i vazhdueshëm i funksioneve të auditimit kombëtar.

Si një forcë jetësore në ruajtjen e demokracisë dhe shtetit ligjor, auditimi kombëtar luan një rol thelbësor në rritjen e eficiencës qeverisëse, zhvillimit të një administrate me integritet, mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe përmirësimit të jetës së njerëzve.

Megjithatë, institucionet e auditimit janë aktualisht të detyruara të kufizojnë idetë e tyre udhëzuese, metodat dhe impaktet, për të përmbushur plotësisht nevojat e një qeverisjeje të mirë kombëtare.

Së dyti, kjo periudhë e re transformimi kërkon të zgjerohet qëllimi i auditimit. Në kontekstin e një bote nën krizën financiare, vendet janë duke kërkuar dhe synuar mënyra të reja zhvillimi. Situatat që ndryshojnë, masat dhe kërkesat, bëjnë që nga SAI-t të kërkohet të ruajnë hapin me kohën. Do të ishte normale për SAI-t që vazhdimisht të përfshiheshin në sfida të reja, të bënin ndryshime dhe të ndërmerrnin masa proaktive për ta çuar përpara qeverisjen e mirë kombëtare.

Së treti, kjo përpjekje e re nxit zhvillimin e teorive kombëtare të auditimit. Kërkimet mbi teoritë e auditimit kombëtar që promovojnë dhe i shërbejnë qeverisjes kombëtare duhet të thellohen, pasi nuk ka eksperienca të mjaftueshme nga të cilat të mund të nxjerrësh mësime.

Praktikisht, teoritë mbi auditimin kanë nevojë të pasurohen duke eksploruar mekanizmat e tij, përmbajtjen themelore, rrugën e realizimit dhe metodat për vlerësimin.

Mundësitë ecin gjithnjë bashkarisht me sfidat.

Për t'i drejtuar sfidat e përmendura më lart, nevojitet të ndërmerren metoda innovative në punën tonë audituese dhe të krijohet mjedisi i duhur për zhvillimin ekonomik, i cili, nga ana e tij, do të ofronte mundësi të reja për SAI-t për të luajtur një rol më të dukshëm në promovimin e interesave të tyre kombëtare. SAI-t mund të ndihmojnë që qeveritë të bëhen më të përgjegjshme në përdorimin e burimeve publike duke zbuluar shkeljet dhe praktikat e këqija dhe duke promovuar përgjegjshmërinë dhe transparencën. SAI-t mund të bëjnë të mundur shpërndarjen e rregullt dhe përdorimin e burimeve publike duke kryer auditime në fushat përkatëse.

Në përballjen me deficitet financiare dhe krizat e borxheve publikë, SAI-t mund të fokusohen në faktorët e përgjithshëm apo ata sistemikë që ndikojnë me ashpërsi në zbatimin e politikave dhe qëndrueshmërinë financiare afat-gjatë, kontribuojnë në krijimin e politikave të shëndosha financiare publike dhe monetare.

Lidhur me ndryshimet klimaterike, energjinë dhe çështjet lidhur me sigurinë e burimeve, dhe krizat mjedisore, SAI-t mund të japin informacione objektive, të zbulojnë problemet ekzistuese dhe të japin rekomandime për përmirësime.

Roli dhe pozicioni i rëndësishëm i auditimit kombëtar në promovimin dhe përmirësimin e mirë qeverisjes kombëtare, shpalosen më mirë në shpërndarjen dhe zgjidhjen efektive të krizave të ndryshme.

Aktualisht dhe në të ardhmen, SAI-t duhet – në përputhje me konceptin e "auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare" – të përfitojnë nga kjo mundësi, të përmbushin përgjegjësitë e tyre audituese me seriozitet dhe të intensifikojnë ngritjen e kapaciteteve.

Kjo do të mundësojë për SAI-t që të luajnë një rol më të madh në promovimin e qëndrueshmërisë afat-gjatë apo politikave financiare, përmirësimin e qeverisjes kombëtare, pjesëmarrjen aktive në qeverisjen globale dhe realizimin, në veçanti, të Qëllimeve për Zhvillim të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara.

Terrence Nombembe,
Auditues i Përgjithshëmi Afrikës së Jugut
dhe ish-Kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t

Terrence Nombembe: Besoj se ka më shumë mundësi sesa sfida me të cilat përballen sot SAI-t.

Një prej mundësive primare për SAI-t është të ngrihen mbi hapat e bërë tashmë në konsolidimin e bashkëpunimit brenda INTOSAI-t – si ndërmjet strukturave të ndryshme ashtu edhe ndërmjet SAI-ve – gjithashtu edhe me organizatat partnere dhe palët e interesit kryesore.

Ne duhet ta mbështesim këtë moment duke vazhduar në bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve individuale dhe INTOSAI-t, si dhe ndërmjet rajoneve të INTOSAI-t, duke përdorur forcat tona të ndryshme dhe duke shkëmbyer inovacionet përkatëse në përfitim të të gjithëve.

Ndërsa SAI-ve më të fuqishëm u del për detyrë të mbështesin ata më të dobtit, SAI-t më pak të privilegjuar, duhet të kuptojnë se edhe ata gjithashtu, mund ta mbështesin shumë mirë njëri-tjetrin duke shkëmbyer njohuritë.

SAI-t gjithashtu kanë mundësinë të vazhdojnë t'i përgjigjen nevojës së madhe të njerëzimit për vërtetësi, ndershmëri dhe integritet.

Duke e shfaqur gjithnjë e në rritje impaktin tonë si zë i besueshëm i arsyes, audituesit publikë do të rrisin transparencën dhe sigurojnë përgjegjshmërinë si dhe do të ndihmojnë qeveritë të përmirësojnë performancën, luftën kundër korrupsionit, të promovojnë besimin publik dhe të mbrojnë interesat e qytetarëve të cilëve u shërbejnë.

ISSAI-t ofrojnë një kuadër standartesh botërore dhe sigurojnë besueshmërinë në punën tonë.

Këto ISSAI kompletohen edhe me planin strategjik të INTOSAI-t si dhe me shumë udhëzues që u mundësojnë SAI-ve t'u përgjigjen me besim sfidave që has sektori publik.

Ndërkohë që ne përpiqemi për ekselencë në çdo aspekt të punës tonë, secili SAI, si pjesë të profesionalizimit të tij, duhet të përfitojë nga mundësia që i jepet nga kuadri i ISSAI-ve dhe me shpejtësi duhet t'i zbatojë këto standarte.

SAI-t duhet gjithashtu të vazhdojnë me trajnimet për të ruajtur superioritetin e tyre në mjedisin e auditimit të sektorit publik.

Këto trajnime do të pajisin stafin e SAI-ve me pushtetin e mendimit dhe analizës së pavarur, si dhe aftësinë për të krijuar rrugën drejt auditimit ekselent për të gjitha rajonet e INTOSAI-t.

Pyetja 2:Si mundet t'i përgjigjet më mirë INTOSAI ndryshimeve globale si një zë i pavarur dhe çfarë roli besoni se duhet të luajë kjo Organizatë?

Liu Jiayi: INTOSAI duhet të përballet me impaktet e globalizmit në SAI-t, të identifikojë pritshmëritë e grupeve të interesit dhe të vlerësojë dhe shpërndajë sfida të shumta.

Në respektimin e SAI-ve në arenën ndërkombëtare, INTOSAI duhet të marrë parasysh që të ofrojë një zë të bashkuar në çështjet ndërkombëtare ndër-kufitare, duke vendosur kështu plotësisht në lojë, rolin e tij si një pjesë të rëndësishme të përgjegjshmërisë të sektorit publik dhe sistemit të qeverisjes globale.

INTOSAI duhet të bëjë sa vijon:

■ Të marrë pjesë në zbatimin e legjislacionit të qeverisjes globale

INTOSAI mund të thellojë marrëdhëniet e tij në disa forume (si të qenit anëtar, pjesëmarrës në konferenca, vëzhgues, këshillues, apo aktiv në organizim) me

organizatat ndërkombëtare, forumet, institutet e kërkimit dhe fondacionet (si Kombet e Bashkuara dhe agjensitë e tyre, Banka Botërore, G20, dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, apo OECD), si dhe organizatat rajonale (si Unioni Afrikan, Shoqata e Kombeve jug-lindore Aziatike, Banka Aziatike për Zhvillim dhe Banka Afrikane për Zhvillim).

Kjo do të mundësojë që INTOSAI të ushtrojë plotësisht influencat e veta në rregull bërjen ndërkombëtare; të promovojë përmirësimin e rregullave ekonomike ndërkombëtare, duke përfshirë standartet rregullatore ndërkombëtare financiare; të promovojë ISSAI-t dhe të përmirësojë më tej standartet e auditimit dhe kontabilitietit globale në sektorin publik; dhe të përcaktojë një sistem vlerësimi të progresit social bazuar në treguesit kyç kombëtarë.

- Të marrë pjesë në praktikat globale të qeverisjes

INTOSAI duhet t'i nxisë SAI-t:

- të marrin pjesë në praktikat e qeverisjes si në vlerësimin e progresit social, çështjet globale dhe rajonale dhe promovimin ndërkombëtar të bashkëpunimit socio-ekonomik;

- të marrin pjesë në aktivitete të organizatave multilaterale si Kombet e Bashkuara dhe Samiti Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm; dhe

- të vendosë një grup pune mbi promovimin e qeverisjes së mirë globale që synon të kërkojë çështje praktike për SAI-t dhe organizatat përkatëse që marrin pjesë në qeverisje globalisht në mënyrë që INTOSAI të luajë kështu një rol në forcimin e disiplinës financiare, zbulimit të risqeve ekonomike në kohën e duhur dhe luftës ndaj korrupsionit.

- Të ofrojë shërbime auditimi të pavarura për organizatat ndërkombëtare dhe mbi-kombëtare dhe të fillojë auditime ndërkombëtare të koordinuara në fusha të ndryshme. INTOSAI duhet të studiojë më tej auditimet e pavarura të jashtme të

organizatave ndërkombëtare (si atyre rajonale dhe instituteve të ngjashme që pranojnë kontribute financiare të anëtarëve).

Mund të merret si pikë reference metoda e auditimit të jashtëm e Bordit të Audituesve të Kombeve të Bashkuara dhe Panelit të Audituesve të Jashtëm të Kombeve të Bashkuara për të studjuar marrëveshjet që i lejojnë SAI-t të punojnë si auditues të jashtëm të pavarur të organizatave ndërkombëtare; të mobilizojnë organizatat ndërkombëtare të pranojnë propozimet që drejtuesit e SAI-ve anëtare të INTOSAI-t të emërohen si auditues të tyre të jashtëm, dhe të njohin ISSAI-t si standartet e tyre të auditimit.

Terrence Nombembe: Ngritja e Komisionit Drejtues të Mbikqyrjes mbi Çështjet që Emergjente është një tregues i qartë i qëllimit të INTOSAI-t për të zgjeruar rolin e tij me vlerë të shtuar në arenën globale.

Një falenderim shkon për qëllimin e INTOSAI-t për të influencuar pozitivisht dhe në mënyrë proaktive drejtimin e trendit global dhe të avancimit të një pozite ku metodat e sektorit publik global, mund të ndahen me grupet e interesit të sektorit publik për të rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe qeverisjen e mirë.

Përpjekjet e INTOSAI-t, s'mund të jenë veçse të suksesshme, pavarësisht faktit nëse ne përpiqemi të marrim pjesë në forume globale me influencë dhe në diskutimet e tyre kryesore. INTOSAI është një organizatë shumë e respektueshme, e mbushur me njerëz të cilët kanë aftësi teknike tepër të zhvilluara dhe eksperinca të mëdha.

Në mënyrë që INTOSAI t'u përgjigjet sfidave dhe ndryshimeve globale, duhet që drejtuesit e tij të jenë të pranishëm në platforma globale të identifikuara me kujdes për të pasur një impakt maksimal.

Edhe pse është relativisht e lehtë për INTOSAI-n të monitorojë zhvillimet kyçe globale, INTOSAI duhet të bëjë të mundur që të ndikojë në këto zhvillime, duke

angazhuar forume të identifikuara si të rëndësishme në drejtimin e trendeve globale.

Ne kemi mundësinë të konsolidojmë rrjetet tona ekzistuese, të cilat kanë provuar historikisht se janë tepër të vlefshme në drejtimin e trendeve globale. Në këtë kontekst, unë po i referohem atyre organeve si Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve, Instituti për Audituesit e Brendshëm, Kombet e Bashkuara, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, dhe donatorët tanë kryesorë, me të cilët kemi vendosur tashmë një nivel të lartë besueshmërie dhe autoriteti në çështjet e vendosjes së standarteve ashtu si edhe të zbatimit të kuadrit të standarteve.

Duke ruajtur të njëjtën linjë me Simpoziumin e 22-të të Kombeve të Bashkuara/INTOSAI, që njohu dhe ngriti lart rolin e SAI-ve si këshilltarë të besueshëm, INTOSAI mund të shtrijë më tej këtë rol, në territoret specifike të SAI-ve, në forume ku ata të cilët ne këshillojmë, mund të takohen me partnerët e tyre global dhe të influencojnë ngjarjet dhe trended botërore.

Këto forume përfshijnë G8, G20, dhe BRICS; Forumi Ekonomik Botëror; forumet e nivelit të lartë për zhvillim; dhe forumet kryesore rajonalë.

Unë e vlerësoj mjaft që INTOSAI ka përparuar deri më tani duke ngritur Komisionin Drejtues të Mbikqyrjes mbi Çështjet Emergjente. Është e rëndësishme që ky komision është ngritur në nivelin e duhur të autoritetit duke u drejtuar nga Presidenti i INTOSAI-t.

Nuk kam asnjë dyshim se për tre vitet në vijim, z.Liu Jiayi dhe Komisioni i Mbikqyrjes, të mbështetur edhe nga drejtues rajonalë në INTOSAI, do të tregojnë maturi në drejtimin e tyre, takt dhe influencë strategjike, do t'i përgjigjen sfidave si një zë i pavarur i arsyes në nivelet globale të qeverisjes.

Pyetja 3:Sipas këndvështrimit tuaj, sa ka përparuar INTOSAI në:

(a) promovimin e pavarësisë së SAI-ve dhe (b) nxitjen e bashkëpunimit me ata partnerë të ngarkuar me qeverisje?

Liu Jiayi: Si një organizatë strehë për SAI-t, ashtu edhe si një qendër kryesore e një platforme vendim-marrjeje për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin teknik dhe trajnimin dhe seminaret në fushën e auditimit kombëtar, në mbarë botën, INTOSAI luan një rol pozitiv si për promovimin e pavarësisë së SAI-ve ashtu edhe për nxitjen e bashkëpunimit me ata partnerë të ngarkuar me përgjegjësinë e qeverisjes së mirë.

INTOSAI ka ndërmarrë masat që vijojnë për të promovuar pavarësinë e SAI-ve:

- **Së pari,** parimet e pavarësisë janë sqaruar duke miratuar Deklaratat e Limës dhe Meksikos, si dhe Pekinit, dhe duke lehtësuar miratimin e Rezolutës A/66/209 "Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke forcuar SAI-t", në Asamblenë e Përgjithshme të 66-të të Kombeve të Bashkuara.

- **Së dyti,** duke shpëndarë dokumentet e lartpërmendura dhe parimet e pavarësisë së auditimit në konferenca ndërkombëtare të ndryshme, forume dhe simpoziume, INTOSAI ka nxitur legjislacionet kombëtare dhe administratat të sigurojnë aplikimin e e parimeve të pavarësisë, si dhe ka vendosur një themel të fortë për përmirësimin e pozitave të SAI-ve në vendet e tyre respektive.

- **Se treti**, INTOSAI, në përputhje e udhëzuesit e tij të komunikimit dhe nëpërmjet koordinimit dhe mekanizmave të komunikimit, ka nxitur dhe promovuar SAI-t të shpërndajnë ndërveprimin e tyre dhe bashkëpunimin me partnerët e ngarkuar me përgjegjësi qeverisëse ndërsa ka siguruar pavarësinë e tyre. Praktikisht, janë ndërmarrë veprimet si vijon:

- INTOSAI i kushton rëndësi të madhe ngritjes së kapaciteteve për SAI-t dhe ka botuar Standartet Ndkërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe Udhëzuesit e INTOSAI-t për Qeverisjen e Mirë, të cilët ofrojnë për SAI-t një koleksion të standarteve ndërkombëtarisht të pranueshme dhe udhëzues mbi auditimin financiar, të përputhshmërisë, të performancës, të mashtrimit, të mjedisit, të IT dhe qeverisjes së brendshme, si dhe ndihmojnë të

shkëmbehen praktikat më të mira dhe konceptet për të rritur cilësinë e auditimit dhe rezultatet.

- INTOSAI vlerëson shkëmbimin e njohurive nëpërmjet aktiviteteve, seminareve dhe trajnimeve si dhe ofron tematika të ndryshme nëpërmjet Komisionit Drejtues të Mbikqyrjes mbi Çështjet që Ndeshen. Këto strategji kanë bërë të mundur për SAI-t që të përshtaten më mirë me ndryshimet e jashtme dhe zhvillimet ashtu si edhe me kërkesat në rritje të grupeve të interesit, si dhe të bashkëpunojnë me më shumë kompetencë me qytetarët dhe organet legjislative e ekzekutive.

- INTOSAI promovon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet anëtarëve të tij duke përdorur më së miri komisionet e INTOSAI-t, grupet e punës, nën-komitetet, dhe grupet projektuese.

INTOSAI, së bashku me organizata të rëndësishme ndërkombëtare, merr pjesë në qeverisjen globale duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve dhe partnerëve të jashtëm, përfshi këtu edhe Kombet e Bashkuara, Bankën Botërore, OECD, Unionin Ndër-parlamentar, IFAC dhe Institutin e Audituesve të Brendshëm. INTOSAI gjithashtu merr pjesë në Grupin e Rishikimit të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, i cili qeveris dhe mbikqyr marrëveshjet për vendosjen e IPSAS dhe deklaratave të tjera, duke marrë pjesë në zhvillimin e Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, ISA nga IFAC.

Terrence Nombembe: (a) Miratimi i Rezolutës së Kombeve të Bashkuara A/66/209 ishte një arritje e rëndësishme në historinë e INTOSAI-t dhe sektorit publik global. Pavarësia e SAI-ve bën të mundur që një SAI të përshtatet me çdo situatë dhe të aplikojë këtë privilegj të lartë dhe të pushtetshëm për t'i treguar shoqërisë rëndësinë tonë dhe përfitimet.

Në disa raste, unë kam shprehur besimin tim se SAI-t mund të rriten për t'u bërë zëri më i fuqishëm i arsyes në vendet tona përkatëse dhe në sektorin publik

global, dhënë fakti se asnjëherë nuk duhet të vetë-kënaqemi lidhur me parimet kryesore dhe vlerat e Deklaratave të Limës dhe Meksikos.

Megjithatë, mbetet shumë për të bërë për të siguruar që të gjithë SAI-t të arrijnë pavarësi të plotë. Për këtë qëllim, INTOSAI – veçanërisht strukturat e tij rajonale – do të vazhdojnë të përdorin çdo platformë të mundshme për të promovuar doktrinën e pavarësisë. Unë besoj se, megjithëkëtë, SAI të veçantë duhet të bëjnë më shumë për të mbështetur dhe inkurajuar njëri-tjetrin në luftën për të përmbushur me sukses rrugëtimin e tyre drejt pavarësisë së plotë.

(b) Në lidhje me nxitjen e bashkëpunimit me partnerët e ngarkuar me qeverisje, INTOSAI nëpërmjet miratimit të ISSAI-t 12 në Pekin, ka njohur vlerën e komunikimit të vazhdueshëm dhe të strukturuar në angazhimin me grupet e interesit.

Ky ISSAI nxit SAI-t, të ngrejnë bashkëpunime që do të mundësojnë për të ngarkuarit me qeverisjen e sektorit publik të shpërndajnë përgjegjësitë e tyre në përgjigje të gjetjeve të auditimeve dhe rekomandimeve, të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese në mënyrë që të forcohet shërbimi ndaj qytetarëve dhe të ngrenë besimin e publikut.

SAI-t duhet të përdorin privilegjin e tyre të të angazhuarit me qeveritë e vendeve të tyre për të krijuar kushtet që prodhojnë vazhdimisht informacione të besueshme lidhur me përdorimin e fondeve publike, shërbimin ndaj qytetarëve dhe respektin për shtetin e së drejtës në menaxhimin e burimeve shtetërore.

Në mënyrë që SAI-t të arrijnë përfitimin maksimal nga ky patneritet, ne duhet të kemi procese të vazhdueshme, sistematike dhe të strukturuara nëpërmjet të cilave të mund të ngremë reputacionin si institucione reaguese, ndërkohë që zhvillohet marrëdhënia profesionale me komisionet përkatëse legjislative mbikqyrëse, autoritetet ekzekutive dhe drejtuesit e subjekteve të audituara. Standartet e auditimit përcaktojnë qartë kushtet dhe ndërhyrjet që ne duhet të ndërmarrim në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie e suksesshme me të ngarkuarit me qeverisjen.

Kjo do të kërkojë vendosmëri, qëndrueshmëri dhe modesti nga ana jonë si SAI, por është një rrugëtim që ia vlen, duke qenë se është në interesin tonë dhe më tej, në interesin e atyre të cilëve ne u shërbejmë – qytetarëve.

Pyetja 4:Deklarata e Pekinit ishte një arritje shumë e madhe për INTOSAI-n. Çfarë duhet të bëjnë SAI-t lidhur me zbatimin e kësaj Deklarate?

Liu Jiayi: Si një tjetër dokument shumë i rëndësishëm që "përmbledh historinë, përmbush sfidat dhe ndërton konsensus", pas Deklaratave të Limës dhe Meksikos, Deklarat e Pekinit mbi Promovimin e Qeverisjes së Mirë nga SAI-t, besoj se do të jetë me influencë të thellë dhe të gjatë në sigurimin e pavarësisë mga SAI-t dhe rolet që luajnë SAI-t në promovimin e qeverisjes së mirë kombëtare, mbrojtjes së qëndrueshmërisë afat-gjatë të politikave financiare dhe sigurimit të qeverisjes së mirë, globalish.

Së pari, Deklarata e Pekinit përfshin arritjet e mëdha dhe eksperiencat e arritura nga INTOSAI që prej themelimit të tij zyrtar 60 vjet më parë dhe ri-konfirmon parimet udhëzuese të përfshira në Deklaratat e Limës dhe Meksikos si dhe Rezolutën e Kombeve të Bashkuara A/66/209, veçanërisht rregullat bazë për auditimin kombëtar dhe parimin e pavarësisë.

E vlefshme për të gjithë SAI-t individualë, ajo bën thirrje për zbatimin e këtyre parimeve nga secili legjislacion dhe organ qeverisës.

Së dyti, Deklarata e Pekinit, identifikon promovimin e qeverisjes së mirë kombëtare dhe asaj globale si qëllim i përbashkët i të gjithë SAI-ve si dhe zhvillon mandatet e SAI-ve në një perspektivë të orientuar drejt së ardhmes.

Në përputhje me Deklaratën e Pekinit, si një pjesë e rëndësishme e qeverisjes kombëtare, SAI-t duhet të propozojnë rekomandime konstruktive tek vendim-marrësit në mbështetje të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, të rrisin eficiencën e qeverisë, të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin, të garantojnë sigurinë kombëtare, të promovojnë mundësitë për njerëzit, të forcojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë, si dhe t'i ndërtojnë modelin e SAI-ve si organizata të besueshme, të ndershme dhe me integritet.

Deklarata e Pekinit bën thirrje për SAI-t individual të pranojnë përgjegjësitë e përbashkëta, t'u rezistojnë risqeve të zakonshme, të ndërmarrin veprime të përbashkëta, dhe të flasin me një zë të vetëm.

Duke rritur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe duke luajtur një rol jetësor në gjetjen e zgjidhjeve për sfidat më të mëdha që hasen sot – si krizat lidhur me borxhin, ekologjinë, sigurinë globale financiare dhe anti-korrupsionin – ne mund të inkurajojmë qeveritë individuale të përmbushin detyrimet e tyre nëpërmjet auditimit të atyre zonave si angazhimin në ndryshimet klimaterike, eliminimi i pengesave tregtare, sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe nxitja e përpjekjeve kundër pastrimit të parave. SAI-t gjithashtu mund të promovojnë përgjegjshmërinë, transparencën dhe performancë më të mirë në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i mbarë i ekonomisë botërore.

Ky qëllim mund të arrihet duke marrë pjesë në aktivitetet e qeverisjes si vlerësimi i progresit shoqëror, duke kryer auditime të jashtme të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe duke kontribuar në plotësimin e detyrave të përcaktuara në Deklaratën e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara – duke u konsultuar me organe multilaterale si Kombet e Bashkuara, Banka Botërore, G20, dhë OECD, si dhe duke u angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes globale.

Së treti, e përballur me krizat ekonomike dhe financiare botërore në fillim të shekullit të 21, Deklarata e Pekinit bën thirrje për të gjithë SAI-t, në linjë edhe me kushtet e tyre kombëtare dhe mandatet ligjore, të kryejnë auditime të pavarura dhe strikte të deklaratave të llogarive të qeverisë dhe borxhit publik për të ruajtur qëndrueshmërinë afat-gjatë dhe afat-mesme të politikave financiare, të sigurojë interesin publik dhe të promovojë zhvillimin social dhe ekonomik.

Deklarata e Pekinit gjithashtu bën thirrje për të gjithë SAI-t të përmirësojnë mandatet e tyre për të kryer auditime mbi qëndrueshmërinë e politikave financiare.

Së fundi, Deklarata e Pekinit, bën thirrje për të gjithë SAI-t anëtare, që në përputhje me Planin Strategjik të INTOSAI-t, të rrisin ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive, të aplikojnë dhe vëzhgojnë ISSAI-t dhe bazuar në sa më lart, të ruajnë pavarësinë dhe përmirësojnë performancën për të ngritur INTOSAI-n në një organizatë model.

Kongresi i XXI i INTOSAI-t, miratoi si tematikë pune për 2014 "zbatimin e Deklaratës së Pekinit, veçanërisht të Rezolutës së Asamblesë së Kombeve të Bashkuara A/66/209 mbi forcimin e pavarësisë së SAI-ve dhe kuadrit të ISSAI-ve për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të financave publike".

Kjo, ka theksuar edhe më shumë, rëndësinë e Deklaratës së Pekinit.

Terrence Nombembe: Deklarata e Pekinit konfirmon se tashmë INTOSAI ka përvetësuar plotësisht parimet e vlerave dhe përfitimeve nga SAI-t si dhe përcaktoi tendencën që frymëzon të gjitha SAI-t të qëndrojnë plotësisht të angazhuar në forcimin e përgjegjshmërisë, integritetit dhe transparencës të qeverive që ne auditojmë.

Deklarat na motivon për të ruajtur rëndësinë dhe gatishmërinë ndaj qytetarëve si dhe të mbikqyrim organet që mbajnë llogaritë e qeverive, ndërsa vazhdojmë të ngremë dhe të ruajmë organizata model që drejtohen nga shembulli, në mënyrë që të respektohemi nga ata që besojnë në punën tonë.

Na përket tashmë ne, si SAI, të caktojmë masat për të siguruar përputhjen me objektivat dhe parimet e ISSAI 12 dhe të përgatitemi që të matemi në termat e kuadrit të matshmërisë së performancës së SAI-ve, që drejtohet nga INTOSAI.

Deklarat e Pekinit njeh gjithashtu rolin e rëndësishëm që SAI-t mund të luajnë në forcimin e qeverisjes kombëtare. Auditimi i sektorit publik duhet të rrisë efektivitetin, eficiencën, ekonomicitetin dhe përdorimin e barabartë të burimeve, të qeverisë, duke krijuar kështu bazat për zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar një "jetë dinjitoze" për qytetarët dhe duke promovuar përmirësimin e mundësive për njerëzit.

Do të doja t'i sfidoja SAI-t, të pozicionuar në formë strategjike, në garancinë e tyre për të përmbushur këtë rol të nderuar, shkëlqyeshëm. Kjo, do të përfshijë miratimin dhe zbatimin e plotë të kuadrit të ISSAI-ve, veçanërisht ISSAI-t e miratuara në INCOSAI XXI; sigurimin e vazhdueshëm dhe të mirë koordinuar të aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve në të gjitha disiplinat e auditimit në SAI-t, duke përfshirë përdorimin e plotë të mbështetjes së INTOSAI-t, sekretariateve rajonale dhe SAI-ve individualisht; dhe rritjen e shkëmbimit të njohurive të sektorit publik brenda SAI-ve, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve për t'iu përgjigjur sfidave fiskale dhe ekonomike, për të mundësuar që SAI-t mbeten të rëndësishëm.

Në përfundim, dëshiroj të kujtoj për të gjithë ne si SAI, se roli ynë është të sjellim shpresë për qytetarët e botës. Unë besoj plotësisht, se nëse ne vazhdojmë në drejtimin e caktuar 60 vjet më parë – një drejtim i konfirmuar dhe ri-përcaktuar në Pekin – ne si SAI, me të vërtetë do të sjellim shpresë për qytetarët e botës.

Si INTOSAI, është koha jonë për të shkëlqyer, dhe ne do të shkëlqejmë.

INCOSAI XXI Një vështrim i shpejtë

Kongresi i XXI Ndërkombëtar i INCOSAI-t u hap zyrtarisht më 22 Tetor 2013, në Pekin. Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe pritësi i INCOSAI XXI, i uron mirëseardhjen në Kinë delegatëve

Për nder të 60-vjetorit të INTOSAI-t, u prezantuan një sërë pullash përkujtimore. Nga e majta, Terrence Nombembe, Auditues i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut; Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t; Gene Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i SH.B.A; dhe Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës, prezantojnë pullën e INCOSAI XXI.

INCOSAI XXI Një vështrim i shpejtë

■ Në Kongresin INCOSAI XXI morën pjesë më shumë se 546 delegatë që përfaqësonin 158 SAI, 19 delegatë që përfaqësonin tre anëtarë të asociuar të INTOSAI-t dhe 33 vëzhgues që përfaqësonin 22 organizata.

■ Për nder të 60-vjetorit të INTOSAI-t, Kongresi publikoi një botim të veçantë "60 Vite INTOSAI - 50 Vite Sekretariat i Përgjithshëm: Transparencë, Përgjegjshmëri dhe Qeverisje e Mirë", si dhe një seri pullash përkujtimore

■ Raportet sipas temave, të miratuara nga Kongresi INCOSAI XXI, të cilat u përqendruan mbi rolin e SAI-ve në promovimin e qeverisjes së mirë, ishin si vijon :

❍Tema 1: Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare

❍Tema 2 : Roli i SAI-ve në Ruajtjen e një Qëndrueshmërie

Muri i Madh shtrihet për më shumë se 8.000 kilometra, me rrugën e tij dredha-dredha përmes Kinës, me një këmbëngulje që për 2.500 vjet ka shërbyer si një simbol për ruajtjen e sigurisë së vendit dhe popullit të Kinës. Ky rol, si një mbrojtës kundër kërcënimeve të jashtme dhe një konsolidues i mirëqënies kombëtare, është i ngjashëm me funksionin e auditimit, dhe për këtë arsye ishte frymëzim për logon e Kongresit INCOSAI XXI. Muri i Madh pasqyron një vizion largpamës të parashikimit strategjik për të krijuar një seri fortifikimesh, muresh dhe punimesh tokësore që u lidhën për të krijuar një entitet të jashtëzakonshëm. Përveç ndërtimit të një linjë të mbrojtjes, Muri i Madh ka lehtësuar historikisht komunikimin dhe tregtinë, duke krijuar një rrugë në mes kulturave të ndryshme. Imazhi i Murit të Madh në logon e INCOSAI-t është integruar me përshtatje me gjithë Globin, duke evokuar një ekonomi botërore dhe informacione të rrjetit që po bëhen gjithnjë e më të globalizuara. Këtu,gjithashtu globi është referencë e emblemës së INTOSAI-t, dhe thekson pozicionin e Organizatës, për të lehtësuar bashkëpunimin dhe zhvillimin mes SAI-ve kudo në botë. Duart që "ngrejnë dhe mbajnë" globin përfaqësojnë bashkëpunimin në mes SAI-ve dhe qytetarëve, për të nxitur auditimin dhe për të adresuar, së bashku, sfidat e një ekonomie botërore në rritje.

Afatgjatë të Politikave Financiare.

■ Në fjalimin e tij në ceremoninë e nisjes së Kongresit, Moderatori dhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Dr Josef Moser vuri në dukje rëndësinë e Rezolutës A/66/209 të Asamblesë së Përgjithëshme të OKB-së, e cila promovon eficiencën, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike, duke forcuar SAI-t. Kjo rezolutë, tha ai, është e rëndësishme për Punën e ardhshme të INTOSAI-t dhe përfshirjen e tij në axhendën e OKB-së pas vitit 2015.

■ **Deklarata e Pekinit**, e cila bën thirrje për promovimin e Mirëqeverisjes nga ana e SAI-ve , u miratua.

■ Anëtarësimi i plotë INTOSAI-t u rrit në 192 SAI anëtare, me pranimin e SAI-t të Taxhikistanit. Anëtarësimi i asociuar është rritur në pesë, pas pranimit të SAI-t të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të Afrikës Perëndimore.

■ Çmimi "Jörg Kandutsch" për këtë vit për shërbime të merituara në auditimin e jashtëm publik iu dha Dr Josef Moser, në kapacitetin e tij si President i Gjykatës Austriake të Auditimit (ACA), duke njohur marrjen e masave të suksesshme nga ana e ACA -s për reforma kombëtare dhe aktivitete në lidhje me miratimin e Rezolutës A/66/209 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në fjalën e tij të falënderimit, Josef Moser deklaroi se Çmimi i takon të gjithë anëtarëve të INTOSAI-t, si dhe punonjësve të ACA-s, mbështetja aktive e të cilëve i kishte mundësuar ACA-s të kryejë me sukses detyrat e saj në vitet e fundit.

■ Çmimi "Elber B. Staats", i cili jepet për artikullin më të mirë të botuar në Revistën Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik të Qeverisë- sikurse gjykohet nga Bordi i Redaktorëve të kësaj Reviste- që nga Kongresi i fundit INCOSAI-, iu dha Yining Zhou të Shkollës së Tregtisë dhe Menaxhimit, Universiteti Southern Cross i Australisë, si dhe Gangying Zhou, i dalë në pension, i Zyrës së Auditimit të qytetit Huazhou, provinca Guangdong, Kinë, për artikullin e tyre "*Caktimi i Gjykimeve mbi Materialitetin në Auditimet e Jashtme Publike: Përvojat e Audituesve të Pushtetit Vendor kinez*.

INCOSAI XXI Një vështrim i shpejtë

Veprimet e ndërmara gjatë INCOSAI-t XXI:

■ Zgjedhja e përfaqësuesit të ri për EUROSAI, AFROSAI, dhe ASOSAI Bordin Drejtues të INTOSAI-t: SAI-t e Polonisë dhe Rusisë për EUROSAI-n, SAI-t e Gabonit dhe Egjiptit për AFROSAI-n dhe SAI-t e Japonisë dhe Pakistanit për ASOSAI-n.

■ SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe iu bashkua anëtarëve të Bordit Drejtues si i ftuar i INCOSAI XXII 2016.

■ SAI-t e Norvegjisë dhe SHBA-së u ri-zgjodhën përgjegjës për respektivisht, IDI-n dhe Revistën Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik të Qeverisë.

■ Transferimi i kryesisë të Qëllimit 2, Komitetit i Ngritjes së Kapaciteteve (CBC) nga SAI i Marokut në SAI-n e Afrikës së Jugut.

■ Përcaktimi i një nën-drejtuesi dhe miratimi i SAI-t të Suedisë si zv.drejtues i CBC.

■ Shpërbërja e nënkomitetit 1 të CBC, “Promovimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t” dhe kalimi i detyrave në Komitetin Drejtues të CBC-së.

■ Krijimi i një Grupi të Ri pune mbi Auditimin e Industrive Nxjerrëse kryesuar nga SAI i Ugandës dhe Task Forca e re mbi Auditimin e Kontratave të Prokurimit e kryesuar nga SAI i Federatës Ruse, të dyja nën Qëllimin 3. Shpërbërja e Grupit të Punës së INTOSAI-t për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmave në rastet e Fatkeqësive natyrore.

■ Transferimi i kryesisë së Grupit të Punës së INTOSAI-t për Auditimet e mjedisit nga SAI i Estonisë në SAI-n e Indonezisë.

■ Transferimi i kryesisë së Grupit të Punës së INTOSAI-t për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve, nën Qëllimin 3, nga SAI i Afrikës së Jugut tek SAI i Meksikës.

■ Zgjedhja e Institucioneve Supreme të Auditimit të Kinës, Arabisë Saudite, SHBA-së, Norvegjisë dhe Ekuadorit si anëtarë, dhe Afrikës së Jugut dhe Sekretariatit të Përgjithshëm si anëtarë *ex-Officio* të Komitetit të Financave dhe Administrimit, nën Qëllimin 4.

Mbi Takimin e 64-t të Bordit Drejtues

Takimi i 64-t i Bordit Drejtues të INTOSAI-t u zhvillua më 21 tetor 2013, në Pekin, Kinë. Nga e majta në të djathtë janë Rashad M. Kassim, Byroja e Përgjithshme e Auditimit, Arabia Saudite ; Osama Jafar Faquih, President i Byrosë së Përgjithshme të Auditimit, Arabia Saudite; Robert Sattler, Drejtor i Gjykatës Austriake të Auditimit, Austri; Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëmm i INTOSAI-t, Austri; Terrence Nombembe, Auditues i Përgjithshëm, Afrika e Jugut; Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm, Kinë; Zhou Weipei, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Ndërkombëtar, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës Popullore të Kinës;Monika Gonzalez-Koss, Drejtor i Planifikimit Strategjik të INTOSAI-t, Austri.

Mbledhja e 64- t e Bordit Drejtues të INTOSAI u mbajt në Kinë në Qendrën e Konventave Kombëtare, në prag të Kongresit INCOSAI XXI. Bordi Drejtues miratoi veprimet e mëposhtme:

1. Krijimin e pozicionit të një Zëvendës-Kryetari të Komitetit Mbikëqyrës të Përhershëm për Çështjet e Reja, si dhe miratimin e SAI-t të SHBA për të shërbyer në këtë rol.

2. Miratimin e raporteve vjetore dhe pasqyrave financiare të audituara të Sekretariatit të Përgjithshëm, 2010-2012.

3. Miratimin e buxhetit 2014-2016 të INTOSAI-t.

4. Transferimin e kryesisë së Nënkomitetit të Auditimit Financiar nga SAI i Suedisë në SAI-n e Emirateve të Bashkuara Arabe.

5. Miratimin e Planit Strategjik të IDI-t për vitet 2014-2018 dhe të mandatit të rishikuar të IDI-t.

Lista e ISSAI-ve, INTOSAI GOVs dhe Dokumenteve Zyrtare të miratuara nga INCOSAI XXI

ISSAI/ INTOSAI GOV	Titulli	Hartuar nga
ISSAI 12	Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - duke sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve	Grupi i punës për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve
ISSAI 100	Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik	Projekti i Harmonizimit
ISSAI 200	Parimet themelore të Auditimit Financiar	Projekti i Harmonizimit
ISSAI 300	Parimet themelore të Auditimit të Performancës	Projekti i Harmonizimit
ISSAI 400	Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë	Projekti i Harmonizimit
ISSAI 5500	Njohja me Udhëzimin për Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish
ISSAI 5510	Auditimi i Gatishmërisë ndaj Fatkeqësive	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish
ISSAI 5520	Auditimi i Ndihmës në Situata Fatkeqësish	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish

ISSAI 5530	Përshtatja e i Procedurave të Auditimit për të marrë parasysh rritjen e Riskut të Mashtrimit dhe Korrupsionit në fazën e emergjencës pas një fatkeqësie	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish
ISSAI 5540	Përdorimi i Informacionit Gjeo – Hapësinor në Auditimin e Menaxhimit të fatkeqësive dhe Ndihmës në situata fatkeqësish	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish
INTOSAI GOV 9250	Kuadri i Integruar i Përgjegjshmërisë Financiare (IFAF): udhëzime për përmirësimin e informacionit mbi flukset financiare të ndihmave humanitare	Grupi i punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmës në situata Fatkeqësish

Dokumente zyrtare të INTOSAI-t

Dokument zyrtar	Titulli	Zhvilluar nga
	Komunikimi dhe promovimi i vlerave dhe përfitimeve të SAI-ve – Udhëzues i INTOSAI-t	Grupi i Punës për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve

Organigrama Organizative e INTOSAI-t



INCOSAI XXI u hap më 22 Tetor 2013, në Sallën e Madhe të Popullit, Pekin, Kinë.

Përpara ceremonisë festive në 23 Tetor, delegatët dhe vëzhguesit u mblodhën për foton zyrtare të kongresit në Qëndrën Kombëtare të Mbledhjeve në Pekin.

Qëndra Kombëtare e Mbledhjeve në Kinë shërbeu si vendi i zhvillimit të INCOSAI XXI.

Përfaqësues të INTOSAI-t dhe komunitetit të donatorëve gjatë mbledhjes së Komitetit Drejtues të Donatorëve të INTOSAI-t, e mbajtur para Kongresit.

Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe pritësi i INCOSAI XXI, i uron mirëseardhjen delegatëve në ceremoninë festive të zhvilluar në 23 Tetor.

Për të përkujtuar 60-vjetorin e INTOSAI-t, u zhvillua një ceremoni festive dhe kulturore me valltarë dhe muzikantë, në 23 Tetor.

Komunikimi ndërmjet delegatëve nga vende dhe rajone të ndryshme pasuroi diskutimet gjatë Kongresit.

Gjatë Kongresit, Terrence Nombembe (majtas) Auditues i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, i dorëzoi çmimin Jorg Kandutsch, Josef Moserit, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit.

Takimi i 65 i Bordit Drejtues u mbajt pas INCOSAI XXI në 26 Tetor. Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe Kryetari i Ri i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, i uroi mirëseardhjen Bordit të ri Drejtues, që përfshin 18 anëtarë: Bahamas, Kinën, Ekuadorin, Egjiptin, Gabonin, Austrinë, Japoninë, Meksikën, Zelandën e Re, Norvegjinë, Pakistanin, Poloninë, Federatën Ruse, Arabinë Saudite, Afrikën e Jugut, Venezuelën, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe SH.B.A.

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe
Z. Josef Moser, President i ACA-s,
edhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe
Z. Gene Dodaro,
Auditues i Përgjithshëm i GAO-s së SHBA

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe
Prof. As. Dr. Recai Akyel Presidentit i TCA

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z.Liu Jiayi, Kryetar i SAI-t të Kinës, njëkohësisht edhe Kryetari i ri i Bordit Drejtues të INTOSAI-t

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z.Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z. Krzysztof Kwiatowski President i Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK)- të Polonisë

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së në Kongresin e XXI të INCOSAI-t

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë dhe Z. Radoslav Stretenovic, President i SAI-t të Serbisë

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z.Magnus Lindell, zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Suedisë

Z. Bujar Leskaj Kryetar i KLSH-së dhe Z.Dong Dasheng, zv.Kryetari i SAI-t të Kinës

Seanca e Parë e Përgjithshme Plenare: Mbi Qeverisjen e mirë

E moderuar nga Liu Jiayi, Kryetar i Kongresit dhe Auditues i Përgjithshëm i Kinës, Seanca e Parë e Përgjithshme Plenare zgjodhi z Augusto Nardes, Kryetar i Gjykatës Federale të Llogarive të Brazilit, si Zëvendës- Kryetar të Kongresit.

Seanca e Parë e Përgjithshëm Plenare e INCOSAI XXI u mbajt më 22 tetor në Qendrën Kombëtare të Kongreseve në Kinë. Kjo seancë plenare përfshiu një sërë raportesh, të tilla si ato të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI, të Drejtorit të Planifikimit Strategjik, të Komitetit të Financave dhe Administratës, të Task Forcës mbi Planifikimin Strategjik, të shtatë Grupeve Rajonale të Punës të INTOSAI-t, të audituesve të jashtëm të INTOSAI-t, të Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve, si dhe të Nismës për Zhvillim (IDI) të INTOSAI-t.

Vendimet kryesore të Seancës ishin si më poshtë :

■ Pranimi i SAI-t të Taxhikistanit si një anëtar i plotë dhe i SAI-t të Bashkimi Ekonomik dhe Monetar të Afrikës Perëndimore si një anëtar i asociuar i INTOSAI-t.

■ Krijimi i pozicionit të një Zëvendës-Kryetari të Komitetit Mbikëqyrës të Përhershëm për Çështjet në Zhvillim dhe miratimi i SAI-t të Shteteve të Bashkuara për të marrë këtë rol.

■ Miratimi i raporteve vjetore dhe pasqyrave financiare të audituara të Sekretariatit të Përgjithshëm për vitet 2010-2012.

■ Miratimi i buxhetit 2014-2016 të INTOSAI-t.

■ Komunikimi i Temës prioritare për vitin 2014: "Zbatimi i Deklaratës së Pekinit", sidomos i Rezolutës A/66/209 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për forcimin e pavarësisë së SAI-ve dhe të kuadrit të zbatimit të ISSAI-ve, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i financave publike".

■ Prezantimi i nëntë propozimeve nga ana e Komitetit të Financave dhe Administratës:

❍për të ofruar më shumë fleksibilitet financiar për INTOSAI-n për të mbajtur financat e tij dhe për të pranuar kontribute financiare vullnetare,

❍për të sqaruar pritshmëritë mbi vendndodhjet ku do të zhvilloheshin takimet e INTOSAI-t,

❍për të shqyrtuar vlerësimin aktual të anëtarësimit,

❍për të inkurajuar anëtarët e INTOSAI-it për të dhënë kontribute financiare vullnetare,

❍për të njoftuar Sekretariatin e Përgjithshëm për të gjitha financimet e jashtme të vazhdueshme,

❍për të rishqyrtuar procesin e anëtarësimit si anëtar i asociuar,

❍për të përgatitur një plan financimi të nivelit të lartë në përputhje me Planin e ri Strategjik të INTOSAI-t, dhe

❍për të shqyrtuar mundësinë për fillimin e procesit të çertifikimit për audituesit.

■ Transferimi i kryesisë së Nënkomitetit të Auditimit Financiar nga SAI i Suedisë në SAI-n e Emirateve të Bashkuara Arabe.

■ Transferimi i kryesisë së Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC), që shënohet në Qëllimin 2 , nga SAI i Marokut në SAI-n e Afrikës së Jugut.

■ Ngritja e pozicionit të një Zëvendëskryetari të CBC dhe miratimi SAI-t të Suedise për të përmbushur këtë rol.

■ Transferimi i kryesisë së Nënkomitetit 3 të CBC-së "Nxitja e praktikave më të mira dhe sigurimi i cilësisë përmes komenteve vullnetare nga kolegët" nga SAI i Gjermanisë në SAI-n e Republikës Sllovake (me rastin e takimit të 63-të të Bordit Drejtues në vitin 2012).

■ Shpërbërja e Nënkomitetit 1 të CBC-së "Nxitja e aktiviteteve në rritje të ndërtimit të kapaciteteve midis anëtarëve të INTOSAI-t" dhe kalimi i detyrave të tij tek Komiteti i CBC-së.

■ Miratimi i Planit Strategjik 2014-2018 IDI-t dhe i mandatit të rishikuar të IDI-t.

Në Seancë u prezantuan një numër publikimesh, manualesh dhe udhëzimesh, të tilla si:

■ Botimi :60 Vite INTOSAI - 50 Vite Sekretariati i Përgjithshëm: Transparencë, Përgjegjshmëri dhe Mirëqeverisje”

■ Një ribotim i broshurës së Deklarateve të Limës dhe Meksikos, duke përfshirë edhe Tekstin e pashkurtuar të Rezolutës A/66/209 të OKB-së

■ Një përmbledhje të Praktikat Inovative e Angazhimit të Qytetarëve për Përgjegjshmërinë Publike përmes Institucioneve Supreme të Auditimit; një përmbledhje e literaturës përkatëse për forcimin e kapaciteteve SAI-ve në luftën kundër korrupsionit, si dhe

■ Një letër pozicionimi nga Sekretariati i Përgjithshëm dhe nga Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Ekonominë dhe Çështjet Sociale në Simpoziumin e 22-të të OKB/INTOSAI.

Këto botime u shpërndanë tek delegatët që marrin pjesë në Kongres dhe janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të INTOSAI-t http://www.intosai.org nën "publikime".

Bashkëpunimi i donatorëve për INTOSAI-n raportoi për rinisjen e Thirrjes Globale për Propozime për vitin 2013, bazuar në suksesin domethënës të thirrjes së mëparshme për vitin 2011.

Janë 25 projekte që janë duke u financuar ose janë në vazhdim, dhe Kuadri i Matjes së Performancës së SAI-ve është duke bërë përparim të rëndësishëm. Gjithashtu, me nënshkrimin nga ana e Ministrisë franceze të Punëve të Jashtme, numri i donatorëve që kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të INTOSAI-t dhe të Komunitetit të Donatorëve është rritur në 21.

IDI dha një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve të saj për ndërtimin e kapaciteteve, të tilla si Programi i Zbatimit të ISSAI-ve (3i) dhe Programi i Menaxhimit të 3i.

Seanca e Dytë e Përgjithshme Plenare:

TEMAT E KONGRESIT INCOSAI XXI

INCOSAI XXI diskutoi tematika që u përqëndruan në rolin e SAI-ve për promovimin e qeverisjes së mirë

Kongresi INCOSAI XXI diskutoi temat që përqëndroheshin në rolin e SAI-ve në promovimin e qeverisjes së mirë. Përgjatë një dite, Kongresi iu përkushtua diskutimeve mbi dy temat kryesore:

■ Tema I: Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare

■ Tema II: Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Politikave Financiare

Diskutimet mbi Temën I, theksuan faktin që SAI-t kanë nevojë për një mandat auditimi të plotë, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre. Në shumë fusha auditimi kjo ende nuk është arritur, që e bën përcaktuese Rezolutën A/66/209 të

Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe thirrjen e saj për zbatimin e parimeve të pavarësisë, siç janë përcaktuar në Deklaratat e Limës dhe Meksikos.

Kongresi rekomandoi që SAI-t të marrin përgjegjësinë e tyre të auditimit dhe të përshtaten me kërkesat vazhdimisht në ndryshim të një mjedisi kompleks. SAIt-duhet më tepër të lobojnë dhe përkrahin forcimin e një kornize ligjore miqësore ndaj auditimit, të rrisin ndërtimin e kapaciteteve në institucionet e auditimit, dhe të përmirësojnë praktikat kombëtare të auditimit. Ata duhet që në fund të fundit të rrisin efektivitetin e auditimeve kombëtare mbi qeverisjen kombëtare dhe të komunikojnë rezultatet e arritura.

Në këtë frymë, INTOSAI duhet të mbështesë përmirësimin e qeverisjes globale, të përmirësojë qeverisjen e vet dhe t'u bëjë thirrje SAI-ve për të marrë një rol më efektiv në nivel kombëtar.

Diskutimet mbi Temen II treguan që SAI-t duhet të kryejnë auditime të borxhit publik dhe të planifikimin buxhetor afat-gjatë dhe afat-mesëm, për të luajtur një rol efektiv në zhvillimin e qëndrueshëm. Për disa SAI, megjithatë, kjo nuk është e mundur, për shkak të mungesës së një kuadri ligjor.

Pjesëmarrësit në Kongres e konsideruan veçanërisht të rëndësishme për të ankoruar në mënyrë ligjore rregullat e buxhetit dhe për të përdorur treguesit fiskalë. Një sistem solid i kontabilitetit, mundësisht i kontabilitetit rrjedhës, është me rëndësi të madhe, për të rritur transparencën e financave publike. Auditimi i koordinimit efektiv mes politikave buxhetore dhe fiskale, së bashku me një analizë të plotë të riskut ekonomik, është i favorshëm për efektivitetin e auditimeve.

Përcaktimi i rregullave të buxhetit- sidomos në lidhje me bilancin strukturor buxhetor, si dhe për zbatimin e sistemeve të planifikimit-, të buxhetimit të orientuar nga impakti, të auditimeve të performancës, të transparencës dhe përgjegjshmërisë- është veçanërisht e rëndësishme, me qëllim që të ruhet qëndrueshmëria afat-mesme dhe afatgjatë e financave publike dhe borxheve publike.

Në përputhje me strukturat ligjore kombëtare, mandati i SAI-ve duhet të përfshijë auditimin e rregullatorëve financiarë, duke siguruar një dhënie në kohë të informacionit për vendim-marrësit dhe publikun, mbi mundësitë e tyre konkrete të auditimit dhe mbi limitet, në lidhje me qëndrueshmërinë financiare. Auditime të performancës në këtë fushë duhet gjithashtu që të kryhen.

Temat, të cilat u diskutuan plotësisht dhe u miratuan, do të konsolidohen në formën e Marrëveshjve të Pekinit, si aneks të Deklaratës së Pekinit.

Për më shumë, lexoni Kongresi i INCOSAI XXI,

Temat (Marrëveshjet e Pekinit)

http://www.intosai.org.

Seanca e Tretë e Përgjithshme Plenare:

Miratimi i Deklaratës së Pekinit



Kongresi INCOSAI XXI në Pekin u mbyll më 26 tetor 2013,
me miratimin e Deklaratës së Pekinit.

Seanca e tretë e përgjithshme plenare miratoi Deklaratën e Pekinit. Bordi i ri Drejtues i INTOSAI-t gjithashtu miratoi SAI-n e Emirateve të Bashkuara Arabe si organizatorin e Kongresit INCOSAI XXII në vitin 2016. SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe do të shërbejë si nënkryetar i parë i Bordit Drejtues të INTOSAI-t. SAI i Arabisë Saudite do të vazhdojë si nënkryetar i dytë i Bordit

dhe si kryesues i Komitetit të Financave dhe Administrimit. SAI-t e Omanit dhe Ganës u zgjodhën si audituesit e jashtëm të Bordit Drejtues të INTOSAI-t.

Anëtarët e zgjedhur rishtazi apo të rinovuar të Bordit Drejtues, përfshijnë edhe SAI-t e Egjiptit dhe Gabonit nga AFROSAI, të Japonisë dhe Pakistanit nga ASOSAI , si dhe të Polonisë dhe Federatës Ruse nga EUROSAI. SAI-t e Shteteve të Bashkuara dhe Norvegjisë kanë rinovuar pozicionet e tyre, përkatësisht si drejtues të Revistës Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik dhe të Nismës për Zhvillim (IDI) të INTOSAI-t .

Kongresi INCOSAI XXI publikon Deklaratën e Pekinit

Në Deklaratën e Pekinit, pjesëmarrësit e Kongresit, bëjnë thirrje në mënyrë të veçantë për Zbatimin e Rezolutës A/66/209 të OKB-së për forcimin e pavarësisë së SAI-ve dhe shprehëin mbështetjen e tyre për planet për intensifikimin e bashkëpunimit me Kombet e Bashkuara, në kuadër të Axhendës së Zhvillimit Pas Vitit 2015.

Kongresi vuri në dukje përshtatjen e Rezolutës së OKB-së "Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike nërpërmjet forcimit të institucioneve të auditimit suprem", në një mënyrë shumë pozitive, dhe i bëri thirrje anëtarëve, organizatave të zhvillimit dhe aktorëve të tjerë, për të zbatuar në nivel kombëtar parimet e Deklaratave të Limës dhe Meksikos.

Në lidhje me miratimin e standardeve të reja të auditimit, puna u përqëndrua në tre fusha:

■ ISSAI 12 "Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve: Duke sjellë një ndryshim në jetën e qytetarëve"

■ Parimet themelore të auditimit financiar, atij të performancës dhe të përputhshmërisë, të rishikuara nga projekti i harmonizimit (Niveli 3, katër ISSAI : 100, 200, 300 dhe 400)

■ Udhëzimet e auditimit në lidhje me auditimin e ndihmës shtetërore në rastet e fatkeqësive natyrore (Niveli 4, pesë ISSAI : 5500, 5510, 5520, 5530 dhe 5540; si dhe një INTOSAI GOV: 9250).

Kongresi rekomandoi që SAI-t të marrin përgjegjësinë e tyre të auditimit dhe të përshtaten me kërkesat vazhdimisht në ndryshim të një mjedisi kompleks. SAI-t duhet më tepër të lobojnë dhe përkrahin forcimin e një kuadri ligjor miqësor ndaj auditimit, të rrisin ngritjen e kapaciteteve në institucionet e auditimit, dhe të përmirësojnë praktikat kombëtare të auditimit. Ata duhet që në fund të fundit, të rrisin efektivitetin e auditimeve kombëtare mbi qeverisjen kombëtare dhe të komunikojnë rezultatet e arritura.

Fituesi i Çmimit Elmer B. Staats 2013

Shënim i redaktorit: Në çdo Kongres të INTOSAI-t Revista paraqet Çmimin Elmer B. Staats të autorit të shkrimit më të mirë të botuar nga Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik të Qeverisë gjatë tre viteve të mëparshme.

Revista ka kënaqësinë të shpallë fituesin e konkursit të këtij viti, një artikull me bashkë-autor z. Yining Zhou i Shkollës së Tregtisë dhe Menaxhimit, Universiteti Southern Cross, Australi, dhe z. Gangying Zhou, në pension, nga Zyra e Auditimit të Qytetit Huazhou, Guangdong, Kinë.

Titulli i artikullit të tyre, të zgjedhur nga Bordi i Redaktorëve të revistës si artikulli më i mirë i publikuar gjatë vitit 2010 - 2012, është: "Krijimi i gjykimeve mbi Materialitetin në Auditimet e Qeverisë: Përvoja kineze e Audituesve të Qeverisjes Vendore".

Juria për këtë konkurs, janë SAI-t anëtarë të Bordit të Redaktorëve të Revistës dhe Redaktorët e asociuar. Juria mori në konsideratë kriteret në vijim për të klasifikuar artikujt: kontributi në dije dhe origjinaliteti, evidenca kërkimore, trajtimi imagjinativ, merita letrare dhe lënda.

Artikulli u botua në korrik 2011 dhe është gjithashtu online në faqen e internetit të revistës: http://www.intosaijournal.org.

Yining Zhou, djathtas, pranon Çmimin Elmer Staats 2013, dhënë nga Audituesi i Përgjithshëm i SH.B.A, Gene Dodaro, për artikullin e Revistës që z.Zhou e shkroi në bashkëpunim me Gangying Zhou.

Fjalimi i pranimit të Çmimit të 11, Elmer Staats

Mbajtur në INCOSAI XXI, Tetor 2013, nga Yining Zhou, Universiteti Southern Cross, Australi, në emër të botuesve të artikullit fitues, Yining Zhou dhe Gangying Zhou.

Shkëlqesitë Tuaja, Zonja dhe Zotërinj,

Mirëmbrëma.

Si autorë të artikullit, ne shprehim mirënjohjen tonë të thellë për INTOSAI-n dhe Revistën Ndërkombëtare të Auditimit të jashtëm Publik për këtë çmim.

Z. Elmer Staats, është një monument në historikun e auditimit të sektorit publik. Përpara këtij momenti, ne nuk e kishim imagjinuar kurrë se puna jonë modeste, do të lidhej me këtë njeri të madh. Jemi të befasuar, përulemi dhe ndjehemi të nderuar. Shprehim vlerësimet tona të mëdha edhe për botuesit, redaktorët dhe asistentët e Revistës, për këshillat e tyre konstruktive dhe shërbimin e shkëlqyer. Vlerësojmë mbështetjen e madhe dhënë nga Zyra e Auditimit të qytetit Huazhou të Guangdongut në Kinë, si dhe Universitetit Southern Cross në Australi, ashtu si edhe ndihmën e madhe dhënë nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Kinës dhe zyrat lokale të auditimit.

Ne nuk e shohim këtë çmim si njohje të arritjes që pati ky studim. Përkundrazi, ne e shohim këtë si një promovim të nevojës për të sinergjizuar praktikat audituese dhe teorinë, si dhe theksimin e vlerës së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive gjatë procesit të sinergjizimit. Nga ky këndvështrim, ky çmim duhet të ndahet me të gjithë praktikantët dhe kërkuesit e auditimit të qeverisë.

Një fjalë e urtë kineze thotë: mençuria vjen nga praktika. Nga shumë vite praktikë, audituesit e qeverisë nga vende të ndryshme, kanë krijuar një rezervë të madhe eksperiencash praktike. Por, thjesht grumbullimi i eksperiencave, është i pamjaftueshëm për të prodhuar një formë të thellë njohurish. Të gjithë ne, duhet të shkojmë përtej njohurive empirike të thjeshtuara, sipërfaqësore dhe disi të njëanshme, për të pasur një qasje më të thellë, sistematike dhe të kuptueshme të njohurive.

Nëpërmjet njohurive racionale, ne mundemi të eksplorojmë rregullshmëritë dhe të studiojmë natyrën e fenomeneve që dalin nga praktika e auditimit, në kërkesën tonë për "mençuri". Mençuria, në terma të standarteve të auditimit të qeverisë dhe teorive, do të drejtojë dhe përmirësojë praktikat tona, në një nivel të ri. Për të cituar filozofin e lashtë kinez Chu-Tzu, "Sa më shumë të kuptosh, aq më mirë praktikon, sa më mirë praktikon, aq më shumë kupton".

Pikëpamja "Mençuri-praktikë", është në përputhje me sugjerimin e Elmer Staats se zhvillimi i njohurive është përmirësimi i praktikave, për të zgjidhur probleme komplekse. Në Kongresin Ndërkombëtar të Kontabilistëve në 1982, Elmer Staats mbajti fjalimin e famshëm të identifikimit se, fokusi i profesionit të auditimit ka nevojë për përmirësimin e praktikave, si dhe të synojë mënyrat sesi të mund të mbështesë zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe ekonomike. Për këtë shqetësim, Elmer Staats bëri thirrje që i gjithë profesioni i auditimit të "zhvillonte standartet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, të përmirësonte përgjegjshmërinë nga organizatat ndërkombëtare, si dhe të përmirësonte trajnimin dhe zhvillimin e mundësive për audituesit e qeverisë".

Në emër të Çmimit Elmer Staats, ne e përdorim thënien e tij, për t'iu drejtuar të gjithë komunitetit të auditimit të qeverisë.

Le të punojmë të gjithë së bashku, si një komunitet, si një skuadër dhe si një familje, për të shkëmbyer eksperiencat tona, njohuritë tona, si dhe të shkëmbejmë arritjet tona teorike dhe praktike. Ne besojmë se, puna jonë e përbashkët, nga prejardhje të ndryshme, do të zhvillojë progresin e auditimit të qeverisë, si dhe do të kontribuojë në zhvillimin e të gjitha shoqërive.

Ne besojmë se, bashkëpunimi ynë do të çojë në sinergjizimin e teorisë me praktikën nga një perspektivë ndërkombëtare, si dhe do të realizojë për rrjedhojë pritshmërinë e Elmer Staats si dhe aspiratën për profesionin e audituesit të qeverisë.

Ky çmim, i dedikohet të gjithë praktikantëve dhe kërkuesve në auditimin e qeverisë.

Shumë faleminderit

Raporti mbi Qëllimin 1: Përgjegjshmëria dhe Standartet Profesionale

Bettina Jakobsen, Zv.Audituese e Përgjithshme e Danimarkës dhe Kryetare e Komitetit për Standartet Profesionale të INTOSAI-t, tha në raportin e saj për INCOSAI e XXI, se detyra kryesore e këtij Komiteti është të zhvillojë, ruajë dhe promovojë Standartet Ndërkombëtare të SAI-ve, ISSAI-t. Ajo tha se gjatë shtatë viteve të kaluara, të 71 anëtarët e këtij Komiteti kishin punuar për të rritur ndërgjegjësimin mbi ISSAI-t dhe për të siguruar se ato tashmë pëdoreshin nga të gjithë SAI-t.

Zj.Jakobsen, raportoi se Projekti i Harmonizimit të ISSAI-ve, i cili përpiqet të harmonizojë kuadrin e ISSAI-ve, ka qenë objektivi kryesor i mandatit për periudhën 2011 – 2013, dhe fokusohej në çështjet si vijon:

- Parimet themelore të auditimit të rishikuara (niveli 3 i kuadrit të ISSAI-ve), përcakton thelbin e auditimit të sektorit publik dhe krijon një platformë të përbashkët për të gjithë SAI-t;
- ISSAI-t e reja, 100, 200, 300, dhe 400 përcaktuan konceptet kryesore të auditimit të sektorit publik dhe do të shërbejnë si një gjuhë e përbashkët për komunitetin e INTOSAI-t. Kryetari i këtij Komiteti raportoi se ky komitet është krenar të paraqesë këto ISSAI për miratim në Kongres.

ISSAI 100: Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik
ISSAI 200: Parimet themelore të Auditimit Financiar
ISSAI 300: Parimet themelore të Auditimit të Performancës
ISSAI 400: Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë

Këto ISSAI janë gjithashtu online në http://www.issai.org./3-fundamental-auditing-principles/

Arritja e qëllimit për harmonizimin e kuadrit të ISSAI-ve ka qenë e mundur vetëm nëpërmjet përpjekjeve të bashkëpunimit në PSC. Për shembull, lidhja e boshllëqeve ndërmjet traditave, llojeve të auditimit dhe diferencave kombëtare ka qenë një sfidë që nevoitej të kapërcehej për të siguruar se rezultati i projektit

do të ishte një set standartesh koherente. Zj.Jakobsen tha se pjesëmarrja e ekspertëve nga anëtarët e nënkomitetit të PSC-së, ka qenë thelbësore për suksesin e projektit.

Kryetarja e PSC-së gjithashtu shprehu falenderimet e saj për SAI-n e Suedisë, i cili u largua si kryesues i Nënkomitetit për Auditimet Financiare pas nëntë vitesh, për punën në zhvillimin e udhëzuesve të auditimit financiar dhe kontributet e tij për projekte të tjera të PSC-së.

Seksioni në vijim, përmbledh progresin e PSC-së në arritjen e objektivave strategjikë, punën e nënkomiteteve të PSC-së, publikimet e miratuara nga Kongresi dhe qëllimet strategjike të PSC-së për 2014-2016.

PSC 2011–2013

Aktivitetet e PSC-së në rishikimin dhe zhvillimin e standarteve janë organizuar në projekte të kryera nga një prej nënkomiteteve ose nga një grup ndërsektorial projektesh. PSC aktualisht është e organizuar në pesë nënkomitete të përhershme:

■ Nënkomiteti i Auditimit Financiar (FAS)

■ Nënkomiteti i Auditimit të Performancës (PAS)

■ Nënkomiteti i Auditimit të Përputhshmërisë (CAS)

■ Nënkomiteti i Standarteve të Kontrollit të Brendshëm

■ Nënkomiteti i Kontabilitetit dhe Raportimit

Disa grupe projektesh kanë punuar gjithashtu në zhvillimin e udhëzuesve të ndryshëm për periudhën 2011–2013. Në 2011, PSC shkriu projekt grupin mbi transparencën dhe përgjegjshmërinë (ISSAI 20), dhe në 2013, projekt grupin mbi auditimin e kontrollit të cilësisë (ISSAI 40). Në linjë me mandatin e PSC 2011-2013, PSC në tre vitet e kaluar është përqëndruar në përpjekjet për Projektin e Rritjes së Ndërgjegjësimit dhe Projektin e Harmonizimit të ISSAI-ve

(ISSAIs 100, 200, 300, dhe 400). Nga fundi i vitit 2013, detyrat e këtyre grupeve u përmbushën dhe ato do të shpërbëhen.

Anëtarët e PSC-së mblidhen çdo tre vjet në përputhje me INCOSAI-n. Administrimi i përditshëm i PSC-së i është caktuar Komitetit Drejtues të PSC-së, detyrat e të cilit përfshijnë koordinimin e punës së nënkomiteteve dhe projekteve. Të 19-të anëtarët e PSC-së, përfshijnë SAI-t e Bahrein, Brazilit, Kamerunit, Kanadasë, Kinës, Danimarkës, Francës, Indisë, Italisë, Libisë, Meksikës, Marokut, Zelandës së Re, Norvegjisë, Polonisë, Afrikës së Jugut, Suedisë, SHBA-së dhe Zimbabve.

Komiteti Drejtues i PSC-së është mbledhur tre herë që prej INCOSAI XX në Afrikën e Jugut: Qershor 2011 në Zelandën e Re, Maj 2012, në Afrikën e Jugut dhe Qershor 2013, në Suedi.

Projekti i Harmonizimit të ISSAI-ve

Finalizimi i Projektit të Harmonizimit të ISSAI-ve shënon fundin e këtij hapi të tretë drejt krijimit të një seti standartesh të përbashkëta, të besueshme dhe të qëndrueshme për auditimin e sektorit publik.

Hapi i parë u mor në 2007 në Kongresin e Meksikës, kur të gjithë dokumentet ekzistuese dhe të planifikuara zyrtare të INTOSAI-t dhe nëntë ISSAI të reja për auditimin financiar, u bashkuan në një kuadër ISSAI-sh.

Hapi i dytë u mor në 2010 në Kongresin e Afrikës së Jugut kur kongresi miratoi 37 ISSAI të reja dhe kështu promovoi setin e parë të kuptueshëm të miratuar, të ISSAI-ve të reja. Të gjithë anëtarët e INTOSAI-t u inkurajuan të përdornin ISSAI-t si një kuadër të përbashkët referuar auditimit të sektorit publik, të masnin performancën e tyre dhe udhëzuesin e auditimit kundrejt ISSAI-ve, si dhe të zbatonin ISSAI-t në përputhje me mandatet dhe legjislacionin e tyre.

Hapi i tretë ndodhi në 2013 kur Kongresi i XXI në Kinë miratoi parimet themelore të rishikuara të kontabilitetit në ISSAI-t e reja 100, 200, 300, dhe 400. Me këtë miratim, Projekti i Harmonizimit do të arrijë qëllimin e përgjithshëm të të ofruarit e një baze konceptuale për auditimin e sektorit publik që siguron qëndrueshmëri në kuadrin e ISSAI-ve dhe një gjuhë të përbashkët për komunitetin e INTOSAI-t. ISSAI-t e reja gjithashtu ofrojnë për secilin anëtar të INTOSAI-t një bazë të qartë për vendimet e tyre personale sesi ISSAI-t mund të zbatohen më mirë dhe të përdoren brenda kontekstit kombëtar. Të mundësuarit e përdorimit të ISSAI-ve si një bazë për rishikimet në të ardhmen të ISSAI-ve të nivelit 4, do të jetë një përpjekje e vazhdueshme për PSC-në dhe nënkomitetet.

ISSAI i ri 100 përcakton parimet themelore të Auditimit të Sektorit publik

ISSAI 100: Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit publik pritet të jetë produkti më i ri i INTOSAI-t në promovimin e auditimit të sektorit publik dhe praktikave të auditimit të mirë. Ai mbulon të gjitha llojet e auditimit të sektorit publik dhe ofron konceptet kryesore, elementët dhe parimet, që aplikohen në të

gjitha auditimet e sektorit publik. Ai gjithashtu mund të përdoret nga të gjitha SAI-t, pavarësisht detyrave të tyre dhe mandatit.

ISSAI 100 konfirmon se auditimi i sektorit publik kontribuon në qeverisjen e mirë duke rritur përgjegjshmërinë dhe transaparencën, duke ofruar informacione të besueshme dhe duke krijuar nxitje për ndryshim, duke inkurajuar përmirësime të vazhdueshme dhe mbështetur konfidencën në përdorimin e duhur të fondeve publike dhe aseteve, si dhe performancën e administratës publike. ISSAI 100 bën dallimin ndërmjet auditimeve financiare, të performancës dhe të përputhshmërisë, por mund edhe të aplikohet për lloje të tjera auditimi.

Parimet e reja bazë të auditimit gjithashtu përmirësojnë koherencën dhe qëndrueshmërinë ndërmjet niveleve në kuadrin e ISSAI-ve. ISSAI-t e reja bëjnë referencë të qëndrueshme me ISSAI-t në nivelet 1 dhe 2, kështu që mbivendosjet ndërmjet tyre janë evituar.

Autoriteti i ISSAI-ve është përcaktuar në ISSAI-n 100, që gjithashtu shpjegon sesi audituesit mund t'i referohen ISSAI-ve

Parimet e reja themelore ofrojnë bazën e përbashkët profesionale për auditimet e SAI-ve. Pjesa "Qëllimi dhe Autoriteti i SAI-ve" në ISSAI-n 100 sqaron se çfarë do të thotë të përputhesh me ISSAI-t dhe shpjegon sesi SAI-t u referohen atyre, duke ofruar kështu mënyrat e zbatimit; ky inormacion nuk ka qenë më parë pjesë e kuadrit ISSAI.

ISSAI 100 njeh se SAI-t kryejnë auditimet e tyre në përputhje me standartet e ndryshme kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare të auditimit. Secili anëtar i INTOSAI-t nxitet të përcaktojë standartet e veta të auditimit në bazë të parimeve dhe mandatit të tij. Parimet mund të përdoren si bazë për zhvillimin autoritativ të standarteve në tre mënyra:

■ të formojnë bazën në të cilat standartet janë zhvilluar nga një SAI,

■ të formojnë bazën në të cilën standartet kombëtare të qëndrueshme janë miratuar, dhe

■ të formojnë bazën për miratimin e udhëzuesve të përgjithshëm të auditimit (ISSAI-t 1000 - 4999) si standarte.

Në varësi të zgjedhjes së SAI-ve, ISSAI-ve mund t'u referohemi në dy mënyra kryesore:

1. Raportet e auditimit mund të shprehin se auditimi u krye në përputhje me bazën kombëtare të standarteve ose në përputhje me parimet themelore të auditimit ISSAI.

2. Raportet e auditimit mund të shprehin se auditimi u krye në përputhje me ISSAI-t. Në rastin e fundit, udhëzuesit e auditimit në nivelin 4 për auditimet financiare, të performancës dhe të përputhshmërisë aplikohen si standartet autoritative.

Duke dhënë këto dy mundësi, ISSAI 100, lejon një shkallë më të lartë të fleksibilitetit, nëpërmjet së cilës secili SAI përcakton metodën e tij dhe përdor standartet përkatëse brenda kontekstit dhe mandatit.

ISSAI-t përcaktojnë elementët e përbashkët të kontabilitetit të sektorit publik

ISSAI 100 përfshin një pjesë të titulluar "Elementët e Auditimit të Sektorit publik", që reflekton nocionin e Deklaratës së Limës se auditimi është i lindur në administratën publike financiare, duke qenë se menaxhimi i fondeve publike përfaqëson një besim. Auditimi kështu, përfshin një marrëdhënie ndërmjet tre palëve: audituesit, palës përgjegjëse dhe përdoruesve, të cilët mund të jenë legjislativi ose organe mbikqyrëse tek të cilët SAI raporton.

ISSAI 100 përcakton sesi auditimi financiar, i performancës, i përputhshmërisë apo edhe auditime të tjera mund të kategorizohen si veprime të verifikuara apo veprime të drejtëpërdrejta të raportimit direkt. ISSAI 100 gjithashtu, përcakton se auditimi i sektorit publik është thelbësor në të dhënin e informacionit të besueshëm për legjislativin, organet mbikqyrëse, ato të ngarkuar me qeverisjen dhe publikun.

Elementët e përshkruar në ISSAI 100, janë koncepte kryesore që mund të përdoren kur shkruhen standartet dhe përshkruhen llojet e ndryshme të auditimit të kryera nga SAI. Kjo gjuhë e përbashkët profesionale do të lehtësojë më shumë njohuritë eficiente dhe bashkëpunimin si dhe do të shtojë besueshmërinë e mëtejshme në raportet e auditimit të SAI-t.

ISSAI-t e reja 200, 300, dhe 400 përcaktojnë bazat për auditimin financiar, të performancës dhe përputhshmërisë në sektorin publik.

Ndërsa ISSAI 100 bazohet në parimet themelore të auditimit të sektorit publik në përgjithësi, ISSAI-t 200, 300, dhe 400 kanë një qëllim më të përqëndruar të aplikimit dhe përmbajnë parimet themelore për auditimin financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë. Ato gjithashtu ofrojnë udhëzimet më kryesore të një auditimi më të detajuar financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë në nivelin 4. Së bashku me ISSAI 100, parimet kyçe të përshkruara në ISSAI-t 200, 300 dhe 400 ofrojnë bazat për zhvillime të mëtejshme të udhëzimeve në nivelin 4.

■ ISSAI 200: Parimet Themelore të Auditimit Financiar

■ ISSAI 300: Parimet Themelore të Auditimit të Performancës

■ ISSAI 400: Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë

Zhvillimi i udhëzuesve të përgjithshëm të auditimit drejt një grupi të përmirësuar standartesh auditimi.

ISSAI-t e reja 100, 200, 300, dhe 400 i lejojnë SAI-t, nëse dëshiron, të miratojë udhëzimet e përgjithshme të auditimit (ISSAIs 1000–4999) si standarte të veta të auditimit dhe t'i referohen ISSAI-ve në raportet e auditimit. Kjo në një farë mënyre, është praktikë e përcaktuar tashmë brenda komunitetit të INTOSAI-t. Megjithatë, shumë SAI preferojnë gjithashtu të miratojnë dhe zhvillojnë standarte të tjera kombëtare bazuar në parimet themelore të auditimit. Parimet themelore të auditimit ofrojnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e ISSAI-ve

në nivelin 4 ashtu si ofrojnë bazat për zhvillimin e standarteve të auditimit nga vetë SAI-t.

Udhëzuesit në nivelin 4 duhet megjithatë të mbështesin kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nivelin 3 të kuadrit, si dhe duhet të veçojnë ndërmjet kërkesave të auditimit dhe udhëzimeve të mëtejshme të dhëna.

Parimet e reja themelore të auditimit kanë një impakt në rishikimet e ardhshme të nivelit 4 të kuadrit ISSAI – si për udhëzuesit e përgjithshëm të auditimit (1000–4999) dhe për udhëzuesit mbi subjekte specifike (5000–5999). Për të bërë të mundur që harmonizimi të vazhdojë në nivelin 4 të kuadrit, grupi i projektit ka zhvilluar një grup projekt-konventash që duhet të aplikohen në tekstin e udhëzuesve në nivelin 4. Qëllimi është të sigurohet uniformiteti në përdorimin e koncepteve dhe stili i të shkruarit në të gjithë nivelin 3 dhe 4.

Mundësi të reja për më tepër udhëzues operacional të auditimit në nivelin 4 (ISSAI-t 1000–4999)
Parimet e reja themelore të auditimit krijojnë një mundësi për të zhvilluar udhëzuesit e auditimit të performancës dhe përputhshmërisë drejt një serie udhëzuesish më të përqëndruar dhe më operacional. Parimet japin një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve të ndryshme të procesit të auditimit, të cilat mund të përdoren në zhvillimin e ardhshëm të udhëzuesve.

Komiteti i Standarteve Profesionale dhe Shkëmbimit të Njohurive Komiteti duhet të punojë së bashku drejt përmirësimit të udhëzuesve të auditimit

Përgjegjësia për ISSAI-t në nivelin 4 është aktualisht e ndarë ndërmjet nënkomitetit të PSC (për ISSAI-t 1000–4999) dhe nënkomiteteve në Komitetin e Shkëmbimit të Njohurive (KSC) (për ISSAI-t 5000–5999). Kjo ndarje njihet në Planin Strategjik të INTOSAI-t 2010–2016. Mandati i grupit të projektit përfshin marrjen në konsideratë të shtrirjes në të cilën udhëzuesit specifikë të auditimit (ISSAI-t 5000-–5999) mund të njehsohen me ISSAI-t 100–4999 dhe terminologjinë e përgjithshme të ISSAI-ve.

Puna e grupit të projektit

ISSAI-t e reja u zhvilluan nga Grupi i Projektit të Harmonizimit nga marsi 2011 derin në nëntor 2012. Ky grup u përqëndrua kryesisht në sigurimin që ISSAI-t e reja të rishkuara të reflektonin rolin e veçantë dhe funksionet e SAI-ve dhe që ato të ishin të vlefshme për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t.

Të gjitha kostot e projektit u mbuluan nga vetë SAI-t pjesëmarrëse. Bazuar në reagimet nga anëtarët e grupit të projektit, drejtuesi i projektit vlerësoi shumën e burimeve dhe punën kontribuese të të gjithë anëtarëve të grupit, mbi limitin e çfarë arsyeshëm mund të pritej nga kontributi vullnetar i një SAI.

13 SAI morën pjesë në këtë grup. Pas kryesuesit, SAI-t të Danimarkës, grupi përfshiu anëtarët e Suedisë, Anglisë dhe SHBA-së, Brazilit, Suedisë dhe Austrisë dhe Norvegjisë, ECA-s dhe Republikës Çeke, gjithashtu dhe Kryesuesin e INTOSAI-t, Afrikën e Jugut, zv.kryesuesin, Kinën dhe drejtuesit e Komitetit të Shkëmbimit të Njohurive, Indinë dhe Meksikën si drejtuese të Task Forcës së Databazës për Informacionin e SAI-ve.

Grupi organizoi pesë takime për të gjithë anëtarë, dhe projekti me projekt ISSAI-t u diskutuan gjerësisht në dy takimet e Komitetit Drejtues në Zelandën e Re në 2011 dhe Afrikën e Jugut, 2012.

Të katërt projekt ISSAI-t u publikuan në http://www.issai.org nga nëntori 2012, deri në shkurt 2013. Në vijim të kësaj periudhe, grupi i projektit rishikoi të gjitha komentet e marra, mori parasysh në tërësi rëndësinë e tyre dhe rishikoi ISSAI-t sipas përputhjes.

Komentet e marra për të katërt projekt paraqitjet reflektonin një nivel të lartë sigurie të angazhimit të anëtarëve të INTOSAI-t me këtë fazë kryesore të vendosjes së procesit të duhur të standarteve. Projekti i Harmonizimit mori 1,216 komente nga 47 SAI apo organizata të tjera, të cilët kontribuan shumë në përmirësimin e projekteve. Komentet e marra përgjithësisht shprehnin një mbështetje të gjerë për ambiciet e projektit dhe treguan se shumë SAI i kishin kushtuar një rëndësi të gjithanshme projekteve. Komiteti Drejtues i PSC miratoi

aprovimin e versioneve të ISSAI-ve 100, 200, 300, dhe 400 gjatë takimit të tij në Stokolm në qershor 2013. Një shikim i përgjithshëm i komenteve gjendet në http://www.issai.org.

Rritja e Ndërgjegjësimit për ISSAI-t

Task Forca për Rritjen e Ndërgjegjësimit për ISSAI-t, u krijua në Kopenhagen në qershor 2010. Qëllimi, ishte të zhvilloheshin materiale të ndryshme për të ndërgjegjësuar rreth ISSAI-ve dhe mënyrës më të mirë të zbatimit të tyre.

Zbatimi i kuadrit të ISSAI-ve është një prej prioriteteve kyçe të INTOSAI-t në planin e tij strategjik 2011–2016. Sesi SAI zgjedh të zbatojë kuadrin e ISSAI-ve, i përket SAI-ve individuale, por drejtuesit e Qëllimit 1 dhe 2 dhe të IDI-t, kanë rënë dakort në modelin roll-out të ISSAI-ve për të ruajtur situatën aktuale të aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit. Modeli roll-out përshkruan tre fazat e zbatimit të ISSAI-ve dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e PSC, Komitetit të Ngritjes së Kapaciteteve dhe IDI-t. Modeli roll-out i ISSAI-ve u prezantua dhe u miratua nga Bordi Drejtues i INTOSAI-t në tetor 2011. Programi është financuar nga Banka Botërore me rreth 2.8 million USD.

Gjatë 2011dhe 2012 task forca promovoi një sërë aktivitetesh me qëllim ndërgjegjësimin mbi kuadrin e ISSAI-ve dhe promovimin e zbatimit të ISSAI-ve nga SAI-t, duke përfshirë zhvillimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe prezantimeve PowerPoint, artikujve të publikuar në Revistën Ndërkombëtare të Auditimit të qeverisë si dhe një faqeje të re mbi lehtësimin e zbatimit të ISSAI-ve, http://www.psc-intosai.org.

Google Analytics, ka treguar rritjen e trendit të klikimeve në faqen http://www.issai.org.

PSC vendosi të shpërbënte task forcën në 2012 pasi u kuptua se procesi kishte kaluar nga rritja e ndërgjegjësimit në fazën e zbatimit.

Projekti mbi Kontrollin e Cilësisë

Ky projekt u nis në 2007 me hartimin e një propozimi për një ISSAI të ri mbi kontrollin e cilësisë për t'u miratuar në 2010; numrat e ISSAI-ve 40– 49, u hartuan për këtë qëllim. ISSAI 40, është hartuar për të ndihmuar SAI-t në përcaktimin dhe ruajtjen e një sistemi të përshtatshëm të cilësisë së kontrollit që mbulon punën e tyre, më tepër sesa aktivitetet individuale.

ISSAI 40 më pas u miratua në INCOSAI XX në Afrikën e Jugut, pas një procesi normal. Grupi i projektit që nga ajo kohë ka ndjekur udhëzimet si vijon për të përmbushur ISSAI 40:

■ një mjet për gap analysis për SAI-t, në mënyrë që të vetë-vlerësojnë pozicionin e tyre në lidhje me ISSAI 40

■ një shpjegim të kolonave në mjetin e gap analysis

■ një shembull duke përdorur mjetin e gap analysis bazuar në një SAI hipotetik.

Ky udhëzues zbatimi gjendet në http://www.issai.org/implementationguidance/

Me përmbushjen e detyrës nga task forca me miratimin nga INCOSAI të ISSAI 40 dhe zhvillimin e materialeve mbështetëse udhëzuese, Komiteti Drejtues i PSC vendosi të shpërbënte grupin bazuar në rekomandimin e grupit të projektit.

Arritjet e Nënkomitetit

Nënkomiteti i Auditimit Financar (ISSAI-t 1000-2999)

Ky nënkomitet ka dy objektiva strategjike:

(1) të ruajë dhe zhvillojë udhëzues me cilësi të lartë dhe të pranuar globalisht për auditimin e deklaratave financiare në sektorin publik dhe (2) të bëjë të mundur që këto udhëzues të njihen, pranohen dhe të jenë të mundur për komunitetin INTOSAI. Nënkomiteti u përqëndrua në një plan pune për 2011–

2013 që mbështetet në detyrat kryesore të identifikuara nga Komiteti Drejtues i PSC gjatë 2010:

Të ruajë dhe të vazhdojë të zhvillojë ISSAI-t për auditimin financiar.

■ Të ndërgjegjësojë lidhur me standartet dhe udhëzuesit dhe të kontribuojë me njohuritë e ekspertëve të tij në udhëzuesit për zbatimin.

■ Të kontribuojë në qëndrueshmërinë e kuadrit të ISSAI-ve.

■ Të eksplorojë avantazhet dhe mundësitë e përfshirjes së standarteve të tjera të dala nga Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Sigurimit të Standarteve (IAASB) si pjesë e udhëzuesve të auditimit financiar të INTOSAI-t.

■ Të përmbledhë mësimet e mësuara gjatë gjithë procesit me shpresën se konkluzionet do të kontribuojnë në përmirësimet e mëtejshme të punës së nënkomitetit dhe do të jenë një burim i vlefshëm për organe të tjera të INTOSAI-t.

■ Të monitorojë zbatimin e udhëzuesve ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t.

Nënkomiteti ka zhvilluar mbledhje të vetat në 2011, 2012, dhe 2013. Anëtarët aktualë përfshijnë Kamerunin, Kanadanë, Kinën, ECA-n, Francën, Indinë, Kuvajtin, Meksikën, Namibinë, Zelandën e Re, Norvegjinë, Republikën e Koresë, Rusinë, Afrikën e Jugut, Suedinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Kryesuesit janë Britania dhe SHBA. IAASB është një anëtar vëzhgues.

Nënkomiteti do të vazhdojë, me ndihmën e ekspertëve të INTOSAI-t, të kontribuojë në zhvillimin e ISA-ve dhe të hartojë Shënimet Praktike korresponduese për të siguruar që anëtarët e INTOSAI-t do të vazhdojnë të kenë akses në udhëzuesit e përditësuar financiarë. Gjithashtu, ky nënkomitet do të vazhdojë të marrë në konsideratë nevojën e emërimit të ekspertëve të INTOSAI-t për një rishikim të ri apo inisiativat për zhvillim brenda IAASB.

Gjatë 2012, sekretariati i nënkomitetit ndërmorri një anketë për të përcaktuar nevojat e anëtarëve të INTOSAI-t për të përfshirë standarte të tjera të IAASB lidhur me auditimin financiar në strukturën e ISSAI-ve. Anketa u drejtohej 75 SAI-ve. Nënkomiteti vendosi se ishte ende herët për të identifikuar nevojat për standarte shtesë.

Nënkomiteti ka marrë pjesë në aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit të PSC dhe ka marrë inisiativa si përcaktimi i një paneli me njerëz të rëndësishëm të komunitetit të INTOSAI-t me interes të veçantë në udhëzuesit e auditimit financiar. Nënkomiteti mori pjesë në një sërë ngjarjesh dhe seminaresh për të prezantuar udhëzuesit në 2011 dhe 2012; nevoja për aktivitete në rritjen e ndërgjegjësimit nuk ka qenë e njëjtë në 2013, gjë që reflekton faktin se puna e IDI-t për zbatimin ka nisur. Gjatë 2013 nënkomiteti e ka mbështetur IDI-n në zhvillimet e tij nëpërmjet përpjekjeve vullnetare si nga anëtarët e nëkomitetit ashtu dhe nga përfaqësues nga paneli i ekspertëve të nënkomitetit. Sekretariati i nënkomitetit ka marrë pjesë gjithashtu në mënyrë aktive në Projektin e Harmonizimit të PSC gjatë 2011–2013.

Nënkomiteti i Auditimit të Performancës (ISSAI-t 3000-3999)

Qëllimi i këtij nënkomiteti është (1) promovimi i zbatimit të udhëzuesve për auditimin e performancës dhe (2) zhvillimi dhe shpërndarja e udhëzuesve të tjerë që komuniteti i INTOSAI-t mund të ketë nevojë, për të përfunduar zhvillimin e udhëzuesve të auditimit të performancës të INTOSAI-t (ISSAI-t 3000–-3999). Nënkomiteti i uroi mirëseardhjen tre anëtarëve të rinj: SAI-ve të Hungarisë, Iranit dhe SHBA. Nënkomiteti aktualisht përbëhet nga Australia, Austria, Brazili (drejtuesi), Kanadaja, Danimarka, Franca, Guajana, Hungaria, India, Irani, Kiribati, Meksika, Hollanda, Norvegjia, Arabia Saudite, Sllovenia, Afrika e Jugut, Suedia, Tunizia, Britania, SHBA dhe ECA. Instituti i Audituesve të Brendshëm është anëtar vëzhgues.

Përfaqësuesit e këtij nënkomiteti nga SAI austriak dhe Brazilian, vazhduan të punonin mbi Projektin e Harmonizimit deri në takimin final të prillit 2013 në Indi.

ISSAI 300: Parimet Themelore të Auditimit të Performancës morën 265 komente gjatë periudhës së shfaqjes së ISSAI-ve 100–400. Pas përfundimit të kësaj periudhe në shkurt 2013, grupi i nënkomitetit për projektin punoi mbi ndryshimet e sugjeruara për ISSAI 300 në mënyrë që të përgatiste versionin e miratuar që iu paraqit PSC për miratim. Ky nënkomitet mori pjesë gjithashtu në Programin 3-i dhe krijoi një komunitet praktike.

Plani i Punës së nënkomitetit 2014–2016 paraqet veprimet si vijon:

■ Rishikimin e ISSAI-ve të nivelit 4 duke prodhuar një grup kërkesash në linjë me nivelin 3 që mund të përdoren nga SAI si standarte autoritative.

■ Zhvillimin e materialeve ekzistuese në udhëzues mbi auditimin e performancës që mund të mbështesin ISSAI-t e rinj 300 dhe 3000.

■ Bashkëpunimin me KSC, CBC, dhe Grupin e Punës mbi Vlerësimin e Programeve, duke përfshirë bashkëpunimin me komunitetin e 3i duke angazhuar ekspertë për të marrë pjesë në aktivitetet e komunitetit dhe për të ndihmuar në zhvillimin e produkteve 3i.

■ Testimin dhe vlerësimin e komunitetit elektronik për anëtarët e nënkomitetit.

Takimi i gjashtë i nënkomitetit u mbajt në maj 2013 në Otavë, Kanada. Axhenda përfshiu një vlerësim të zhvillimit të programeve të Planit të Punës 2011–2013 dhe diskutimet e pesë udhëzuesve të rinj të auditimit të performancës të publikuar nga nënkomiteti në 2012.

Nënkomiteti i Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI-t 4000-4999)

Në takimin e tetorit 2004 të Komitetit të Standarteve të Auditimit, në Budapest, Hungari, Grupi i Punës mbi Auditimet e Përputhshmërisë u caktua të zhvillonte udhëzuesit e INTOSAI-t për auditimin e përputhshmërisë. U riemërua Nënkomiteti për Auditimin e Përputhshmërisë pasi u krijua PSC. Ky nënkomitet ka këta anëtarë:

Brazili, Kina, Danimarka, ECA, Gjeorgjia, India, Lituania, Meksika, Namibia, Norvegjia (drejtuese), Portugalia, Rumania, Arabia Saudite, Republika Sllovake, Afrika e Jugut dhe Tunizia. Që prej takimit të fundit të Komitetit Drejtues të PSC në maj 2012, nënkomiteti ka zhvilluar një takim në Vilnius, Lituani në shtator 2012.

Anëtarët e nënkomitetit kanë marrë pjesë në Projektin e Harmonizimit, kanë punuar në finalizimin e ISSAI-t të ri të nivelit 3 miratuar nga INCOSAI XXI. Grupi i harmonizimit të nënkomitetit ka marrë pjesë në zhvillimet e ISSAI-ve, në dhënien e zgjidhjeve si përgjigje ndaj komenteve të bëra në draftin e INTOSAI-t të nivelit 3 dhe ka finalizuar ISSAI 400: Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë.

Që prej miratimit të serive të ISSAI-ve 4000, nënkomiteti ka marrë pjesë në një numër aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me ISSAI-t. Një nëngrup i nënkomitetit ka punuar mbi shtrirjen e cështjeve lidhur me gjykatat e llogarive në një format ISSAI, dhe në takimin e nënkomitetit të 2012, një projekt ISSAI 4300 mbi gjykatat e llogarive u diskutua dhe u mor në konsideratë të mëtejshme nga PSC.

Në periudhën strategjike 2012–2016, nënkomiteti është përgjegjës për sa vijon:

■ Zbatimin: ngritjen e një rrjeti rajonal ekspertësh të përputhshmërisë, të cilët do të ndjekin zbatimin e ISSAi 4000 në SAI-t;

■ Harmonizimin: pjesëmarrja në projektin e harmonizimit të PSC dhe nxjerrjes së ISSAI 400: Parimet *Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*

■ Ruajtjen: të ruajë dhe përditësojë ISSAI-t 4000, 4100, dhe 4200

Nënkomiteti i Standarteve të Kontrollit të Brendshëm (INTOSAI GOV 9100–9199)

Nënkomiteti për Standartet e Kontrollit të Brendshëm punon ngushtë me Institutin e Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe përqëndrohet në marrëdhënien

ndërmjet SAI-ve dhe audituesve të brendshëm, si dhe pavarësinë e këtyre të fundit në sektorin publik. Nënkomiteti, i cili u mblodh në Poloni në 2011 dhe 2012, përfshin SAI-t si vijon: Austrinë, Bahamas, Bangladesh, Belgjikë, Bolivi, Brazil, Kili, Ishujt Cook, Kosta Rikën, Kubën, Egjiptin, El Salvadorin, Francën, Gjeorgjinë, Hungarinë, Xhamajkën, Libinë, Lituaninë, Hollandën, Omanin, Poloninë (kryesuese), Rumaninë, Rusinë, Afrikën e Jugut, Spanjën, Tanzaninë, Ukrainën dhe SHBA. IIA, është vëzhgues.

Në 2012, nënkomiteti zhvilloi dy anketa lidhur me sektorin publik, një mbi riskun e menaxhimit të subjektit dhe një, në udhëzimet për raportimin mbi kontrollet e brendshme. Në bazë të rezultateve të anketave, dukementet kërkimore të nënkomitetit treguan nevojën për rishikimin e udhëzuesve mbi menaxhimin e riskut (GOV 9130) dhe u zhvilluan ato të raportimit mbi kontrollin e brendshëm (GOV 9110).

Plani i punës i nënkomitetit për for 2014–2016 do të fokusohet në rishikimin e INTOSAI GOV mbi kontrollin e brendshëm:

■ Projekt-udhëzuesit e rishikuar mbi raportimin e kontrollit të brendshëm (INTOSAI GOV 9110), në bazën e rezultateve të anketës së kryer në 2012.

■ Projekt-udhëzuesit e rishikuar mbi menaxhimin e riskut (INTOSAI GOV 9130), në bazë të rezultateve të anketë së kryer 2012.

■ Ekzaminimi i INTOSAI GOV 9100, 9120, 9140, dhe 9150, dhe paraqitja e një propozimi mbi rishkimin e tyre.

■ Promovimin aktiv të INTOSAI GOV mbi kontrollin e brendshëm (9100-9150).

■ Zhvillimin e platformës elektronike të nënkomitetit.

Nënkomiteti i Raportimit dhe Kontabilitetit

Nënkomiteti i Raportimit dhe Kontabilitetit është i ngarkuar me vëzhgimin dhe pjesëmarrjen në takimet e përcaktimit të vendosjes së standarteve të kontabilitetit të Federatës Nkërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), Bordit Ndërkombëtar të Standarteve të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSASB).

Nënkomiteti ka këta anëtarë: Kanadaja (kryesuese), Kuba, Franca, Gana, Italia, Kenia, Libia, Lituania, Malajzia, Malta, Maroku, Zelanda e Re, Peruja, Suedia, Trinidad dhe Tobako, Ukraina, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe SHBA.



Me kërkesë të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, nënkomiteti nxorri një kërkesë për shprehjen e interesit nga anëtarët, për t'iu bashkuar Grupit të Rishikimit të Qeverisjes së INTOSAI-t – IPSASB, puna e të cilit do të ishte vlerësimi i qeverisjes aktuale dhe mbikqyrjes së marrëveshjeve të përcaktimit të IPSAS dhe deklaratave të tjera, si dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse. SAI i Francës është emëruar si përfaqësuesi mbikqyrës për INTOSAI-n.

INCOSAI XX miratoi materialin e nënkomitetit, Rëndësia e një Procesi të Pavarur të përcaktimit të standarteve; ky dokument ka dalë tashmë si GOV 9200 dhe gjendet në linkun http://www.issai.org/intosai-guidance-for-goodgovernance-(intosai-gov)/

Qëllimet e PSC për 2014–2016

Detyra kryesore e PSC për tre vitet e ardhshme është të ruajë rezultatet e arritura nga anëtarët e PSC dhe nënkomitetet e tij, projekti, grupet e punës dhe task forcat në respekt të kuadrit ISSAI. INTOSAI dhe PSC do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me të tjerë përcaktues standartesh, si dhe do të zhvillojnë standarte që përputhen me me nevojat e komunitetit të INTOSAI-t.

Mandati i PSC për tre vitet e ardhshme reflekton një angazhim në vazhdim për të ruajtur kuadrin e ISSAI-ve të përditësuar dhe në të njëjtën rrugë me zhvillimet brenda auditimit të sektorit publik. PSC dhe pesë nënkomitetet e tij do të fokusohen në katër fusha gjatë 2014-2016:

1. Vlerësimi dhe përmirësimi i proceseve të vendosjes së standarteve në bashkëpunim të ngushtë me Task Forcën e INTOSAI-t për Planifkimin Strategjik, në mënyrë që të sigurohet dhe zhvillohen standartet e INTOSAI-t për auditimin e sektorit publik.
2. Kryerjen e rishikimeve të ruajtjes së të gjithë udhëzuesve të përgjithshëm të auditimit në nivelin 4 të kuadrit ISSAI për të identifikuar nevojën për rishikime, për të siguruar uniformitetin me parimet e reja themelore të auditimit në nivelin 3 dhe t'i zhvillojë ato drejt një grupi standartesh auditimi më të qarta.

3. Rishikimin dhe zhvillimin e ISSAI-ve dhe INTOSAI GOV në përputhje me procesin e duhur INTOSAI.
4. Mbështetjen në zbatimin e ISSAI-ve.

Përmirësimi i procesit të përcaktimit të standarteve të PSC

Sigurimi i transparencës, besueshmërisë dhe profesionalizmit të aktiviteteve të përcaktimit të standarteve të INTOSAI-t për të ardhmen, është një shqetësim i ngutshëm. Përcaktimi i natyrës dhe qëllimit të aktiviteteve që mund të mbështesin më tej rolin e INTOSAI-t si një përcaktues standartesh, së bashku me pesë nënkomitetet e PSC-së, do të kërkojë një bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Komitetit të Ngritjes së Kapaciteteve, Komitetit të Shkëmbimit të Njohurive, IDI-t, Task Forcës së Planifikimit Strategjik të Komitetit për Financë dhe Administrim, si dhe përcaktuesve të tjerë të standarteve.

Fokusi fillestar do të jetë në vlerësimin dhe identifikimin e pikave të forta dhe të dobta, si dhe kosto-përfitimeve të përmirësimeve të mundshme të kuadrit aktual standart-përcaktues të INTOSAI-t. Rezultatet e aktiviteteve të ndjekura lidhur me këtë, ashtu si edhe propozimet për struktura të reja, do të paraqiten në Bordin Drejtues të INTOSAI-t në 2014, dhe do të drejtojnë aktivitetet e PSC-së në 2015 dhe 2016.

Rishikimet e Mbajtjes

Projekti i Harmonizimit theksoi nevojën për të siguruar qëndrueshmëri ndërmjet parimeve themelore të auditimit dhe parimeve të përgjithshme të auditimit. Në përputhje me frekuencën e ruajtes së dakortësuar për ISSAI-t, PSC do të rishikojë parimet e përgjithshme të auditimi për të identifikuar nevojën për rishikim. Komiteti i Standarteve të Kontrollit të Brendshëm dhe nënkomiteti për Kontabilitetin dhe Raportimin, janë të ngarkuar me mbajtjen e INTOSAI GOV.

Përmirësimi dhe zhvillimi i ISSAI-ve në përputhje me procesin e duhur të INTOSAI-t

Në varësi të rishikimit mbi ruajtjen, PSC do të zhvillojë projekte për përmirësimin dhe zhvillimin e ISSAI-ve për të siguruar që kërkesat e auditmit janë sqaruar dhe udhëzuesit bazohen në parimet e reja themelore të auditimit (ISSAI 100–400).

Mbështetja në zbatimin e ISSAI-ve

Zbatimi i ISSAI-ve mori hov kur IDI i INTOSAI-t, zhvilloi Inisiativën për Zbatimin e ISSAI-ve (3i) në 2012. PSC ka patur edhe më parë në vëmendje rritjen e ndërgjegjësimit mbi ISSAI-t, por me përcaktimin e 3i-ve, theksi ka kaluar në kontributin që jepet për zbatimin e ISSAI-ve. Anëtarët e PSC-së janë të mirë pozicionuar për të kontribuar në këtë detyrë, së bashku me palët e tjera të rëndësishme në INTOSAI, dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe për periudhën e mandatit të ardhshëm.

Takimi i ardhshëm i Komitetit Drejtues të PSC-së, do të zhvillohet në Bahrein në datat 20-22 maj 2014.

Raporti mbi Qëllimin 2: Ngritja e Kapaciteteve Institucionale

Në raportin e tij në Kongres, Kryetari i Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC), Driss Jettou, Presidenti i parë i Gjykatës së Llogarive të Marokut, theksoi rolin qendror që ngritja e kapaciteteve luan në Planin strategjik të INTOSAI-t për të forcuar SAI-t në të gjithë botën.

CBC, e ndihmuar nga përfshirja e 42 SAI-ve anëtare të tij, ka punuar për të arritur qëllimet e mëposhtme:

■ Forcimi i kapacitetit të SAI-ve

■ Futja e kualifikimeve profesionale për stafin auditues

■ Ndihmë ndaj SAI-ve për të menaxhuar në mënyrë efektive burimet e tyre njerëzore

■ Rritja e përdorimit dhe ndikimit të raporteve të auditimit

■ Zbatimi i ISSAI-ve

■ Plani për vazhdimësi në rastet e fatkeqësive natyrore

■ Zhvillimi dhe implementimi i auditimeve të përbashkëta

■ Inkurajimi dhe bërja publike e programeve të praktikës audituese

■ Krijimi dhe shpërndarja e udhëzimeve praktike dhe informacionit në lidhje me konsultimin dhe mendimet kritike nga të barabartët e SAI-ve të tjera (peer reviews)

■ Krijimi dhe mirëmbajtja e një bazë të të dhënave për ndërtimin e kapaciteteve

■ Zhvillimi i një bazë të dhënash të ekspertëve të financave publike.

Z. Jettou pranoi se ndërtimi i kapaciteteve është një sfidë për SAI-t, si dhe një mision që kërkon përkushtim, vizion dhe burime financiare e njerëzore. Ai vuri në dukje se anëtarët e INTOSAI-t kanë bërë progres në këtë fushë, duke ndarë mes tyre njohuri dhe përvojë, si dhe duke mobilizuar burimeve financiare nga komuniteti i donatorëve.

Këto përpjekje, tha Jettou, duhet të kryhen vazhdimisht, të forcohen dhe të përshtaten, për të arritur efekte të qëndrueshme.

Kryetari i CBC-së përfundoi raportin e tij, duke njoftuar se pas nëntë vjetësh si kreu i CBC, dhe në përputhje me praktikat e rekomanduara të INTOSAI-t, SAI i Marokut mendonte se ishte koha për të kaluar stafetën e lidershipit te një tjetër SAI. SAI i Afrikës së Jugut do të ketë pozicionin e drejtuesit të CBC-së, ndërsa SAI i Suedise do të bëhet zëvendës kryesues. Takimi i ardhshëm i Komitetit Drejtues të CBC-së do të mbahet në Lima, Peru, më datat 08-10 shtator 2014.

Nënkomiteti 1 : Nxitja e Ngritjes së Kapaciteteve

Aktivitetet ndërmjet anëtarëve të INTOSAI-t

Nënkomiteti 1 është projektuar për të identifikuar dhe dhënë, me anë të udhëzimeve dhe të burimeve të tjera të informacionit, praktikat më të mira për ndërtimin e kapaciteteve në të gjithë Komuniteti INTOSAI. Komiteti është takuar tri herë që nga INCOSAI XX, dhe ka punuar për të siguruar se takimi i tij vjetor të përfshijë të gjitha elementët kryesorë të ndërtimit të kapaciteteve në komunitetin INTOSAI, duke përfshirë edhe delegatë rajonalë.

Nënkomiteti 1 ka këta anëtarë: SAI-t e Austrisë, Azerbajxhanit, Bangladeshit, Butanit, Kanadasë, Kroacisë, Danimarkës, Estonisë, Gjykatës Evropiane të Audituesve, Fixhit, Francës, Gjermanisë, Hungarisë, Iranit, Irakut, Italisë, Japonisë, Jordanisë, Kazakistani, Republikës së Koresë, Kuvajtit, Kirgistanit, Libisë, Marokut, Norvegjisë, Omanit, Pakistanit, Perusë, Polonisë, Arabisë Saudite, Sllovenisë, Afrikës së Jugut (Kryesuese), Spanjës, Shri Lankës, Suedisë (ZV Kryesuese), Tajlandës, Tunizisë, Ukrainës, Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Jemenit.

Disa tema kryesore për ndërtimin e kapaciteteve, të dala nga grupimet rajonale të INTOSAI-t, janë si më poshtë:

■ Rritja e vazhdueshme dhe zhvillimi i komiteteve rajonale të ngritjes të kapaciteteve.

■ Mungesa e vazhdueshme e lidershipit të fortë dhe e burimeve në disa rajone.

■ Qëllimi për përdorimin më të mirë të teknologjisë së informacionit, për të zvogëluar shpenzimet, ndërsa menaxhon dhe jep trajnime.

■ Qëllimi për bashkimin e mëtejshëm të kostove të zhvillimit dhe materialeve të kurseve të trajnimit.

■ Rëndësia e pronësisë lokale të trajnimeve, për përshtatjen dhe kontekstualizimin e udhëzimeve dhe manualeve në nivelin e një SAI individual.

■ Nevoja për të inkurajuar disa drejtues SAI për të parë bashkëpunimin si reciprokisht të dobishëm.

■ Qëllimi për të zhvilluar një dosje auditimi model për auditimin e subjekteve të vogla.

■ Përkushtimi i rjë hapësire në rritje të rendit të ditës për shkëmbimin e informacionit midis rajoneve.

Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) ka marrë përgjegjësinë për menaxhimin e bazës së të dhënave të Ngritjes së Kapaciteteve, e cila mund të shihet në internet në http://www.saidevelopment.org/default.aspx.

Lista e udhëzimeve që Nënkomiteti 1 ka prodhuar, si dhe numri i atyre që janë përkthyer në gjuhët kryesore të INTOSAI-t, vazhdon të rritet. Që nga INCOSAI XX, dy udhëzime të reja janë prodhuar dhe shpërndarë:

1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore-Një Udhëzues për Institucionet Supreme të Auditimit (nga SAI i Hollandës)

2. Zbatimi Standardeve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-t): Konsiderata strategjike (nga SAI i Suedisë).

Këto udhëzime janë në dispozicion në faqen e internetit të CBC-së: http://cbc.courdescomptes.ma.

Nënkomiteti 1 ka propozuar shpërndarjen e tij, për të shmangur dyfishimin e shpenzimeve dhe burimeve me Komitetin Drejtues të CBC-së dhe për të liruar burimet financiare që do të mundësonin një numër më të madh të vendeve përfituese për të marrë pjesë në aktivitetet e CBC-së . Bordi Drejtues në Takimin e 64-t votoi për të miratuar këtë shpërbërje.

Nënkomiteti 2 : Zhvillimi i Shërbimeve këshilluese dhe konsultative

Nënkomiteti 2, përbëhet nga këta anëtarë: SAI-t e Fixhit, Kazakistanit, Marokut, Pakistanit, Perusë (Kryesuese) dhe Sllovenisë. Nënkomiteti synon të zhvillojë shërbimet këshilluese dhe konsultative.

Aktivitetet e tij mbështesin qëllimet e mëposhtme:

■ Zhvillimi i një baze të dhënash të ekspertëve dhe hetuesve të financave publike.

Për ta çuar më tej këtë mision, SAI i Perusë ka zhvilluar një platformë virtuale për Bazën e të dhënave të ekspertëve dhe specialistëve, e cila u lansua në vitin 2010. Numri i rregjistrave për këtë bazë të dhënash është rritur nga 27 në 114. Nënkomiteti 2 ka ftuar anëtarët e INTOSAI-t që të regjistrojnë ekspertë në

bazën e të dhënave, dhe numri i ekspertëve është rritur nga 41 në75. Nënkomitetit 2 planifikon të koordinojë integrimin e Bazës së të dhënave të Ekspertëve me Bazën e të Dhënave të informacioneve për SAI-t.

■ Inkurajimi i programeve të përbashkëta, ose të koordinuara apo paralele të auditimit. Nënkomiteti miratoi një propozim për të kthyer Udhëzuesin e tij për Auditime të Përbashkëta në një ISSAI dhe drafti që rezulto ishte ISSAI 5800, i cili ka marrë komente nga 25 SAI. Drafti përfundimtar i ISSAI 5800 do të dorëzohet për miratim final në Kongresin INCOSAI XXII në vitin 2016.

■ Inkurajimi i praktikave dhe programe të vizitave. SAI i Pakistanit ka zhvilluar një version paraprak të një udhëzuesi të praktikave audituerse. Nënkomiteti 2 planifikon të koordinojë miratimin dhe publikimin në internet të këtij Udhëzimi, si dhe të identifikojë dhe shpërndajë ofertave të praktikave audituese, të disponueshme brenda organizatave rajonale.

Nënkomiteti 3: Nxitja e Praktikave më të Mira dhe e Sigurimit të Cilësisë përmes Shqyrtimeve Vullnetare mes SAI-ve (peer reviews)

Nënkomiteti 3 ka këta anëtarë: SAI-t e Austrisë, Bangladeshit, Kroacisë, Estonisë, Gjykatës Evropiane të Audituesve, Gjermanisë, Hungarisë, Marokut, Polonisë, Republikës Sllovake (Kryesuese) dhe Shteteve të Bashkuara.

Nënkomiteti përpiqet për të arritur qëllimet e mëposhtme :

■ Të vlerësojë dhe dokumentojë marrëveshjet ekzistuese për shqyrtim vullnetar mes kolegëve në komunitetin e INTOSAI-t

■ Të nxisë një mjedis ku komente të tilla vullnetare shihen si reciprokisht të dobishme

■ Të përditësojë udhëzimet e CBC-së dhe praktikat më të mira në shqyrtimet vullnetare

■ Të shpërndajë rezultatet e këtyre shqyrtimeve.

Në vitin 2012, Bordi Drejtues i INTOSAI-t miratoi kalimin e Kryesisë së Nënkomisionit 3 nga SAI i Gjermanisë në SAI-n e Republikës Sllovake.

Dokumentacioni i Nënkomitetit 3 për momentin përbëhet nga materiale per 29 shqyrtime mes kolegëve dhe është në dispozicion online në http://cbc.courdescomptes.ma/.

Në fillim të vitit 2014, Nënkomiteti 3 do të shpërndajë një vrojtim për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t, duke u kërkuar atyre që të japin informacion që mund të përdoret për të dokumentuar projekte për shqyrtim vullnetar mes kolegëve. Rezultatet e këtij vrojtimi do të përfundohen në mars 2014.

Për të promovuar dhe publikuar komentet e shqyrtimeve vullnetare mes anëtarëve të INTOSAI-t dhe për publikun e gjerë, Nënkomiteti 3 ndërmori këto veprime:

■ Dërgoi një artikull, të botuar në numrin prill 2013 të Gazetës Ndërkombëtare të INTOSAI-t për Auditimin e Jashtëm Publik.

■ Përgatiti një artikull për koleksionin e Shoqatës Gjermane të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, me temë :"Institucionet Supreme të Auditimit - Llogaridhënia për Zhvillim"

■ Bëri një prezantim në takimin e pestë vjetor të Zyrtarëve të Buxheteve Parlamentare të OECD-së dhe të Institucionet të Pavarura Fiskale, të mbajtur në shkurt 2013

■ Bëri një prezantim në Konferencën e katërt EUROSAI – ARABOSAI, mbajtur në prill 2013

■ Mori pjesë në një seminar të organizuar nga SAI i Indonezisë në prill 2013.

Kongresi INCOSAI XX miratoi Udhezimin dhe Listën e Kontrollit (Checklist) të Shqyrtimeve Vullnetare, të zhvilluar nga Nënkomiteti 3 si një ISSAI 5600, në vitin 2010. Ky dokument që atëhere është përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare të INTOSAI-t. Përkthime të tjera - si bengalisht, hungarisht, portugalisht dhe sllovakisht- janë aktualisht në progres. Task forca e ISSAI 5600 kërkoi reagime dhe vërejtje për këtë ISSAI në vitin 2012. Në vitin 2013, kjo Task Forcë konsideroi një propozim për të ristrukturuar ISSAI 5600.

Nënkomiteti 3 do të paraqesë një ISSAI 5600 të rishikuar në Kongresin INCOSAI XXIII në vitin 2016. Nënkomiteti 3 dëshiron të rekrutojë anëtarë të tjerë, veçanërisht përfaqësues nga AFROSAI dhe OLACEFS, për të arritur një përfaqësim më të gjerë të rajoneve të INTOSAI-t.

Takimi i ardhshëm i Nënkomitetit 3 është planifikuar për në shtator 2014.

Iniciativa e INTOSAI-t për Zhvillim (IDI)

Iniciativa e INTOSAI-t për Zhvillim (IDI) mbështet rritjen e kapaciteteve të auditimit të anëtarëve të INTOSAI-t nëpërmjet veprimtarive si programet afatgjata të trajnimit rajonal, programet pilot dhe të partneritetit rajonal, si dhe seminaret e trajnimit dhe workshop-e, në fusha kyçe të auditimit të qeverisë.

Kryetari i Bordit Norvegjez të Audituesve të Përgjithshëm ka funksionin e kryetarit të bordit të IDI-t.

INCOSAI miraton mandatin dhe planin strategjik 2014 – 2018 të rishikuar të IDI-t.

INCOSAI i XXI-të miratoi planin strategjik të IDI-t për 2014-2018 dhe mandatin e tij të rishikuar. Mandati i rishikuar pasqyron rolin zgjeruar të IDI-t për të punuar në të gjitha qëllimet strategjike të INTOSAI-t dhe zëvendëson mandatin e mëparshëm të dhënë gjatë INCOSAI-t të XII-të në vitin 1986.

Përveç mbështetjes së zhvillimit të kapaciteteve të stafit organizativ dhe profesional, në këtë periudhë të planifikimit strategjik IDI do të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve institucionale të SAI-ve. IDI e ka përshkruar modelin e vet të ofrimit të shërbimeve dhe modelin e zhvillimit të kapaciteteve të SAI-ve në këtë dokument të planifikimit strategjik. Modeli i ofrimit të shërbimeve përshkruan qasjen e partneritetit të IDI-t, qasjet e tij për zhvillimin e kapaciteteve, përcaktimin e burimeve, financimin, si dhe parimet e tij bazë.

Modeli i zhvillimit të kapaciteteve të SAI-ve shpjegon botëkuptimin e IDI-t përsa i përket aspekteve dhe kuadrit për zhvillimin e kapaciteteve të SAI-ve. Objektivat dhe rezultatet e Sekretariatit të Donatorëve të INTOSAI-t, organizuar nga IDI që nga viti 2010, janë integruar në kuadrin e rezultateve të përbashkëta të përcaktuara nga IDI. Plani Strategjik është në dispozicion në faqen: http://www.idi.no.

Komiteti Këshillimor i IDI-t mblidhet në Pekin

Takimi për vitin 2013 i Komitetit Këshillimor të IDI-tu zhvillua në Pekin më 19 tetor, 2013 në prag të INCOSAI-t të XXI-të. Komiteti Këshillimor i IDI-t përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë grupet rajonale të INTOSAI-t dhe SAI-t që kanë kontribuar ndjeshëm në programet dhe aktivitetet e IDI-t, SAI-t e vendeve donatore të IDI-t, SAI-t që janë anëtarë të Bordit të IDI-t, si dhe SAI-t përgjegjës për Revistën Ndërkombëtare të Auditimit të Qeverisë. Ishin të ftuar gjithashtu edhe donatorët e IDI-t. U diskutuan aktivitetet e IDI-t gjatë Planit Strategjik 2007-2013. Diskutimet e tjera përfshinë aspektet kryesore të Planit të ri Strategjik 2013-2018, vlerësimin e jashtëm të IDI-t, dhe financimin e tij.

Komiteti Drejtues i Donatorëve i INTOSAI-t mblidhet në Pekin

Takimi i gjashtë i Komitetit Drejtues të Donatorëve të INTOSAI-t (KD) u zhvillua në Pekin më 18 dhe 19 Tetor 2013. Takimi u ndoq nga 76 përfaqësues të INTOSAI-t dhe të donatorëve. Thirrja globale për propozime e vitit 2013 u ndërmor në takim dhe KD rekomandoi krijimin e një grupi të punës për auditimin e industrive minerare. U miratua Plani i Punës për bashkëpunimin e Donatorëve të INTOSAI-t për vitin 2013. Kuadri i matjes së performancës së SAI-ve dhe trajnimi për donatorët të ndërlidhur me SAI-t, kanë qenë dy nga çështjet e tjera të diskutuara.

Bashkëpunimi IDI-CBC-Donatorët e INTOSAI-t gjatë INCOSAI-t

Delegatë të mbledhur në një nga sesionet "Tako me Ekspertin" të mbajtur në stendën e përbashkët IDI - CBC - Bashkëpunimi i Donatorëve i INTOSAI-t, gjatë INCOSAI XXI

Si në INCOSAI-n e kaluar, IDI dhe Komiteti për Ngritjen e Kapaciteteve i INTOSAI-t ngritën një stendë të përbashkët më 21 - 26 tetor 2013, në INCOSAI-n e XXI-të.

Literaturë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e kapaciteteve të SAI-ve, si për shembull detajet e produkteve të IDI-t dhe CBC-së, si dhe CD që përmbajnë materiale burimore të IDI-t dhe CBC-së, u shpërndanë në këtë stendë. Bisedime

ekspertësh dhe seanca takimesh me ekspertë u organizuan në gjuhë të ndryshme mbi një sërë temash si për shembull: ISSAI-t, Thirrja globale për Propozime, Kuadri i Matjes së Performancës së SAI-ve, Auditimet Kooperative dhe Përfshirja Qytetare.

Platforma e INTOSAI-t për bashkëpunim me OKB-në

Platforma e INTOSAI-t për bashkëpunim me Kombet e Bashkuara (OKB), e themeluar gjatë INCOSAI-t të XIX-të në Meksikë, kryesohet nga SAI i Republikës së Koresë. Qëllimi është që të koordinojë punën ndërmjet INTOSAI-t dhe OKB-së në fusha me interes të përbashkët.

A UN-INTOSAI Joint Project:

Collection of Important Literature on Strengthening Capacities of Supreme Audit Institutions on the Fight against Corruption

October 2013

Platforma ka realizuar projektin e saj të parë të përbashkët me Departamentin e OKB-së për Çështjet Ekonomike dhe Sociale (UNDESA) nën temën: "Rolet SAI-ve në luftën kundër korrupsionit". Projekti përbëhet nga dy faza: (1) që së bashku të publikojnë një koleksion të literaturës së rëndësishme në temën e kundër korrupsionin, dhe (2) të mbajnë një seminar me ekspertë të organizuar bashkërisht nga Platforma dhe UNDESA.

Faza e parë, botimi i përbashkët, ka përfunduar dhe titullohet një Projekti i përbashkët OKB -INTOSAI: Koleksion i Literaturës të rëndësishme mbi Forcimin e Kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit në luftën kundër korrupsionit.

Ky koleksion është botuar si në një libër dhe në format CD.

Libri përmban katër seksione:

- Koncepti i korrupsionit dhe udhëzime për të mbrojtur institucionet publike nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme të korrupsionit;

- Auditimi ligjor që merret me mashtrimet, korrupsionin dhe pastrimin e parave;
- Auditimet këshillimore dhe dhënia e këshillave për menaxhimin për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë;
- Angazhimi i qytetarëve në auditim për zbulimin dhe pengimin e korrupsionit.

Publikimi është në dispozicion online në:
http://www.intosai.org/documents/intosai/general/ publications-stand-xxi-incosai.html.

Seminari i përbashkët i ekspertëve pritet të mbahet në Seul, ndoshta në vitin 2015.

Raporti mbi Qëllimin 3: Shkëmbimi i Njohurive

Shashi Kant Sharma, Auditues dhe Kontrollor i Përgjithshëm i Indisë si dhe Kryetar i Komitetit për Shkëmbimin e Njohurive (KSC), paraqiti raportin e tij në Bordin Drejtues të INCOSAI XXI. Synimi i qëllimit 3 është të nxisë SAI-t të bashkëpunojnë, dhe përmirësojnë vazhdimisht shkëmbimin e njohurive. Kjo përfshin dhënien e standarteve, kryerjen e studimeve mbi praktikat më të mira dhe zhvillimin e kërkimit për çështje me interes dhe shqetësim të përbashkët. Për të përmbushur këtë qëllim, që prej INCOSAI XX, komiteti ka ndërmarrë veprimet si vijon:

■ Ka zhvilluar dokumentet e mëposhtme, të cilat u miratuan në INCOSAI XXI:

❍ Disa ISSAI (të renditura më poshtë në raportet e grupeve individuale të punës dhe task forcat)

❍ Ka komunikuar dhe promovuar Vlerat dhe Përfitimt e SAI-ve – një Udhëzues i INTOSAI-t

❍ Broshurën mbi Auditimin IT

❍ Udhëzuesit mbi treguesit kryesorë të performancës të metodologjisë për auditimin e programeve IT

■ Ka rekomanduar se Grupi i Punës mbi Auditimin e Ndihmës në rastet e Fatkeqësive të shpërbëhet dhe puna e Task Forcës mbi Të dhënat Informative për SAI-t, të shkrihet në Grupin e Punës për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve nën drejtimin e SAI-t të Meksikës. (të dy këto veprime u miratuan)

■ Ka propozuar formimin e një Task Force të re mbi Auditimin e Kontratave të Prokurimit dhe një Grup Pune të ri mbi Auditimin e Industrive Nxjerrëse. Bordi Drejtues miratoi krijimin e këtyre dy grupeve të reja

■ Përgatiti planin e tij të punës për 2014–2016 në linjë me Planin Strategjik të INTOSAI-t (2011–2016). Plani fokusohet në një rishikim dhe vlerësim të qëllimit të grupeve të punës dhe task forcave dhe rendit aktivitetet e ardhshme të PSC-së nën katër fusha kryesore:

❍ krijimin e grupeve të reja të punës dhe mbajtjen e atyre ekzistues

❍ lehtësimin e studimeve për praktikat e mira duke patur parasysh shumëllojshmërinë dhe autonominë

❍ nxitjen për komunikimin efektiv në INTOSAI

❍ promovimin e partneritetit me institucionet akademike, të kërkimit dhe shoqatat profesionale, në varësi të kërkesave të INTOSAI-t për pavarësinë.

Anëtarë të Komitetit për Qëllimin 3, mbledhur në Pekin, 20 Tetor 2013

Z. Sharma raportoi se qëllimi i faqes së internetit të KSC-së (http://www.intosaiksc.org) është që të funksionojë si një qendër depozitimi njohurish për të ndihmuar audituesit të forcojnë ekspertizën e njerëzve në INTOSAI. Ai nxiti komunitetin INTOSAI ta shfrytëzonte plotësisht këtë faqe.

Në vijim të raportit të z.Sharma, grupet e punës së KSC-së dhe task forcat, raportuan mbi qëllimet dhe arritjet e tyre. Pjesa në vazhdim përmbledh aktivitetet dhe arritjet e tyre.

Grupi i Punës për Borxhin Publik

Juan Manuel Portal, Auditues i Përgjithshëm i Meksikës drejton Grupin e Punës për Borxhin Publikt (WGPD). WGPD fokusohet në dhënien për INTOSAI-n të njohurive, nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të udhëzuesve dhe materialeve të tjera, të nxitjes së raportimit dhe menaxhimit të mirë të borxhit publik.

Grupi përfshin anëtarët si vijon: Argjentinë, Austria, Brazili, Bullgaria, Kili, Kina, Egjipti, Fixhi, Finlanda, Gaboni, India, Indonezia, Jordania, Republika e Koresë, Lituania, Meksika (drejtuese), Moldavia, Portugalia, Rumania, Rusia, Suedia, Ukraina, SHBA dhe Zambia.

Z. Portal raportoi mbi aktivitetet e grupit të punës që prej INCOSAI –t të fundit duke theksuar bashkëpunimin e WGPD me organe të tjera të INTOSAI-t. Puna e IDI-t në borxhin publik, në veçanti Programi Transrajonal për Ngritjen e Kapaciteteve për Menaxhimin e Borxhit Publik, ka forcuar kapacitetet institucionale të SAI-ve dhe ka kontribuar në promovimin e menaxhimit dhe auditimit të mirë të borxhit publik. Në vitin e kaluar, WGPD miratoi propozimin e sugjeruar nga IDI, për të parë bashkërisht, mundësinë e zhvillimit të programit për ngritjen e kapaciteteve fokusuar në auditimin e kuadrit ligjor për huatë publike.

Një tjetër përpjekje bashkëpunuese ishte takimi i prillit 2012 në Washington D.C. me ish-Task Forcën për Krizën Globale Financiare. Takimi promovoi bashkëpunimin dhe analizën lidhur me çështjet për borxhin publik. Me një

mision të ndarë për të promovuar masat si për parandalimin e krizave financiare në të ardhmen, si për të zbutur impaktin e tyre, veçanërisht në vendet në zhvillim, u ra dakort që WGPD do të konsolidohej si një forum për shkëmbimin e mësimeve të mësuara nga praktikat më të mira për auditimin e qeverisjes lidhur me borxhin publik.

Z. Portal gjithashtu, raportoi edhe mbi progresin e dy projekteve të WGPD. I pari, drejtuar nga Brazili, vlerëson sistemet e informacionit lidhur me menaxhimin e borxhit publik. I dyti, drejtuar nga SAI i Meksikës, merret me çështjet lidhur me menaxhiminn e shërbimeve të borxhit. Anëtarët e WGPD komentuan mbi të dy dokumentet, të cilat janë miratuar nga drejtuesi i Komitetit Drejtues të Qëllimit 3. Kërkimi i kryer nga SAI i Brazilit është klasifikuar si ISSAI 5450 edhe është paraqitur për komente. Ai do të paraqitet për miratimin përfundimtar në INCSOSAI XXII.

Në vijim, SAI i Kanadasë, drejtoi një hetim mbi impaktin që ka mbështetja nga qeveria gjatë krizave financiare, mbi borxhin publik, dhe roli i mundshëm i SAI-ve. Ky dokument iu paraqit ish- Task Forcës mbi Krizat Globale Financiare si kontribut i WGPD-së për punën e kësaj task force. Dokumenti analizonte qëndrueshmërinë financiare afat-gjatë në lidhje me detyrat rregullatore të qeverisë.

SAI-t e Ukrainës dhe të SHBA studjuan borxhin e papërcaktuar dhe impaktin e krizave financiare mbi borxhin publik, respektivisht. Të dy analizat u përfunduan vitin e kaluar dhe janë referencë për kërkimet e ardhshme të WGPD. Studimi i SAI-t të Ukrainës kontribuoi në hartimin e propozimit për të zbatuar inisiativën e menaxhimit të sistemeve informative në auditimet e koordinuara paralele të borxhit publik dhe të auditimeve për borxhin publik.

Grupi i Punës për Auditimin IT

Misioni i këtij Grupi Pune WGITA, është të mbështesë SAI-t në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në përdorimin dhe auditimin e IT.

WGITA ka këta anëtarë: Antigua dhe Barbuda, Australia, Bangladeshi, Barbados, Butani, Brazili, Brunei Darussalam, Kamboxhia, Kina, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, Ekuadori, Franca, India (drejtuese), Indonezia, Irani, Iraku, Izraeli, Xhamajka, Japonia,

Kiribati, Kuvajti, Lituania, Malajzia, Norvegjia, Omani, Pakistani, Peruja, Polonia, Katari, Republika e Koresë, Rusia, Republika Sllovakisë, Sllovenia, Afrika e Jugut, Zvicra, Britania, SHBA dhe Zimbabve.

Që prej INCOSAI XX, WGITA ka zhvilluar tre takime dhe seminarin e shtatë mbi auditimin e performancës. Në këto takime, diskutimet janë fokusuar në rolin e SAI-t në promovimin e politikave për përmirësimin e IT dhe forcimin e politikave të vlerës së parasë, si dhe në promovimin e mbikqyrjes së SAI-ve dhe qeverive për IT.

Aktivitetet e WGITA mund të grupohen në tre kategori kryesore: shkëmbim informacioni, zhvillim i njohurive dhe aftësive, si dhe zhvillim dhe transferim i njohurive.

Shkëmbimi i informacionit: Platformat kryesore për shkëmbimin e informacionit janë revista e WGITA-s "intoIT", faqja e internetit (http://www.intosaiitaudit.org); dhe seminaret tre-vjeçare të auditimit të performancës. Departamenti Kombëtar i Auditimit të Malajzisë, kujdeset për faqen e internetit dhe publikon revistën intoIT.

Zhvillimi i Njohurive dhe Aftësive: WGITA po bashkëpunon me IDI-n dhe AFROSAI-E, për të forcuar kapacitetet e auditimit IT të SAI-ve në këtë rajon. Produkti i këtij bashkëpunimi është një program mbi auditimin e IT që mbulon fushat si teknike ashtu dhe të auditimit dhe fokusohet në stafin e SAI-t të angazhuar për të kryer këto auditime.

Zhvillimi dhe Transferimi i Njohurive: WGITA përmbushi me sukses pesë projektet kërkimore si vijon lidhur me planin e punës për 2011–2013:

■ Treguesit kryesorë të metodologjisë së performancës për auditimin e programeve IT

■ Planifikimin e auditimit IT dhe procedura auditimi të detajuara për të rishikuar kontrollet IT

■ Optimizimin e vlerave IT në organizatat qeveritare

■ IT Jeshil

■ Cloud computing (software) dhe Virtualizimi

WGITA dhe IDI përgatitën udhëzues të kuptueshëm IT në formën e broshurës për auditimin IT, që u prezantua për miratim në INCOSAI XXI.

Bazuar në anketën IT dhe diskutimet në takimin e 22 të WGITA në Vilnius, Lituani, në prill 2013, pesë projektet si vijon u identifikuan për planin e punës 2014–2016:

■ Qeverisja IT

■ Tërheqja e të dhënave si mjet për hetimin e mashtrimit

■ Zhvillimi i standarteve për sistemet informative shtetërore dhe auditimet projekt

■ Zhvillimi i një kufiri standart të dhënash për llogaritjen e software

■ Zhvillimi i ISSAI 5300: Udhëzues mbi Auditimin IT dhe përditësimi i ISSAI 5310: Metodologjia e Rishikuar e Sigurisë së Sistemit Informativ

Projektet më lart, duhet të përmbushen deri në INCOSAI-n e XXII në 2016.

Grupi i Punës për Auditimin e Mjedisit

SAI i Indonezisë pasoi SAI-n e Estonisë si drejtues i Grupit të Punës për Auditimet e Mjedisit (WGEA), grupi më i madh ndër grupet e punës të INTOSAI-t, gjatë INCOSAI XXI. Ky grup është i angazhuar të përdorë pushtetin e auditimit të sektorit publik, për të lënë një trashëgimi për brezat e ardhshëm, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe shëndetin dhe prosperitetin e njerëzve në të gjithë botën.

WGEA përfshin anëtarët si vijon: Algjeria, Argjentina, Armenia, Australia, Azerbaixhan, Bangladeshi, Butani, Brazili, Bullgaria, Kameruni, Kanadaja, Kili, Kina,

Kolumbia, Kosta Rika, Qipro, Republika Çeke, Egjipti, El Salvadori, Estonia, Etiopia,



ECA, Fixhi, Finlanda, Gjeorgjia, Greqia, Guajana, Islanda, India, Indonezia (drejtuese), Irani, Jordania, Kazakistani, Kenia, Kuvajti, Letonia, Lesoto, Libia, Lituania, Malta, Meksika, Mongolia, Maroku, Hollanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Omani, Pakistani, Paraguai, Peruja, Filipinet, Polonia, Katari, Republika e Koresë, Rumania, Rusia, Samoa, Arabia Saudite, Republika e Sllovakisë, Sllovenia, Afrika e Jugut, Sri Lanka, Tanzania, Tailanda, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Tonga, Turqia, Ishujt Turk dhe Kaikos, Uganda, Ukraina, Britania, SHBA, Zambia dhe Zimbabve.

Gjatë tre viteve të fundit, WGEA zhvilloi dhe miratoi dokumentet kërkimore dhe materialet udhëzuese si vijon:

■ Praktikat e Përdorimit dhe Menaxhimit të Tokës në Perspektivën Mjedisore (Maroku)

■ Të dhënat Mjedisore: Burimet dhe Alternativat për SAI-t (Kanadaja dhe SHBA)

■ Raportimi i Qëndrueshëm—Konceptet, Kuadret dhe Roli i SAI-ve (Finlanda)

■ Çështjet Mjedisore Lidhur me Zhvillimin e Infrastrukturës (Britania)

■ Impakti i Turizmit në Ruajtjen e Florës dhe Faunës (Lesoto)

■ Auditimi i Çështjeve të Ujit: Një Ekzaminim i Eksperiencave të SAI-ve dhe Mjetet e Metodologjisë të përdorura me sukses (dokumenti i përditësuar i 2004)

■ Çështjet mbi Mashtrimin dhe Korrupsionin kur Auditohet Mjedisi dhe Menaxhimi i Burimeve Natyrore: Udhëzues për SAI-t (Norvegjia)

Këto publikime gjenden online në http://www.environmental-auditing.org/Home/WGEAPublications/StudiesGuidelines/tabid/128/

Në vijim, tre module të reja trajnimi mbi ndryshimet klimaterike, pyllëzimin dhe minierat, u zhvilluan bazuar në materialet udhëzuese ekzistuese të WGEA-s. Sekretariati gjithashtu promovoi mjetin e mësimit elektronik për ndryshimet klimaterike (SAI i Norvegjisë) i aksesueshëm nëpërmjet faqes së internetit (http://www.environmental-auditing.org). Sekretariati i WGEA dhe SAI i SHBA vazhduan të bashkëpunojnë për publikimin e revistës së WGEA-s "Greenlines".

Sekretariati organizoi dy përmbledhje vjetore të auditimeve mjedisore në mbarë botën në 2011 dhe 2012 për të përditësuar të dhënat globale të auditimit që gjenden në faqen e internetit të WGEA-s. Përafërsisht 450 auditime iu shtuan kësaj liste të dhënash.

WGEA inkurajon rajonet të hartojnë dhe zhvillojnë auditime të përbashkëta rajonale në secilin rajon të INTOSAI-t. Koordinatorët rajonalë dhe SAI-t anëtare identifikuan dhe ndoqën çështjet me interes të përbashkët, përzgjodhën koordinatorët e auditimeve dhe përcaktuan qëllimin e saktë dhe formën e bashkëpunimit në të pesë rajonet.

SAI i Indisë u ofrua që në bashkëpunim me drejtuesin e WGEA-s të përcaktohej një trajnim global për audituesit e mjedisit. Të dy SAI-t bashkëpunuan me një nën-grup projekti në përgatitjen e kursit të parë trajnues të WGEA-s, të mbajtur në nëntor – dhjetor 2013 në Jaipur, në qendrën e iCED të trajnimit të SAI-t të Indisë.

Që prej INCOSAI-t të fundit, WGEA ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare dhe organe të tjera të INTOSAI-t. Ka kontribuar dhe ka marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm

(Rio +20) ashtu si edhe në Programin Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP) në Kongresin Botëror mbi Drejtësinë, Qeverisjen dhe Ligjin për Qëndrueshmërinë Mjedisore.

UNEP ka propozuar gjithashtu firmosjen e memorandumit të mirëkuptimit me WGEA për të forcuar më tej bashkëpunimin në fushën e qeverisjes së mjedisit, me theks të veçantë në marrëveshjet multilaterale për mjedisin.

Përfundoi gjithashtu, Programi Trans-rajonal mbi Ngritjen e Kapaciteteve në Auditimet e Çështjeve të Performancës Mjedisore në Pyje nga IDI-WGEA. 50 SAI nga AFROSAI, ASOSAI, dhe CAROSAI morën pjesë, secili duke përmbyllur një auditim mbi pyjet, në një prej gjashtë tematikave.

WGEA zhvilloi anketën e shtatë mbi auditimet mjedisore të organizuar nga Sekreatariati. Përgjigjet nga 118 SAI u analizuan dhe u përdorën në përgatitjen e planit të punës së WGEA-s për 2014–2016.

Plani propozon qëllimet si vijon:

■ Përditësimin dhe zhvillimin e materialeve udhëzuese ekzistuese të mundshme për SAI-t dhe kryerjen e studimeve kërkimore mbi çështje emergjente të auditimit të mjedisit

■ Mundësinë e auditimeve konkurrente, të përbashkëta dhe koordinuara

■ Rritjen e shpërndarjes së informacionit, shkëmbimin dhe trajnimin

■ Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet WGEA-s, organizatave ndërkombëtare dhe organeve të tjera INTOSAI

Grupi i Punës për Vlerësimin e Programeve

Grupi i Punës për Vlerësimin e Programeve ndihmon SAI-t që praktikojnë apo dëshirojnë të praktikojnë vlerësimin duke dhënë udhëzues, mjete metolodogjie dhe rekomandime praktike për të zbatuar këtë metodë specifike, e cila ndryshon nga forma të tjera të kontrollit dhe auditimit. Grupi i punës ka këta anëtarë:

Belgjika, Kili, Kosta Rika, El Salvadori, Finlanda, Franca, (drejtuese), Gaboni, Gjeorgjia, Republika e Koresë, Gjermania, Kenia, Libia, Lituania, Meksika, Maroku, Pakistani, Papua Guinea e Re, Filipinet, Polonia, Zvicra dhe SHBA.

Në 2012, grupi i punës anketoi SAI-t mbi praktikat e tyre më të mira dhe metodologjtë e vlerësimit. Rezultatet u ndanë me KSC. Gjithashtu, në 2012, grupi i punës vendosi të fokusonte punën e tij në përmirësimin e koncepteve vlerësuese, identifikimin e shembujve instruktiv për SAI-t dhe përgatitjen e udhëzuesve të detajuar të metodologjisë duke ofruar një gamë të gjerë burimesh dhe rekomandimesh për nxjerrjen e vlerësimeve.

Në 2013, Nënkomiteti për Auditimet e Performancës pranoi propozimin për të koordinuar punën me këtë grup pune në nivelet e ISSAI-ve 3000 dhe 3100 për auditimin e performancës. SAI i Brazilit, kryesues i nënkomitetit për auditimet e performancës, mori pjesë në takimin e qershorit 2013 të grupit të punës, ku lidhjet ndërmjet standarteve profesionale për auditimet e performancës dhe udhëzuesi për vlerësimin e metodologjisë së planifikuar, u diskutuan.

Pjesëmarrësit dolën me përfundimin se dallimi ndërmjet një vlerësimi dhe një auditimi performance nuk është i lehtë për t'u përcaktuar, duke qenë se të dy metodat synojnë të masin performancën – varet në një shkallë të gjerë në praktikat e secilit SAI.

Në vijim, ka ende nevojë për të zhvilluar dhe shpërndarë udhëzuesin e propozuar.

Në takim, grupi i punës gjithashtu ndryshoi dhe konfirmoi dokumentin e grupit përgatitor të punës për udhëzuesin e shpërndarë në prill 2013.

Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave

Grupi i Punës për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave (WGFACML) promovon bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin. Grupi gjithashtu ka për qëllim të identifikojë dhe të shkëmbejë politikat dhe strategjitë për luftën kundër pastrimit të parave në kuadër të kompetencave dhe autoritetit të SAI-ve, dhe të hartojë dhe promovojë politikat, strategjitë dhe veprimet brenda kuadrit ligjor ndërkombëtar të çdo SAI kundër pastrimit të parave.

WGFACML përbëhet nga këta anëtarë: Austria, Kili, Kinë, Kolumbi, Republika Çeke, Ekuador, Egjipt (karrige), Fixhi, Gjermania, Indonezia, Irani, Iraku, Malajzia, Meksika, Namibia, Papua Guinea e Re, Peru, Polonia, Federata Ruse, Trinidad dhe Tobago, Emiratet e Bashkuara Arabe, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara, dhe Jemen.

Objektivi i parë në planin e punës të grupit të 2011-2013 ishte që të zhvillohen udhëzime që mbështesin përpjekjet e tij për të zbuluar dhe për të luftuar korrupsionin dhe pastrimin e parave. Tre nëngrupe janë themeluar për të kryer këtë detyrë dhe ata kanë prodhuar dokumentet në vijim:

- INTOSAI GOV 9160: Përmirësimi i Mirë Qeverisjes së Aseteve Publike. Miratuar nga KSK-së, Komiteti i Standardeve Profesionale dhe WGFACML dhe është i hapur ndaj komenteve.
- ISSAI 5700: Auditimi i Parandalimit të Korrupsionit të Agjencive Qeveritare. Miratuar nga KSK-së, Komiteti i Standardeve Profesionale dhe WGFACML dhe është i hapur për komente.
- Sfidat që ndeshin SAI-t në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave. Ky udhëzues është hartuar dhe është dorëzuar në takimin e WGFACML në qershor 2013.

Një projekt i INTOSAI GOV 9160 është në dispozicion në http://www.issai.org/intosaiguidance-for-good-governance-(INTOSAI-gov)/ dhe

një projekt i ISSAI 5700 është në dispozicion në http://www .issai.org/media/13320/issai_5700_exposure_draft.pdf.

Objektivi i dytë ishte zhvillimi, projektimi dhe sigurimi i programeve trajnuese dhe seminareve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.WGFACML identifikoi partnerët kryesorë ndërkombëtarë (Grupi i Integriteti të Tregut Financiar të Bankës Botërore dhe Grupi Egmont) me të cilët ai mund të bashkëpunojë dhe të zhvillojë kanalet e komunikimit. Ai bashkëpunoi me IDI-n, i cili aprovoi fillimin e programeve të trajnimit pas miratimit të udhëzimeve.

Objektivi i tretë ishte bashkëpunimi me Grupin e Punës për Auditimin e Mjedisit Auditimit (WGEA) për të hartuar një udhëzues për çështjet e korrupsionit dhe mashtrimit në fushën e auditimit mjedisor. Dy grupe pune kanë marrë pjesë në mbledhjet e njëri-tjetrit dhe një dokument në këtë temë u përgatit dhe u botua në faqen e internetit WGEA.

Objektivi i katërt ishte zhvillimi i një bazë të dhënash që harton studime të rasteve dhe përvojave të SAI-ve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.WGFACML ka propozuar që kjo të bashkëpunojë me Task Forcën për Bazat e të Dhënave të SAI-ve në këtë fushë për të shmangur mbivendosje dhe dyfishimine.

Plani i punës i WGFACML-së për 2014-2016 përfshin tema të reja dhe qëllime të vazhdueshme nga plani i punës 2011-2013. Ai përmban katër qëllime:

- Bashkëpunimi me SAI-t në finalizimin dhe zhvillimin e udhëzimeve që mbështesin përpjekjet e tyre në zbulimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- Nxitja e ndërtimit të kapaciteteve për profesionistët e SAI-ve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- Kryerja e auditimeve bashkëpunuese të korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe përvojave të SAI-ve në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.

WGFACML po bashkëpunon gjithashtu me Platformën e INTOSAI-t për bashkëpunim me Kombet e Bashkuara për të përgatitur një dokument mbi forcimin e kapaciteteve të SAI-ve për të luftuar korrupsionin dhe për të ruajtur financimin për një zhvillim të qëndrueshëm.

Materialet me praktikat e auditimit kundër pastrimit të parave mund të gjenden në faqen e internetit të WGFACML http://www.wgfacml.cao.gov.eg/.

Grupi i Punës mbi Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmave të Fatkeqësive

Gijs de Vries, Kryetar i Grupit të Punës për Përgjegjshmërinë dhe Auditimin e Ndihmave të Fatkeqësive (WGAADA) dhe anëtar i Gjykatës Evropiane të Audituesve prezantoi raportin përfundimtar të WGAADA i cila ka përfunduar punën e tij dhe për pasojë po shpërbëhet.

Pas krijimit të tij në vitin 2005 në prag të cunamit 2004 në Azi, WGAADA-së iu dha mandati për të (1) gjetur për përgjegjësi të zgjeruara dhe transparencë në ndihmat në raste fatkeqësish, në bashkëpunim të ngushtë me grupet përkatëse të interesit duke trajtuar çështjen e mungesës së një strukture të vetme të informacionit dhe (2) hartuar udhëzimet dhe praktikat më të mira të auditimit të ndihmave në raste fatkeqësish për SAI-t. Mandati i tij u zgjerua në vitin 2010 për të adresuar auditimet e të gjitha ndihmave humanitare.

WGAADA ka punuar ngushtë me aktorët kryesorë dhe organet e vendosjes së standardeve për të kryer mandatin e tij. Ai prezantoi pikat e mëposhtme në INCOSAI:

- Pesë seri të reja të ISSAI-ve 5500 për auditimin e ndihmave gjatë fatkeqësive, duke përfshirë edhe shembuj të praktikave të mira të ofruara nga SAI-t që ishin anëtarë të WGAADA ose që kanë marrë pjesë në auditime të koordinuara, sondazhe apo konsultime të gjera për auditimin e ndihmave gjatë fatkeqësive.
- INTOSAI GOV 9250 i cili paraqet kuadrin e përgjegjshmërisë së Integruar Financiare (IFAF) për raportimin dhe publikimin transparent të informacionit në dispozicion në lidhje me materialet financiare të ndihmave humanitare të audituara.

Me shkrirjen e WGAADA informacioni mbi punën e tij do të postohet në faqen e internetit të Komisionit për Ndarjen e Njohurive duke klikuar në linkun " Disbanded Working Groups/Task Forces" në faqen kryesore. Më tej për zbatimin e suksesshëm të INTOSAI GOV 9250, SAI i Indisë do të sigurojë një forum për t'u mundësuar prodhuesve dhe përdoruesve të pasqyrave IFAF të shkëmbejnë përvojat e tyre.

Grupi i Punës mbi Treguesit Kryesorë Kombëtarë

Grupi i Punës mbi Treguesit Kryesorë Kombëtarë (KNI) përfshin anëtarët e mëposhtëm: Austria, Bullgaria, Kina, Danimarka, Finlanda, Hungaria, Izrael, Itali, Kazakistani, Letonia, Lituania, Meksika, Zelanda e Re, Pakistani, Polonia, Federata Ruse (kryesuesi), Republika Sllovake, Zvicra, Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara.

Grupi ka përgatitur produktin e tij bazë metodologjik, një dokument të bardhë mbi KNI që ofron udhëzime për SAI-t për përdorimin e tyre gjatë auditimeve strategjike dhe kur krahasojmë programet kombëtare, sektoriale dhe rajonale të zhvillimit social dhe ekonomik. Grupi i punës është konsultuar me Komitetin e Standardeve Profesionale për transformimin e mundshëm të dokumentit të bardhë në një ISSAI.

Grupi i punës gjithashtu përfundoi disa nënprojekte të 2011-2013. Këto ishin (1) një analizë e mundësive për të përdorur KNI për krahasime ndërkombëtare në

kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përgatitjen e rekomandimeve të duhura (të koordinuara nga SAI i Hungarisë) dhe (2) roli i SAI-ve në zhvillimin dhe përdorimin e treguesve kryesor per kërkim dhe zhvillim të vlerësimit (të koordinuar nga SAI i Finlandës). Letrat e diskutimit të përgatitura për këto nën-projekte duhet të paraqiten për miratim në mbledhjen e ardhshme të grupit të punës në shkurt 2014 dhe do të përfshihen në dokumentin e bardhë bardhë mbi KNI si shtojca. Një dokument mbi parimet për zhvillimin dhe përdorimin e KNI gjithashtu do të paraqitet në mbledhjen e ardhshme të grupit të punës.

Gjatë tre viteve të fundit Sekretariati i grupi i punës ka rritur përpjekjet e tij bashkëpunuese me Departamentin e Statistikës së Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Ai ka studjuar mundësitë e aplikimit të "Better Life Index" të OECD-së në auditimin publik. Duke përdorur këtë indeks të përbërë mund të identifikohen fushat prioritare për zhvillim, mund të merret në konsideratë opinioni publik për rëndësinë e sferave të ndryshme të jetës në shoqëri, si dhe mund të monitorohet ndikimi i gjetjeve në mirëqenien e përgjithshme të një vendi të veçantë.

Sekretariati i Grupit të punës gjithashtu po studion mundësinë e ndërveprimit praktik me Institutin Ndërkombëtar për Analizë e Sistemeve të Aplikuara (IIASA) veçanërisht në lidhje me problemin e zhvillimit të metodave efikase per të analizuar pabarazitë globale.

Punë e rëndësishme ka përfunduar në zhvillimin e njohurive bazë mbi KNI. Janë shtuar disa paketa të reja informacioni, duke përfshirë Perspektivën Ekonomike Globale të Bankës Botërore të të Dhënave të Parashikuara dhe të Dhënave nga Raporti i Konkurueshmërisë Globale të Forumit Ekonomik Botëror.

Grupi i punës ka përgatitur dhe miratuar planet e tij të punës per 2013-2016. Ai ka identifikuar prioritetet e mëposhtme:

- Kryerja e një auditimi pilot duke përdorur tregues të qëndrueshëm kryesorë të zhvillimit gjatë vlerësimit të strategjive kombëtare (rajonale) të zhvillimit;

- Të mbledhë, sistemojë dhe analizojë KNI të vendeve të SAI-ve të cilëve formojnë grupin e ekspertëve të Grupit të Punës;
- Të zhvillojë qasje dhe metoda të mbajtjes së trajnimeve për punonjësit e SAI-ve mbi përdorimin e KNI në aktivitetet e kontrollit;
- Të vazhdojë të kryejë nënprojektet e grupit ekspert mbi KNI e SAI-ve të Bashkësisë së Vendeve të Pavarura;
- Të vazhdojë të zhvillojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare;
- Të mbështesë funksionimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive bazë mbi KNI;
- Të zhvillojë teknologjitë e informacionit të nevojshme për të zgjedhur dhe vlerësuar zhvillimin socio-ekonomik të KNI;

Të gjitha informatat mbi aktivitetin e grupit të punës (duke përfshirë dokumentet, vendimet, rezultatet e nën-projekteve, planeve dhe raporteve) janë në dispozicion në faqen e tij në http://www.ach.gov.ru/en/intosaikni/.

Grupi i Punës mbi Vlerën dhe Përfitimet e SAI-ve

Grupi i Punës mbi Vlerën dhe Përfitimet e SAI-ve (WGVBS) përbëhet nga këta anëtarë: Austria, Bahreini, Kamboxhia, Kamerun, Kanada, Kina, Franca, Gjermania, Xhamajka, Meksika (kryesuesi), Namibia, Peru, Federata Ruse, Afrika e Jugut, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Terence Nombembe, Audituesi i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut dhe ish-kryetar i WGVBS, raportoi për progresin e bërë që nga INCOSAI XX. Në atë kohë, grupit të punës iu dha mandati për të zhvilluar projektet e mëposhtme:

- ISSAI 12 Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit per miratim përfundimtar nga INCOSAI XXI;
- Një kuadër i vetëm global për matjen e performancës së SAI-ve;
- Një udhëzues për të komunikuar dhe promovuar vlerën dhe përfitimet e SAI-ve dhe ndërveprimin me qytetarët;
- Një udhëzues mbi praktikat efektive të bashkëpunimit mes SAI-ve, legjislativit,gjyqësorit dhe ekzekutivit;

Në kryerjen e këtij mandati WGVBS ka zhvilluar dhe prezantuar dy dokumentet e mëposhtme për miratim në INCOSAI XXI:

- ISSAI 12: Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit Përfitimet në jetën e qytetarëve;
- Komunikimi dhe Promovimi i Vlerës dhe Përfitimet e SAI-ve - Një Udhëzim i INTOSAI-t.

Të dy dokumentet janë miratuar nga INCOSAI XXI dhe janë në dispozicion online në http://www.intosai-wgvbs.org/Admin/Docdeveloped.aspx

WGVBS po punon për hartimin e dy dokumenteve thelbësore të mbetur, të cilët do të finalizohen për miratim në INCOSAI XXII në vitin 2016:

- Kuadri i Matjes së Performancës të SAI-ve (PMF);
- Udhëzuesi mbi praktikat efektive të bashkëpunimit mes SAI-ve, legjislativit, gjyqësorit dhe ekzekutivit.

Nga pikëpamja e marrëdhënieve të ngushta midis Task Forcës mbi Bazën e të dhënave të Informacionit të SAI-ve dhe të WGVBS u propozua që të dy grupet të bashkojnë aktivitetet e tyre dhe të bëhet një grup pune nën drejtimin e SAI-t të Meksikës. Informacionet mbi punën e WGVBS janë në dispozicion në faqen (http://www.intosai-wgvbs.org).

Grupi i Punës mbi Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore

Në vitin 2012, Bordi Drejtues themeloi këtë grup pune për transformimin e Task Forcës mbi krizën globale financiare (e themeluar në vjeshtë të vitit 2008 për të shqyrtuar çështje të lidhura me krizën globale financiare), në një grup të përhershëm. Në miratimin e transformimit, Bordi Drejtues pranoi se komuniteti i INTOSAI-t duhet të vazhdojë të ndërtojë ekspertizën dhe aftësitë e tij për të përmbushur sfidat që lidhen me mbikëqyrjen e sistemit të tanishëm dhe të ardhshëm global financiar.

Grupi përbëhet nga këta anëtarë: Austria, Brazili, Kanadaja, Kili, Kinë, Qiproja, Estonia ECA, Finlandë, Francë, Hungari, Indonezia, Italia, Japonia, Meksika, Maroku, Hollanda, Polonia, Republika e Koresë Federatës Ruse, Arabia Saudite, Spanja, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara (kryesuesi) dhe Venezuela.

Grupi i punës ka për qëllim të ndihmojë SAI-t në adresimin e këtyre sfidave (1) duke zhvilluar mjetet dhe mundësitë për ndarjen e njohurive per vlerësimin e reformave kombëtare (2) duke krijuar mekanizma për shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e reformave ndërmjet INTOSAI-t dhe organizatave ndërkombëtare dhe (3) duke ndjekur në mënyrë sistematike informacionin në lidhje me reformat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Që prej formimit grupi i punës ka zhvilluar dhe miratuar termat e referencës, ka organizuar anëtarët e saj në nëngrupe dhe ka filluar hartimin dhe kryerjen e detyrave të auditimit. Nëngrupi 1 (mjetet e auditimit) po mbledh dhe përmbledh informacione mbi autoritetet dhe aftësitë e SAI-ve për të kryer auditime financiare rregullatore duke identifikuar udhëzime të tjera të rëndësishme dhe mjetet per kryerjen e këtyre auditimeve dhe sigurimin e asistencës teknike për SAI-t sipas nevojës, në baza joformale.

Nëngrupi 2 (networking) po identifikon organizatat përkatëse ndërkombëtare të përfshira në përpjekjet e modernizimit dhe reformës financiare, duke hartuar një listë të pikave të mundshme të kontaktit në çdo organizatë dhe për të krijuar

lidhje me to me qëllim diskutimin e mekanizmave të mundshme per ndarjen e informacionit. Një nga qëllimet e këtij nëngrupi është që të zhvillojë marrëdhënie me organizatat përkatëse ndërkombëtare për të mbledhur në mënyrë periodike informacion mbi atë që dihet në lidhje me risqet e reja rreth e rrotull globit.

Nëngrupi 3 (përpjekjet për reforma) po identifikon dhe mbledh informacion mbi natyrën, fushëveprimin, dhe gjendjen e zbatimit të modernizimit financiar dhe reformat rregullatore të ndërmarra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe po sintetizon informacionin për të identifikuar boshllëqet e mundshme që mund të kërkojnë vëmendjen shtesë rregullative.

Në vitin e ardhshëm grupi i punës do të mbajtë anëtarët e INTOSAI-it të informuar në lidhje progresin e tij dhe do të përqëndrohet në vazhdim për të zbatuar planet e punës të zhvilluara për të tre objektivat.

Task Force mbi Bazën e të Dhënave të Informacionit të SAI-ve

Task Force mbi Bazën e të Dhënave të Informacionit të SAI-ve është krijuar në INCOSAI XX për të mbledhur dhe ruajtur në mënyrë sistematike informacion të dobishëm rreth SAI-t në një bazë të dhënash të sigurt dhe të centralizuar, duke vendousr këtë informacionit në dispozicion të anëtarëve të INTOSAI-t dhe duke e mbajtur atë përditësuar për përdorim në të ardhmen. Juan M. Portal, Audituesi i Përgjithshëm i Meksikës dhe kryetar i grupit të punës, ka raportuar për aktivitetet e grupit të punës dhe arritjet kur ai përfundoi mandatin e tij tre-vjeçar. Grupi i Punës mbi Vlerën dhe Përfitimet e SAI-ve do të përcjellë aktivitetet që lidhen me mjetet elektronike dhe zhvillumin e task forcës.

Grupi i punës ka zhvilluar një studim gjithëpërfshirës që do të plotësohet nga komuniteti INTOSAI për të shumuar bazën e të dhënave. Ajo është në dispozicion në katër gjuhët zyrtare të INTOSAI-së: anglisht, frëngjisht gjermanisht dhe spanjisht. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga anëtarët e INTOSAI-t do të jenë në dispozicion për publikun e gjerë me përjashtim të seksionit mbi kapacitetet, njohuritë dhe shkëmbimin e informacionit të SAI-ve, i

cili do të jetë në dispozicion vetëm për anëtarët e INTOSAI-it në funksion të natyrës së tij të ndjeshme (shkëmbimi i informacionit, asistenca, shërbimet e njohurive dhe aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve midis anëtarëve të INTOSAI-it).

Grupi i punës ka përfunduar fazën e parë të zhvillimit të projektit. Ai ka projektuar një mjet elektronik të thjeshtë për përdoruesit me karakteristikat e mëposhtme:

- Një ndërfaqe në dispozicion në pesë gjuhë të INTOSAI-t;
- Qasje publike me përjashtim të modulit në lidhje me kapacitetet e SAI-t;
- Njohuri dhe shkëmbimi i informacionit i cili do të jetë i mundshëm vetëm për komunitetin INTOSAI;
- Akses i kontrolluar me fjalëkalim për bazën e të dhënave;
- Qasje të pakufizuar për përdoruesit për të përfunduar studimet ndërkohë që ata marrin informacionin e kërkuar;
- Një dizajn i ngjashëm me faqen e internetit të INTOSAI për të lehtësuar përdorimin e tij;
- Një bar progres dhe një kod me ngjyra për të identifikuar në mënyrë të qartë module të paplota dhe pyetje;
- Ruajtje automatike e informacionit të futur nga ana e përdoruesit;
- Një vrojtim i përgjigjeve të pyetësorit për t'i dhënë mundësinë përdoruesve për të vërtetuar informacionin e dhënë;

Z. Portal raportoi se grupi i punës i kishte dhënë akses komunitetit të INTOSAI-t për t'u futur te mjeti elektronik i bazës së të dhënave në gjysmën e dytë të shtatorit 2013, duke mundësuar që SAI-t t'i përgjigjeshin sondazhit brenda 60 ditëve. Ai gjithashtu deklaroi se grupi i punës, po testonte funksionalitetet bazë të mjetit për të parandaluar çdo çështje operative dhe teknike para fillimit të fazës së dytë të zhvillimit, që do të përfshijë funksionalitete statistikore dhe të elementeve të tjera për të garantuar funksionimin e tij dinamik dhe user-friendly.

SAI-t janë të inkurajuar për të hyrë në bazën e të dhënave dhe për t'iu përgjigjur anketës në http://www.intosai-database.org.mx/.

Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik

Z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara dhe botues i Revistës Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik**,** prezantoi raportin vjetor të revistës. Ai theksoi se Revista mbetet në një pozicion të mirë financiar: Ai ka marrë një opinion tjetër të qartë nga audituesit e tij të jashtëm dhe vazhdon të mbajë rezervat financiare të përshtatshme. Menaxhimi i Revistës është i angazhuar të rishikojë gamën e çështjeve financiare dhe operative të Revistës, si dhe të sigurojë që aktivitetet janë në përputhje me planin strategjik aktual të INTOSAI-t. Ai theksoi se falenderime të sinqerta për rolin e rëndësishëm në dhënien e kontributeve, shkonin për SAI-t e Austrisë, Kanadasë, Tunizisë dhe Venezuelës në koordinimin e përkthimit të Revistës. Koha e stafit të tyre, përkthimi, asistenca dhe mbështetja administrative, bënin të mundur që Revista të publikohej në të pesë gjuhët zyrtare të INTOSAI-t.

Ai gjithashtu njohu mbështetjen e madhe dhënë nga SAI-t anëtare, të cilët paraqisnin artikujt e tyre, çështjet e reja, editorialet dhe pjesë të tjera për publikim në formatin e shkruar dhe në web.

Këto prezantime mundësojnë që Revista të shërbejë si forumi kryesor i INTOSAI-t për shkëmbimin e informacionit dhe burimeve ndërmjet SAI-ve anëtare, duke shprehur moton e INTOSAI-t "Eksperienca e përbashkët në përfitim të të gjithëve".

Z. Dodaro tha se GAO është e angazhuar të vazhdojë mbështetjen ndaj Revistës. Kontributet e saj janë vazhdimisht të vlerësuara dhe se ai priste që angazhimi i stafit ndaj Revistës, të mbetej i pandryshuar.

Në ato fusha ku Revista mund të haste kosto më të larta, menaxhimi i Revistës mendonte se mund të ngrinte një numër strategjish kursim-kostosh për shpenzimet e ngritura. Për shembull, bordi i Revistës kohët e fundit, vendosi të mos printonte më kopje për SAI-t e paantarësuar; këta lexues tanimë mund të lexonin revistën elektronikisht. Megjithatë, Revista do të vazhdojë të shpërndajë

kopje të printuara për SAI-t. Për t'i shërbyer më mirë të anëtarësuarve, Revista do të anketonte anëtarët e saj për të përcaktuar nevojat aktuale.

Z.Dodaro tha se Revista mirëpret sugjerimet e komunitetit të INTOSAI-t mbi çështje si reduktimin më të madh të kostove apo përmirësimin e dobishmërisë së Revistës ndaj institucioneve anëtare. Revista, nga ana tjetër, do të ruajë nivelin e mbikëqyrjes buxhetore dhe kujdesin për të siguruar veprimin efektiv dhe eficient.

Raporti mbi Qëllimin 4: Komiteti për Financat dhe Administatën

Nga Osama Faquih, Kryetar i Komitetit të INTOSAI-t për Financat dhe Administratën, raport për përpjekjet dhe aktivitetin e Komitetit që nga Kongresi INCOSAI XX në Afrikën e Jugut.

Siç specifikohet në Planin Strategjik të INTOSAI-t , mandati i Komitetit është që të ndihmojë kryetarin e bordit dhe vetë bordin për të "organizuar dhe qeverisur INTOSAI-n në mënyra që nxisin praktikat ekonomike, efikase dhe efektive të punës, vendimmarrjen në kohë, si dhe praktikat efektive të qeverisjes, duke ruajtur vëmendjen e duhur për autonomi rajonale, të balancuar dhe në respekt të modeleve të ndryshme të SAI-ve anëtare".

Z. Faquih, i cili u zgjodh për një mandat tjetër tre- vjeçar si Kryetar i Komisionit në këtë Kongres, vuri në dukje se Komisioni e kishte ndjekur në mënyrë aktive mandatin e tij përmes takimeve të mbajtura në Uashington, DC., në korrik 2011 dhe në maj 2013, në Londër në Tetor 2012 dhe më së fundi në Pekin pak para INCOSAI XXI.

Përveç kësaj, Komiteti ka përdorur mjetet e teknologjisë në takimet e tij, për të shpërndarë informacionin dhe shkëmbyer pikëpamjet, për të finalizuar dokumentet, si dhe për të formuluar rekomandimet tek Bordi Drejtues. Që nga INCOSAI XX, puna e Komisionit është fokusuar kryesisht në mandatet e Task Forcës së tij të Parashikimit Financiar, themeluar në Uashington në korrik 2011, e cila është e udhëhequr nga SAI i Norvegjisë dhe ne mandadit e Taks Forcës së Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Huaj, e cila është e udhëhequr nga ana e INTOSAI-t, nga SAI i Arabisë Saudite. Përveç kësaj, Komiteti ka themeluar një Task Forcë të re në vitin 2012, për të zhvilluar Planin Strategjik 2017-2022 të INTOSAI-t , e cila udhëhiqet nga SAI i Shteteve të Bashkuara (GAO).

Si rezultat i punës së Task Forcës për Parashikimin Financiar, Komisioni ka ndërmarrë gjithashtu një qasje më të fuqishme për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve financiare dhe buxhetore të INTOSAI-t , duke ofruar nëntë rezoluta te

Bordi Drejtues, mbi mënyrat për të siguruar sigurinë e vazhdueshme financiare të INTOSAI-t. Task Forca për Parashikimin Financiar ka përfunduar punën e saj dhe e ka bërë raportin e saj përfundimtar në INCOSAI XXI, duke u shpërbërë si grupim.

Rezultatet e punës së Komitetit janë të përshkruara më poshtë:

Task Forca për Parashikimin Financiar

Qëllimi i grupit të punës ishte të analizonte dhe të paraqiste propozime në lidhje me çështjet financiare të INTOSAI-t, përmirësime në planifikimin strategjik, si dhe mekanizmat për trajtimin e çështjeve të reja.

Çështjet financiare

Bazuar në një studim të drejtorëve të INTOSAI-t dhe në një analizë të praktikave aktuale dhe dokumenteve të INTOSAI-t, Task Forca ka zhvilluar gjetje dhe mundësi në lidhje me çështjet financiare të INTOSAI-it . Nëntë opsione janë identifikuar dhe pas miratimit nga FAC, ato u prezantuan në Bordin Drejtues, duke kërkuar që Sekretariati i Përgjithshëm të autorizohet për të zhvilluar rregulla të reja, kur është e nevojshme, dhe për të miratuar opsionet në parim, sipas rastit. Bordi i miratoi të nëntë rezolutat, të cilat janë si më poshtë:

1. Marrja e masave të nevojshme për të lejuar financime të jashtme, që do të përdoren për projekte të veçanta dhe që nuk kërkojnë që për financime të tilla të zbatohet rregulli i përqindjes fikse, sipas shpërndarjes së kuotave të anëtarësisë, aktualisht të kërkuara nga Rregullat Financiare të INTOSAI-t.

2. Duke pasur parasysh se kontributet në natyrë janë burimi kryesor i burimeve të INTOSAI-t inkurajojmë anëtarët për të bërë më shumë kontribute vullnetare e në natyrë për aktivitetet e INTOSAI-t. Gjithashtu , inkurajojmë anëtarët për të siguruar kontribute financiare shtesë, që nuk duhet të aplikohen sipas shpërndarjen përqindje fikse, nga kuotizacionet e kërkuara nga Rregullat Financiare të INTOSAI-t.

3. Qartëso pritshmëritë për organizimin e takimeve. Bëjë më të lehtë (p.sh, pa ngjarje sociale të kërkuara) për më shumë SAI që të marrin pjesë dhe të jenë të gatshëm për të mikpritur takime dhe ngjarje të INTOSAI-t.

4. Rishiko strukturën aktuale të vlerësimit të Anëtarësisë dhe këshilloje Bordin Drejtues në lidhje me rezultatet e këtij shqyrtimi.

5. Inkurajo SAI-t për të dhënë fonde vullnetarisht, mbi kontributin e tyre të vlerësuar aktualisht, derisa një strukturë e rishikuar të hartohet.

6. Kujtoju SAI-ve anëtare për rregullin ekzistues, të përmbajtur në Manualin e INTOSAI-t për Komitetet, duke ju kërkuar atyre që të njoftojnë Sekretariatin e Përgjithshëm për financimin e jashtëm të pranuar dhe për të inkurajuar SAI-t që të respektojnë këtë rregull. Kjo do të sigurojë që INTOSAI të ketë një pamje të plotë të të gjitha financimeve të jashtme.

7. Rishiko procesin e anëtarësimit të asociuar, për të parë nëse më shumë organizata dhe institucione mund të inkurajohen për të aplikuar për anëtarësimin e asociuar në INTOSAI. Kontaktet me organizata dhe institucione potenciale për anëtare të asociuara të INTOSAI-t mund të jenë pjesë e procesit të skanimit të jashtëm për Planin Strategjik të ardhshëm 2017-2022).

8. Përgatit një plan financimi të nivelit të lartë, së bashku me Planin e ri Strategjik, për të ilustruar modalitetet e financimit, të nevojshme për të përmbushur objektivat dhe përparësitë e planit.

9. Rishiko mundësinë e inicimit të procesit të çertifikimit për audituesit. Për Rezolutat 1 dhe 2, ndryshimi i kërkuar tek Rregullat Financiare të INTOSAI-t i është dorëzuar për shqyrtim Bordit Drejtues dhe është miratuar nga ai; në mënyrë të ngjashme, një ndryshim në gjuhë tek Manuali i Komiteteve i INTOSAI-t, në lidhje me Rezolutën 3, është miratuar nga Bordi Drejtues.

Bordi Drejtues i ka miratuar të nëntë rezolutat dhe raportin e FAC

Planifikimi Strategjik

Si rezultat i punës së Task Forcës, Bordi Drejtues i INTOSAI-t ngriti një Task Forcë për Planifikimin Strategjik në mbledhjen e tij të 63-të në Chengdu, Kinë, në tetor 2012. Task Forca e Parashikimit Financiar financiare i kerkoi Task Forcës së Planifikimit Strategjik për t'u marrë me çështjet e mëposhtme në punën e saj

■ Rishiko dokumentin e Marsit 2012 "Procesi i Planifikimit Strategjik të INTOSAI-t : Vështrim i përgjithshëm, Parimet udhëzuese dhe Gurët Kilometrikë të zhvillimit të INTOSAI-t", përgatitur nga Task Forca e Parashikimit Financiar, si dhe referoju Manualit të Planifikimit Strategjik të Nismës për Zhvillimin (IDI) të INTOSAI-t.

■ Kërko të dhëna nga të gjitha grupet rajonale të punës, nga komitetet, task forcat, si dhe nga veprimtarë të jashtëm, në fillim të procesit të planifikimit.

■ Kërko sistematikisht të dhëna nga grupet e jashtëm të rëndësishëm të interesit, të tilla si Kombet e Bashkuara, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), nga partnerët e bashkëpunimit INTOSAI - donatorë, dhe nga të tjerë.

■ Vendosi në një linjë përparësitë dhe objektivat e planit me burimet dhe aktivitetet e nevojshme, si dhe përgatit një dokument rishikimi afatmesëm për Kongresin INCOSAI XXIII.

■ Përcakto qartë përgjegjësitë për procesin e planit strategjik.

■ Zhvillo një kornize të matjes së performancës, me tregues të qartë për të matur dhe drejtuar performancën e INTOSAI-t përkundrejt planit strategjik.

■ Siguro kohë të mjaftueshme për të gjitha palët e interesuara për të komentuar dhe për të dhënë propozime për planin strategjik.

Parashikimi Financiar

Bordi Drejtues në Takimin e tij të 63-të miratoi raportin e Task Forcës për Parashikimin Financiar "Mekanizmi Përgjigjës i INTOSAI-t për Çështje në Zhvillim", në vitin 2012. Raporti zhvilloi një kornizë, në mënyrë që INTOSAI të mund t'i përgjigjet në mënyrë efektive çështjeve të rëndësishme në zhvillim, që ndikojnë në punën dhe / ose reputacionin e INTOSAI-t dhe të anëtarëve të tij. Mekanizmi përfshin mënyra për të identifikuar, analizuar dhe për t'u përgjigjur çështjeve në zhvillim.

Bashkëpunimi i Donatorëve

Bashkëpunimi i donatorëve ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme që nga Kongresi INCOSAI XX. Nga 15 donatorë që nënshkruan me INTOSAI-n një memorandum mirëkuptimi në tetor të vitit 2009, numri i donatorëve nënshkrues është rritur në 21. Parimet udhëzuese të bashkëpunimit janë të bazuara

Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU) ndërmjet INTOSAI-t dhe Komunitetit të Donatorëve

Në tetor 2013, INTOSAI dhe disa donator nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për të rritur dhe forcuar mbështetjen ndaj Komunitetit të SAI-ve. Memorandumi i Mirëkuptimit ka nënshkrimin e 21 firmëtarëve:

1. Banka Afrikane për Zhvillim
2. Banka Aziatike për Zhvillim
3. Agjencia Australiane për Zhvillimin Ndërkombëtar
4. Agjencia Austriake për Zhvillim
5. Ministria e Jashtme e Belgjikës
6. Kanadaja
7. Komisioni Europian
8. Ministria e Jashtme e Francës
9. Aleanca GAVI
10. Fondi Global për luftën kundër SIDA-s, Turbekulozit dhe Malaries
11. Banka Inter-Amerikane për Zhvillim
12. Fondi Ndërkombëtar Monetar
13. Irlanda
14. Banka Islamike për Zhvillim
15. Ministria e Jashtme e Hollandës
16. Agjencia Norvegjeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit
17. Zvicra
18. Suedia
19. Britania
20. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
21. Banka Botërore

në zhvillim të qëndrueshëm të kapaciteteve dhe në efektivitetin e ndihmës - në veçanti, në zhvillimin e planeve strategjike të vendit përkatës, duke qenë se donatorët respektojnë udhëheqjen e SAI-t të vendit përkatës, si dhe koordinimin e përmirësuar. Komiteti drejtues i Bashkëpunimit me Donatorët është mbështetur nga një sekretariat të organizuar në kuadër të Nismës për Zhvillim (IDI) të INTOSAI-t.

Përparimi i rëndësishëm deri më sot përfshin sa vijon:

■ Pas vlerësimit të SAI-ve në vitin 2010 (krijimit të bazës së të dhënave), tetë projekte me përparësi rajonale dhe globale për INTOSAI-n u identifikuan për përkrahje. Të gjitha projektet janë përfunduar ose janë në fazat e tyre të fundit. Këto përfshijnë programe të planifikimit strategjik për CREFIAF, CAROSAI dhe SAI-t në CREFIAF, programi e E-zhvillimit të menaxhimit për SAI-t e AFROSAI; si dhe programet globale për zbatimin ISSAI-ve dhe përgatitjen e udhëzimeve të Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve (CBC) . Në vitin 2011, u lansua një Thirrje Globale për Propozime për projekte zhvillimore të ndërtimit të kapaciteteve që kanë nevojë për financim shtesë. Deri në qershor 2012, janë pranuar 55 propozime. Donatorët kanë shprehur interes në mbështetjen e 44 prej tyre, ndërsa 18propozime ishin në zhvillim e sipër apo kishin fonde të miratuara. 23 propozime të tjetëra janë subjekt i diskutimit dhe interesit të vazhdueshëm. Këto projekte kanë përfshirë projekte për ngritjen e kapaciteteve për SAI të veçanta, projekte të zbatimit të një mjet menaxhimi të auditimit për SAI të veçanta, si dhe një numër propozimesh rajonale.

■ Një thirrje e dytë Globale për propozime është bërë në tetor 2013. Ky do të jetë një proces me dy faza. Ai do të fillojë me një koncept notë të aplikuesit dhe një buxhet të parashikuar, dhe në qoftë se, interesi i donatorëve është i pranishëm, do të zbatohet faza e dytë e zhvillimit të mëtejshëm të një propozimi gjithëpërfshirës.

■ Në janar 2012, u prezantua një Bazë të dhënash të zhvillimit të kapaciteteve për një SAI. Mjeti ngrihet mbi bazën e mëparshme të të dhënave të CBC-se e zgjeron fushën e bazës (direktorisë) origjinale, duke përfshirë donatorin, ofruesit

e tjerë të shërbimit, si dhe mbështetjen e rishikimit mes kolegëve (peer review). Baza e të dhënave tani përmban 283 projekte në vazhdim, të planifikuara dhe të propozuara. SAI-t e Suedisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Meksikës sigurojnëudhëzime dhe mbikëqyrje.

■ Në vitin 2011, nisën përpjekjet për krijimin e një Kornize Globale për Matjen e Performancës së SAI-t. Nën kujdesin e Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve, korniza ka njohur përparim të ndjeshëm. Ajo është mbështetur nga anëtarë të INTOSAI-t, nga donatorë, nga palë të interesuara nga INTOSAI, donatorët dhe komuniti i shoqërisë civile. Korniza Globale për Matjen e Performancës së SAI-t do të jetë subjekt i konsultimeve të gjera dhe i një projekti pilot në vitin 2015, dhe pastaj do të paraqitet për miratim në Kongresin INCOSAI XXII në vitin 2016.

■ Në tetor 2012 u prezantua një Dokument tre-vjeçar Programi i Bashkëpunimit INTOSAI –Donatorë (2013-2015), me tema të detajuara, aktivitete dhe piketa për programin. Ai mund të shihet në http://www.idi.no/artikkel.aspx?MId1=129&AId=857.

■ Iniciativa të tjera të Bashkëpunimit me Donatorët përfshijnë:

❍një dokumentim të përfshirjes së SAI-ve në industritë nxjerrëse,

❍zhvillimin e një kursi trajnimi për stafin e donatorëve që punon me SAI-t,

❍zhvillimin e një komuniteti praktikash të SAI-ve që ofrojnë projekte,

❍Nisjen e një Vrojtimi Global 2013 të IDI-t, i cili do të masë progresin në mbështjetjen e Zhvillimit të Kapaciteteve të SAI-ve, duke rifreskuar të dhënat kryesore të vlerësimit të SAI-ve të vitit 2010, si dhe prezantimi i një Buletini tremujor të Bashkëpunimit INTOSAI –Donatorë.

Takimi i ardhshëm i Komitetit Drejtues të Bashkëpunimit INTOSAI- Donatorë do të mbahet në Paris, më 16-17 shtator 2014.

Task Forca për Planifikimin Strategjik

E themeluar në Chengdu, Kinë, në vitin 2012, në takimin e 63-të të Bordit Drejtues, kjo Task Forcë drejtohet nga SAI i Shteteve të Bashkuara. Anëtarësimi përfshin Kryetarin e Bordit Drejtues të INTOSAI-t, të gjithë anëtarët e FAC, Sekretarin e Përgjithshëm, katër Kryetarët e Katër Objektivave themelore të INTOSAI-t , Nismën për Zhvillim (IDI), Revistën e INTOSAI-t, Drejtorin e Planifikimit Strategjik, SAI-n e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe sekretarët e përgjithshëm të shtatë grupeve rajonale të punës. Përveç kësaj, Kryetarët e grupeve rajonale të punës janë të ftuar të marrin pjesë, sipas gjykimit të tyre. Eshtë ftuar po ashtu dhe SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe, si Kryetar i ardhshëm i INTOSAI-t, të marrë pjesë gjatë seancës së planifikimit. Ndryshe nga plani strategjik 2011-2016, Plani Strategjik 2017-2022 do të reflektojë një rishikim të plotë të qëllimeve, nevojave, burimeve dhe aspiratave të INTOSAI-t. Sikurse u përmend më sipër, udhëzimet për Zhvillimin e Planit të ardhshëm Strategjik i kanë rrënjët në punën e Task Forcës për Parashikimin Financiar dhe gjetjet e saj janë të dokumentuara në raportin e saj "Konsideratat për Planin Tjetër Strategjik të INTOSAI-t".

Task Forca planifikon një proces të hapur, që konsideron plotësisht të gjitha pikëpamjet dhe që do të konsultohet me SAI-t anëtare dhe me të gjitha komponentët e INTOSAI-t, për të zhvilluar Planin. Puna do të përfshijë gjithashtu një proces skanimi të gjerë të brendshëm dhe të jashtëm. Dy takime të Task Forcës janë planifikuar në lidhje me Mbledhjen e Bordit Drejtues të INTOSAI-t të vitit 2014 dhe me Simpoziumin OKB / INTOSAI të vitit 2015. Një telekonferencë është planifikuar për 12 shkurt 2014. Për të mbështetur më mirë monitorimin e zbatimit të planit strategjik, procesi i planifikimit do të konsiderojë mundësinë e vendosjes së matësve specifikë të performancës dhe procedurave formale, për monitorimin e e vazhdueshëm të performancës.

INTERNATIONAL ORGANIZATION OF SUPREME AUDIT INSTITUTIONS
ORGANISATION INTERNATIONALE DES INSTITUTIONS SUPÉRIEURES DE CONTRÔLE DES FINANCES PUBLIQUES
INTERNATIONALE ORGANISATION DER OBERSTEN RECHNUNGSKONTROLLBEHÖRDEN
ORGANIZACIÓN INTERNACIONAL DE LAS ENTIDADES FISCALIZADORAS SUPERIORES

المنظمة الدولية للأجهزة العليا للرقابة المالية العامة والمحاسبة

Beijing Declaration

Congress Secretariat, XXI INCOSAI
International Cooperation Department, National Audit Office
No.1 Beiluyuan, Zhanlan Road, Xicheng District, Beijing 100830
China • Chine • China • China
Tel. +86 (10) 6830 1586 • Fax +86 (10) 6833 0958
E-mail: intosai2013@intosai2013.org • World Wide Web: http://www.intosai2013.org

DEKLARATA E PEKINIT

Mbi Promovimin e Qeverisjes së Mirë nga Institucionet Supreme të Auditimit

Parathënie

1. Që prej vitit 1953 Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ka punuar me vitalitet dhe inovacion në përputhje me moton e saj "Eksperienca e Përbashkët na Shërben të Gjithëve", duke përhapur ide dhe standarde kombëtare të auditimit nëpërmjet shkëmbimit të ideve dhe bashkëpunimit në komunitetin ndërkombëtar të auditimit. Në vitin 2013, INTOSAI po feston përvjetorin e 60 të tij.

2. INTOSAI, si një organizatë jo politike, profesionale, e pavarur dhe autonome, ka dhënë mbështetje reciproke, ka nxitur shkëmbimin e ideve, njohurisë dhe eksperiencave, ka vepruar si një zë i njohur i institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) në komunitetin ndërkombëtar dhe ka promovuar vazhdimisht përmirësimin midis SAI-ve anëtarë.

3. INTOSAI ka promovuar qeverisjen e mirë duke mundësuar që SAI-t të ndihmojnë qeveritë përkatëse të përmirësojnë performancën, të rrisin transparencën, të sigurojnë përgjegjshmërinë, të ruajnë besueshmërinë, të luftojnë korrupsionin, të promovojnë besimin e publikut dhe të mbrojnë interesat e qytetarëve të tyre.

4. INTOSAI është – së bashku me Komisionet, Grupet e Punës, Task Force dhe Grupet e Punës Rajonale – forumi botëror për shkëmbimin ndërkombëtar të njohurive në fushën e auditimit të jashtëm qeveritar; është organizata që vendos Standardet e Auditimit në sektorin publik dhe zëri ndërkombëtar i auditimit të jashtëm qeveritar.

5. Arritjet e INTOSAI-t në shkëmbimin e njohurive, vendosjen e standardeve dhe rritjen e statusit të auditimit qeveritar janë të njohura. INTOSAI ka hartuar dhe zbatuar Planin e tij Strategjik të parë, që u aprovua në vitin 2004 në Budapest dhe u përditësua në vitin 2010. Nën udhëzimin e Planit Strategjik,

INTOSAI ka adoptuar kornizën e Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI-ve) dhe ka pasur sukses në projektet e ndërtimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të eksperiencave të orientuara drejt rezultateve në fusha të ndryshme të auditimit në mbarë botën. Gjithashtu ka edhe një axhendë afatgjatë për të qenë vetë një model i qeverisjes së mirë organizative.

6. Në vitin 2011, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara njohu punën e INTOSAI-t dhe anëtarëve të tij me Rezolutën A/Res/66/209 "Promovimi i Eficiencës, Përgjegjshmërisë, Efektivitetit dhe Transparencës në Administrimin Publik duke forcuar SAI-t". Në këtë rezolutë Asambleja e Përgjithshme:

- vërejti me vlerësim punën e INTOSAI-t në promovimin e efiçencës, përgjegjshmërisë, transparencës dhe marrjes dhe përdorimit efiçent dhe efektiv të fondeve publike për të mirën e qytetarëve.

- vlerësoi Deklaratën e Limës dhe të Meksikës dhe inkurajoi anëtarët e INTOSAI-t t'i aplikojnë ato në përputhje me strukturat e tyre kombëtare, me parimet e vendosura në këto deklarata dhe inkurajon shtetet anëtare dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara përkatëse të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin me INTOSAI-n për të promovuar qeverisjen e mirë duke siguruar eficiencë, përgjegjshmëri dhe transparencë nëpërmjet forcimit të SAI-ve.

7. INTOSAI zhvilloi Kongresin e XXI (INCOSAI) në Pekin në vitin 2013, duke rikujtuar zhvillimin e INTOSAI-t në gjashtë dekadat e fundit dhe duke përmbledhur eksperiencën praktike të anëtarëve të tij. INCOSAI njëzëri deklaroi se:

- Në shoqërinë e shekullit të 21të, informacioni dhe globalizimi janë transformuar në një sfidë të madhe, me SAI-t që përballojnë sfida të reja për të përmirësuar qeverisjen kombëtare dhe me INTOSAI-n që përballet me mundësi të reja për të trajtuar tematika globale.

- SAI-t pranojnë se qeverisja kombëtare efektive është kryesore për ruajtjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe progresit social, për përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe ata janë të gatshëm të kontribuojnë në përmbushjen e përgjegjësive të përcaktuara në Deklaratën e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, e cila thotë se:

"Ne nuk do të kursejmë asnjë përpjekje për të liruar shokët tanë burra, gra dhe fëmijë nga kushtet e mjerueshme dhe jo humane të varfërisë ekstreme, në të cilat ndodhen aktualisht më shumë se një miliardë prej tyre. Ne jemi të angazhuar për të bërë të drejtën për zhvillim një realitet për të gjithë dhe për të çliruar tërë racën njerëzore nga mos kamja. Ne vendosim për këtë arsye të krijojmë një mjedis - në nivel kombëtar dhe global - i cili të jetë i favorshëm për zhvillim dhe për eliminimin e varfërisë. Suksesi në përmbushjen e këtyre objektivave varet, inter alia, nga qeverisja e mirë në nivel ndërkombëtar dhe transparenca në sistemet financiare, monetare dhe tregtare ".

- SAI-t mund të ndihmojnë duke rritur transparencën, duke siguruar përgjegjshmërinë, promovuar performancën, dhe duke luftuar korrupsionin dhe kështu të përmirësojnë qeverisjen e mirë kombëtare dhe rrisin paanshmërinë.

- Qëndrueshmëria afatgjatë e politikave financiare është një parakusht i pamohueshëm për qeverisjen e mirë qeveritare. SAI-t, nëpërmjet auditimit të pavarur profesional, mund të ndihmojnë vendimmarrësit të ruajnë qëndrueshmërinë dhe zbatimin e politikave financiare duke rritur transparencën, duke raportuar mbi performancën e financave publike dhe duke nënvizuar risqet e sistemit.

- Në një botë me globalizim intensiv, asnjë vend nuk mund të përmirësojë me sukses qeverisjen kombëtare pa kuptuar se si kjo mund të influencohet nga faktorët e jashtëm. Duke promovuar qeverisjen e mirë në vend, SAI-t duhet t'i dedikohen përmirësimit të qeverisjes globalisht përmes bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përmbushjen e sfidave globale, SAI-t do të vazhdojnë të ndërtojnë forcën e tyre për të ndërmarrë përgjegjësi të përbashkëta, të menaxhojnë risqe të përbashkëta, të ndërmarrin veprime të përbashkëta dhe të

japin një mendim të njohur dhe të respektuar nën patronazhin e INTOSAI-t dhe Grupeve të Punës Rajonale.

- Si një organizatë me përfaqësim të gjerë, një pozicion të pavarur të fortë dhe standarde profesionale të larta, INTOSAI do të vazhdojë të bashkëpunojë me Grupet e Punës Rajonale dhe SAI-t për të vendosur përdorimin e ISSAI-ve në përputhje me kornizat ligjore përkatëse për të promovuar qeverisjen e mirë duke mbetur të pavarur dhe për të rritur performancën.

8. Në këtë sfond Kongresi diskutoi dy çështje me rëndësi globale sipas temave të mëposhtme:

- Tema I: Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare;

- Tema II: Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për Ruajtjen e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Politikave Financiare.

Rezultati i diskutimeve të Kongresit për këto tema ndodhet tek Shtojca I – Marrëveshjet e Pekinit.

9. Për më tepër, Kongresi rishikoi progresin e Planit Strategjik të INTOSAI-t për 2011 – 2016 .

Kreu I: Arritjet dhe Eksperiencat e INTOSAI-t

10. Që prej themelimit të INTOSAI-t në vitin 1953 deri tek Kongresi i XXI në Kinë në vitin 2013, INTOSAI ka pasur zhvillime pozitive të shumëfishta, si edhe ndryshime dhe progres të konsiderueshëm. Në frymën e motos së INTOSAI-t "Eksperienca e Përbashkët na Shërben të Gjithëve", puna e organizatës është bazuar në përkushtimin vullnetar të domosdoshëm dhe kontributin e çdo SAI anëtar. Ky institucion modern, global dhe i strukturuar, i orientuar drejt rezultateve, ka rritur numrin fillestar të anëtarëve nga 34 në 192 anëtarë me të drejta të plota dhe 5 anëtarë të asocuar.

11. Shtatë Grupet e Punë Rajonale të INTOSAI-t – AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, CAROSAI, EUROSAI, OLACEFS dhe PASAI – nënshkruajnë misionin e INTOSAI-t dhe në të njëjtën kohë marrin parasysh diferencat rajonale dhe nevojat heterogjene.

12. Si organe ekzekutuese të punës tematike dhe profesionale të INTOSAI-t, Komisionet, Grupet e Punës dhe Task Force të saj, kanë prekur një varietet të gjerë temash dhe subjektesh.

13. Arritjet mahnitëse të INTOSAI-t përfshijnë Deklaratën e Limës, parimet themeluese të një auditimi të sektorit publik të pavarur, eficient dhe efektiv, hartimin e Planit të parë Strategjik të INTOSAI-t (2005-2010), i cili përcaktoi edhe objektivat strategjikë si, përcaktimin e standarteve, ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin si një organizatë model, Deklaratën e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-ve në 2007, si edhe zhvillimin e kuadrit të ISSAI-ve, të cilët do të ndihmojnë dhe do të rrisin auditimin publik në mbarë botën.

14. Njohja e arritjeve nga Kombet e Bashkuara me rezolutën e Asamblesë të Përgjithshme A/Res/66/209 të vitit 2011 është rezultat logjik i punës së vështirë dhe të suksesshme të INTOSAI-t gjatë viteve të fundit. Kjo e vendos INTOSAI-n – duke përfshirë punën e tij në vendosjen e standardeve dhe në auditimin e sektorit publik - në fokusin e shqetësimeve të komunitetit ndërkombëtar. Institucionet e auditimit të sektorit publik, me karakterin e tyre të pavarur, konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e qeverisjes së mirë. SAI-t tani kanë një mjet efektiv në dorë për të kërkuar që qeveritë kombëtare të njohin dhe zbatojnë parimet bazë të pavarësisë së SAi-ve nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Sukseset konkrete janë raportuar tashmë nga SAI-t e të gjitha rajoneve të INTOSAI-t.

15. Bashkëpunimi i INTOSAI-t me partnerët e jashtëm si për shembull Kombet e Bashkuara dhe me organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, OECD, IPU, IFAC dhe IIA kanë rritur në mënyrë të konsiderueshme reputacionin, dukshmërinë globale dhe vlerësimin si një organizatë profesionale e nivelit të

lartë. Që prej vitit 1970, 22 Simpoziume dhe Seminare të përbashkëta UN – INTOSAI, duke shpërndarë njohuri dhe materiale për trajnime mbi një sërë temash të interesit të lartë në lidhje me auditimin e jashtëm publik.

16. Ngritja e kapaciteteve ka qenë dhe mbetet një nga fushat më të rëndësishme të INTOSAI-t. Kjo fushë përfshin zhvillimin e strukturave të reja për përfitimin e njohurive dhe trajnimin profesional dhe zhvillimin organizativ për SAI-t. Aktualisht ka shumë aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe ndarjen e njohurive në INTOSAI, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe performancës së SAI-ve.

17. INTOSAI ka firmosur një Memorandum Mirëkuptimi me 21 donatorë dhe ka kryer një seri aktivitetesh bashkëpunuese me komunitetin e donatorëve, nëpërmjet të cilave janë arritur qëllimet e përbashkëta të deklaruara, është siguruar zbatimi i Suksesshëm i Kuadrit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t (ISSAI-t) dhe i Udhëzuesve të INTOSAI-t për Qeverisjen e Mirë (INTOSAI GOVs), si edhe është rritur njohja e rëndësisë të SAI-ve dhe të INTOSAI-t në komunitetin e zhvillimit global.

18. Në 60 vitet e fundit, INTOSAI ka përballuar më sukses të madh sfidat e auditimit të sektorit publik dhe është më se i gatshëm dhe i vullnetshëm të vazhdojë në këtë rrugë për vitet në vazhdim me ndihmën dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve. Është i përgatitur të mbajë largpamësinë dhe rëndësinë për sa i përket vizionit dhe misionit të orientuar drejt të ardhmes.

19. Në vitin 2013, INTOSAI feston gjithashtu 50 vjet të Sekretariatit të Përgjithshëm, me seli në Vjenë, tek Gjykata e Auditimit Austriake. Sekretariati i Përgjithshëm ka një rëndësi jetësore për organizatën duke vepruar si nxitës për inovacion, si qendër informacioni dhe si pikë kontakti për anëtarët e INTOSAI-t në gjithë botën dhe për partnerët globalë aktivë.

20. Në dedikim të këtyre arritjeve, organizata ka publikuar librin “60 Vjet INTOSAI/50 Vjet Sekretariati i Përgjithshëm – Transparencë, Përgjegjshmëri, Qeverisje e Mirë në Shërbim të Qytetarëve”.

21. Mbi bazën e një kuptueshmërie të plotë të çështjeve të reja dhe të ndryshimeve të vazhdueshme, si edhe zhvillimeve të shoqërisë së sotshme, INTOSAI do të bëjë të pamundurën për të vazhduar promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë njerëzore.

Kreu II: Promovimi i Qeverisjes së Mirë Kombëtare nga SAI-t

22. Qysh nga fillimi qëllimi kryesor i INTOSAI-t ishte promovimi i qeverisjes së mirë. SAI-t mund të kryejnë mirë këtë detyrë vetëm nëse ata janë të pavarur nga agjencitë që ata auditojnë dhe janë të mbrojtur nga influencat e jashtme të çdo forme. INTOSAI njeh se është e rëndësishme që metodat e auditimit të SAI-ve të bazohen në njohuritë teknike dhe shkencore aktuale dhe që audituesit të kenë kualifikime të përshtatshme profesionale, si edhe integritet moral.

23. Për këto arsye në vitin 1977 INTOSAI aprovoi Deklaratën e Limës dhe me Deklaratën e Meksikës të vitit 2007 vendosi tetë parimet e pavarësisë të auditimit të jashtëm qeveritar në aspektet e tij metodologjike dhe profesionale.

24. Qeveritë dhe qytetarët e të gjitha shteteve kërkojnë promovimin dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë, ekonomisë dhe ambjentit. Si një pjesë e pandashme e qeverisjes kombëtare, auditimi kombëtar kryen funksionet e tij në përputhje me ligjin dhe rregullat dhe jep, në mënyrë objektive, auditim mbikëqyrës, verifikim, vlerësim dhe rekomandime që vendimmarrësit përdorin për të hartuar politika dhe programe vendimmarrjeje. SAI-t duhet të përpiqen të jenë kampionë të së vërtetës, ndershmërisë dhe integritetit në jetën publike. Kur bëjnë këtë, SAI-t do të vazhdojnë të kontribuojnë për të:

- Ruajtur demokracinë dhe shtetin ligjor duke promovuar administrim dhe një qeverisje të ndershme dhe të pastër, duke mbajtur rregull ligjor, duke zbuluar paligjshmërinë, duke frenuar abuzimet me pushtetin nëpërmjet mbikëqyrjes së pushtetit publik. Në disa raste SAI-t janë edhe këshilltarë, duke luajtur një rol konstruktiv nëpërmjet sugjerimeve për përmirësime në sistemin ligjor. SAI-t ndihmojnë në ndërtimin e komunikimit dhe besimit midis sektorit publik dhe

qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bëjnë të mundur që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

- Rritur eficiencën e qeverisë duke mbikëqyrur dhe vlerësuar aktivitetet e qeverisë dhe duke bërë publike mangësitë në qeverisjen dhe kontrollin kombëtar. SAI-t japin një pasqyrim dhe udhëzim të pavarur dhe objektiv për të ndihmuar ndryshimet e dobishme në qeveri dhe në organet publike, si dhe inkurajojnë qeveritë të forcojnë kontrollin. SAI-t gjithashtu promovojnë përdorimin racional të fondeve publike, praktikave të mira dhe krijimit të një qeverisjeje të orientuar drejt performancës.

- Luajtur një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe në parandalimin e mashtrimit si në nivel kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar. Njohuritë e eksperiencat e bazuara të auditimit të SAI-ve, jo vetëm rrisin përgjegjshmërinë, por edhe japin këshilla të vyeshme për iniciativa kundër korrupsionit në të ardhmen, duke përfshirë edhe Axhendën e Zhvillimit Post 2015.

- Ruajtur interesat kombëtare, duke përdorur pozicionin e tyre të pavarur, largpamësinë dhe kapacitetin profesional unik për të dhënë informacion të besueshëm dhe objektiv në kohë, për të zbuluar risqet ndaj veprimtarisë ekonomike dhe shoqërore, si edhe interesave kombëtare.

- Promovuar përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve duke ndihmuar në sigurimin e fondeve publike, si dhe projektet në lidhje kushtet e jetesës së njerëzve janë nën një mbikëqyrje të rreptë dhe arrijnë impaktin e dëshiruar, që përmirëson kushtet e jetesës dhe shanset e barabarta për të gjithë qytetarët duke përfshirë edhe grupet më të dobta.

- Rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke audituar dhe duke publikuar rezultatet e auditimit që ndihmojnë për të ndërgjegjësuar sektorin publik, si dhe inkurajojnë qeveritë dhe organizatat publike të përmbushin përgjegjësitë e tyre për përdorimin dhe ruajtjen e fondeve publike. SAI-t i japin shoqërisë dhe qytetarëve me informacione të verifikuara si janë përmbushur përgjegjësitë nga

organizatat dhe zyrtarët qeveritarë, duke ndihmuar kështu në promovimin e qeverisjes transparente.

Kreu III: Ruajtja e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Financave Publike

25. E thënë gjerësisht, financat publike të qëndrueshme duhet të përmbushin detyrimet e tanishme dhe të ardhme pa trashëguar një borxh të tepërt ndaj brezave të ardhshëm.

26. Qëndrueshmëria e financave publike ka qenë në axhendën e INTOSAI-t për shumë vite me radhë. Në vitin 1991 Komisioni i INTOSAI-t për Borxhin Publik e deklaroi punën e tij dhe në vitin 2007 u njoh si Grup Pune. Në vitin 2008, INTOSAI mori hapa të menjëhershme si përgjigje ndaj krizës financiare: Task Force Globale mbi Krizën Financiare i cili u njoh si Grup Punë në vitin 2013 me emrin Grupi i Punës mbi Modernizimin Financiar dhe Reformën Rregullatore.

27. Shumë është bërë në të shkuarën: një seri Standardesh Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI-t (ISSAI-t 5410 deri në 5450), mbi borxhin publik janë publikuar. Megjithatë, kriza financiare, ekonomike dhe buxhetore sjell për SAI-t sfida të veçanta të cilat, në interes të publikut, mund të adresohen nga SAI-t si pjesë e funksionit të tyre të auditimit.

28. Mësimet që rrodhën nga kriza ekonomike dhe globale e fillimit të shekullit të 21të, kanë theksuar rëndësinë strategjike të qeverive në mbajtjen e financave publike të shëndosha për të krijuar kushtet për rritjen ekonomike, punësim dhe mirëqenie sociale. Nëpërmjet auditimeve të pavarura dhe të shëndosha, SAI-t kontribuojnë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare në çdo vend. Duke pranuar mandatin e çdo SAI anëtar të INTOSAI-t për të përcaktuar qasjen e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, aspektet për t'u marrë në konsideratë kur trajtohet çështja e qëndrueshmërisë financiare janë:

- Forcimi i auditimeve të deklaratave financiare qeveritare me qëllim vendosjen dhe përmirësimin e kornizës financiare institucionale dhe standardeve

të raportimit financiare, në mënyrë që të paraqiten me drejtësi peformanca financiare dhe pozicioni i qeverisë.

- Përmirësimi i auditimeve publike të performances, në mënyrë që të inkurajohet mbështetja fiskale afat mesme dhe afat gjatë, si dhe mirë qeverisja.

- Përforcimi i auditimeve për borxhin publik, duke marrë në konsideratë angazhimet e drejtpërdrejta, sikurse edhe detyrimet dhe kontigjentët financiarë me objektivin për të identifikuar çështjet dhe riskun në menaxhim, si dhe zhvillimet e pritshme të borxhit dhe deficitit financiar.

- Të zhvillohet aftësia për të audituar fazat e planifikimit të financave publike, me qëllim që të nxisë ekzekutivin dhe legjislativin të vlerësojë projektet afat mesme dhe afat gjatë, të cilët janë të lidhura me zhvillimet e mundshme e cikleve të ekonomisë, borxhit, programeve publike, si dhe angazhime të tjera si siguria sociale, pensionet, arsimi dhe kujdesi publik, sikundër edhe rastet si fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimaterike dhe shoku financiar.

- Vlerësimi i planifikimit të qeverisë lidhur me ekonominë, financat publike dhe borxhin publik, do të bëjë të mundur identifikimin e risqeve të mundshme, si dhe do të jepen rekomandime konstruktive.

- Të rritet numri i auditimeve të përputhshmërisë me rregullat fiskale, rregulloret financiare dhe standardet e pranuara, si dhe zbatimin e gjithë proceseve buxhetore të qeverisë. Objektivi është sigurimi i përgjegjshmërisë gjatë fazave të planifikimit, zbatimit, zhvillimit dhe rezultatit të arritur. Mbi të gjitha, kontrollet e brendshme efektive duhet të përmirësohen në lidhje me sistemin e menaxhimit të riskut.

- Adoptimin e politikave për zhvillimin e financave publike. SAI-t duhet të vazhdojnë të kryejnë auditime përtej saktësisë, efektivitetit dhe mbështetjes së politikave publike, në mënyrë që të promovohet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale në çdo shtet.

29.U njoh rëndësia e Deklaratës së Limës dhe Meksikos, rezolutës së OKB-së për të forcuar pavarësinë e SAI-ve, si dhe u theksua vlera e mbështetjes së SAI-ve për njëri-tjetrin nëpërmjet INTOSAI-t dhe Grupeve Rajonale. U njoh gjithashtu, se kur duhet të kryhen auditime në lidhje me qëndrueshmërinë e politikave financiare, duhet të rritet roli i mandatit të SAI-t.

Kreu IV: Arritja e Mirëqeverisjes Globale Një qëllim i përbashkët

30. Përmes mbështetjes dhe përpjekjeve proaktive, INTOSAI ka arritur të zhvillohet me sukses, në një organizatë autonome, të pavarur, profesionale dhe jo politike, të njohur si zëri i institucioneve supreme të auditimit (SAI-t) në komunitetin ndërkombëtar dhe promovimin e vazhdueshëm të përmirësimeve mes anëtarëve të ndryshëm.

31. Reputacioni ndërkombëtar i INTOSAI-t është themeluar mbi një gur kilometrik dhe arritjet përfshijnë kryesisht:

- Njohjen e rëndësisë së SAI-ve nga Kombet e Bashkuara
- Përcaktimin e një kuadri gjithëpërfshirës të standardeve profesionale bazuar në procesin e duhur
- Ngritja e një marrëdhënie produktive me donatorët ndërkombëtarë, për të promovuar ngritjen e kapaciteteve në SAI-t anëtare
- Ndërtimin e një rrjeti efektiv global për përhapjen e njohurive dhe praktikave më të mira
- Bashkëpunimin e mëtejshëm me organizatat ndërkombëtare dhe mbi-kombëtare
- Përmirësimin e vazhdueshëm të marrëveshjeve qeveritare përmes statusit të organizatës ndërkombëtare model

32. INTOSAI ka pranuar se në një botë ku sfidat janë bërë globale, ka nevojë që komuniteti ndërkombëtar i SAI-ve të bëhet bashkimi për dhënien e përgjigjeve kolektive, për të pasur rezultate pozitive për të gjithë. Historia e INTOSAI-t dhe themelet e fuqishme në bashkëpunimin ndërkombëtar mes SAI-ve do të thotë që është pozicionuar për të luajtur një rol në zhvillimin dhe shpërndarjen e zgjidhjeve për sfidat e rëndësishme të kohëve të fundit dhe çështjet tematike si për shembull çekuilibri global i ekonomisë, krizat kombëtare të borxhit, sistemi monetar ndërkombëtar, reformat, kriza ekologjike, siguria botërore financiare dhe axhendat e anti korrupsionit.

33. INTOSAI dhe SAI-t kanë një kapacitet të provuar dhe kanë si detyrë të çojnë përpara mirë qeverisjen kombëtare dhe globale në përputhje me mandat e tyre respektive dhe kuadrin ligjor. Kongresi i inkurajon SAI-t:

- **Të pranojnë përgjegjësitë e përbashkëta:** Puna audituese e SAI-ve për angazhimet ndërkombëtare të qeverisë, si ato që kanë të bëjnë me ndryshimet klimaterike, rishikimi i barrierave tregtare, ruajtja e stabilitetit financiar, si dhe duke luftuar korrupsionin dhe pastrimin e parave, mund të shërbejnë për të inkurajuar përputhshmërinë e plotë me këto detyrime. INTOSAI gjithashtu i mundëson SAI-ve pjesëmarrjen në bashkëpunime ndërkombëtare, si dhe të luajnë një rol në marrëdhënie ndërkombëtare si zbatimi i disiplinave financiare, zbulimin e riskut ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe ruajtja e stabilitetit të ekonomisë botërore.

- **Të menaxhojnë risqet e përbashkëta:** SAI-t kanë një rol të vazhdueshëm në promovimin e identifikimit të riskut. INTOSAI do të vazhdojë ta përqendrojë vëmendjen në kërkimet, çështjet madhore globale dhe fenomenet rajonale, si dhe t'i mundësojë SAI-ve udhëzues efektive si referencë për përgjigje.

- **Të ndërmarrin veprime të përbashkëta:** SAI-t inkurajohen të vazhdojnë kryerjen e auditimeve të përbashkëta dhe paralele, në mënyrë që të trajtojnë sfidat e përbashkëta dhe çështjet si ndryshimet klimaterike, ndotja rajonale dhe kriza financiare. SAI-t inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete të tilla qeveritare si vlerësimi i programeve sociale, përfshirja e organizatave

ndërkombëtare dhe rajonale në auditimin e jashtëm, nxiten të kryejnë auditimet e performancës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale, për të përmirësuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe performancën. INTOSAI do të vazhdojë të punojë me organizata të tjera ndërkombëtare dhe shtetet sovrane për të fuqizuar bashkëpunimin në auditimin ndërkombëtar, si dhe për të identifikuar zgjidhjet më të mira për çështjet rajonale dhe globale.

- **Të flasin në një zë të përbashkët:** SAI-t dhe INTOSAI do të vazhdojnë të përshtaten me ndryshimet e kohëve që po jetojmë, si dhe do të përshtatin pozitivisht masa efektive për të bashkëpunuar me organizatat multilaterale si OKB-ja, Banka Botërore, OSBE-ja dhe G20-ta, për të ndjekur aktivitete multilaterale, për të rritur auditimin ndërkombëtar dhe standardet e kontabilitetit për sektorin publik, për të përcaktuar treguesit kryesorë kombëtare për vlerësimin e progresit social, për të marrë pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes globale, si dhe të ketë një zë unanim dhe të pavarur mbi çështjet me tema ndërkombëtare dhe rajonale në komunitetin ndërkombëtarë.

Kreu V: Konkluzionet e Kongresit INCOSAI XXI

34. Kongresi diskutoi shumë çështje, por u ra dakord që duhet një parim udhëzues për filozofinë e INTOSAI-t, i cili duhet të jetë i orientuar nga e ardhmja. Organizata pati mundësinë të kontribuonte në axhendat globale dhe rajonale, duke u bazuar në ekspertizën dhe eksperiencën e mirë qeverisjes dhe auditimin e sektorit publik.

35. Kongresi vuri re punën e shkëlqyer të kryer nga të gjitha komisionet, grupet e punës dhe task forcat. U shpreh mirënjohje e thellë për të gjithë kryesuesit që kishin kryer detyrat e tyre, si dhe u përshëndetën ata që morën përgjegjësi të reja.

36. Fundi i vitit 2013 shënon gjysmën e parë të Planit Strategjik të dytë të INTOSAI-t, që mbulon periudhën 2011-2016. Gjatë diskutimeve të INCOSAI-t të XXI, anëtarët e INTOSAI-t shprehën kënaqësinë në lidhje me progresin e

organizatës. Si pasojë, vendet anëtare arritën në përfundimet e mëposhtme dhe ranë dakord:

Standardet profesionale

- **Mirëpret** rritjen e kuadrit të standardeve (ISSAI) nga rishikimi i parimeve themelore të auditimit dhe standardeve të tjera (Aneksi II), si dhe një fokusim më i madh mbi nevojat e audituesve dhe përdoruesit që përfaqësojnë këto arritje.

- **Miraton** mandatin e rishikuar të Komitetit dhe vendosmërinë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme që do të mundësojnë garanci të mjaftueshme, si dhe që kuadri dhe procesi i Standardeve Profesionale të INTOSAI-t të ruhen dhe zhvillohen në të ardhmen.

Ngritja e kapaciteteve

- **Përkrah** aftësinë e Organizatës për mbështetjen e dhënë për SAI-et në ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe në veçanti progresi i bërë nga Sekretariatet Rajonale dhe Bashkëpunimi Donator i INTOSAI-t;

- **Vlerëson** kontributin e vazhdueshëm të IDI-t për INTOSAI-n në mbështetjen e anëtarëve të tij, në përpjekjet e tyre për të rritur përformancën në punë, pavarësinë dhe profesionalizmin; dhe

- **Miraton** planin strategjik të IDI-t, 2014-2018, si dhe mandatin e tij të rishikuar që reflekton rolin e tij, duke punuar paralel me synimet e INTOSAI-t.

Shkëmbimi i njohurive

- **Lavdëron** punën që thekson vlerat dhe përfitimet e SAI-t: duke ndryshuar jetën e qytetarëve (Aneksi III) dhe kriterin që SAI-t duhet të angazhohen në punën e përgjegjshmërisë për auditimin e ndihmave lidhur me katastrofat (Aneksi II);

- **Inkurajon** SAI-t të zhvillojnë aftësitë për t'iu përgjigjur sfidave të kohëve të fundit, ekonomike dhe fiskale, në shumë pjesë të botës, për shembull duke rritur ose zgjeruar auditimin e tyre në mbikëqyrjen dhe mekanizmat rregullator; dhe Inkurajon anëtarët të aplikojnë strategjitë dhe udhëzuesit e INTOSAI-t, si dhe të përdorin në mënyrë aktive mjetet e hartuara dhe zhvilluara për këtë qëllim.

INTOSAI – Një organizatë model

- **Mirëpret** Planin për Zhvillimin Strategjik të INTOSAI-t për periudhën 2017-2022, si dhe për trajtimin e nevojave të Organizatës në të ardhmen;

- **Thekson** krijimin e një komiteti mbikëqyrës mbi çështjen e emergjencave (Aneksi IV).

Çështje të tjera

SAI-t anëtare të Kongresit:

- **Ranë dakort** që INTOSAI duhet të ketë një rol në Axhendën e Zhvillimit Post 2015, të Kombeve të Bashkuara.

37. Për më tepër, Kongresi u bëri thirrje anëtarëve të Organizatës për:

- **T'i dhënë prioritet** miratimit dhe zbatimit të kuadrit të standardeve, si dhe Rezolutës së OKB-së, dhe i kërkon donatorëve dhe partnerëve të tjerë të zhvillimit t'i japin atij të njëjtin status;

- **T'iu përgjigjur** pozitivisht thirrjes së dytë globale, për propozimet e botuara nga Bashkëpunimi Donator i INTOSAI-t;

- **Të promovuar** në mënyrë aktive vlerat dhe përfitimet e SAI-ve;

- **Të krijuar** mundësinë për të kontribuar plotësisht në përcaktimin e të ardhmes së Organizatës;

- **Të marrë në konsideratë** kontributin e mëtejshëm për burimet në dispozicion të Organizatës.

38. Në përfundim të INCOSAI XXI, Organizata dhe anëtarët e tij konfirmuan edhe një herë ambicien për ta shndërruar INTOSAI-n në një organizatë model, që paraqet programe cilësore, të cilat përforcohen nga standardet profesionale dhe nga idetë humanitare.

Kongresi mbyllet me vlerësimet për Kinën dhe pritshmëritë për Emiratet e Bashkuara Arabe

Me përfundimin e INCOSAI XXI, në 26 tetor 2013, delegatët unanimisht shprehën mirënjohjen dhe vlerësimet për z.Liu Jiayi dhe stafin e Zyrës Kombëtar të Auditimit të Kinës, të cilët punuan pareshtur për të siguruar suksesin e kongresit. Planifikimi dhe menaxhimi i çdo aspekti të kongresit ishte i shkëlqyer – ashtu si ishte dhe mikpritja e ngrohtë dhe e bukur e ofruar nga moment i mbërritjes së delegatëve në Pekin – dhe që kontribuoi shumë që ky Kongres të kthehej në një ngjarje të shënuar në historinë e INCOSAI-t.

Me kënaqësi, Institucioni Shtetëror i Emirateve të Bashkuara Arabe, (UAE), pret zhvillimin e kongresit të ardhshëm të INTOSAI-t në 2016.

Dr.Harib Al Amimi, President i Institucionit Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe, mirëpret anëtarët e INTOSAI-t në INCOSAI XXII në 2016

Shkëlqesia e Tij, Dr. Harib Al Amimi, President i SAI-t dhe zv.Kryetar i INTOSAI-t, shprehu formalisht ftesën gjatë fjalës së tij në INCOSAI XXI. Ftesa u pranua unanimisht nga INCOSAI XXI në sesionin plenar të mbylljes.

Në fjalën e tij për kongresin, Dr. Al Amimi theksoi se qeveria e UAE i kushton një rëndësi shumë të madhe INCOSAI XXII dhe do të mbështesë plotësisht ngjarjen me fonde, burime njerëzore, salla organizimi dhe siguri. Ai shtoi se

UAE do të përpiqet shumë për ta bërë atë ngjarje sa më shumë të jetë e mundur të suksesshme, të paharrueshme dhe të vlefshme.

Detaje të tjera për 2016, si përzgjedhja e tematikave dhe relatorëve, do të vendoset në takimin e Bordit Drejtues në nëntor 2014. Në 2015, ky SAI do të presë takimin vjetor të bordit drejtues.

Mbi takimin e 65 të Bordit Drejtues

Takimi 65 i Bordit Drejtues të INTOSAI-t në 26 Tetor 2013, në Pekin, Kinë.
Nga e majta në të djathtë, Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, Austria; Liu Jiayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës, Kinë; Zhou Weipei, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Ndërkombëtar, Kina; Harib Al Amimi, President i Institucionit Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe;
Salem Alfalasi, Asisten Auditues, Emiratet e Bashkuara Arabe.

I mbledhur pas INCOSAI-t XXI në Pekin, Bordi Drejtues miratoi si vijon:

1. Një bord të ri drejtues që përfshin 18 anëtarë, Austria, Bahamas, Kina, Ekuadori, Egjipti, Gaboni, Japonia, Meksika, Zelanda e Re, Norvegjia, Pakistani, Polonia, Federata Ruse, Arabia Saudite, Afrika e Jugut, Venezuela, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe SH.B.A.

2. Zgjodhi Osama Jafar Faquih, President i Byrosë së Përgjithshme të Auditimit të Arabisë Saudite, si zv.kryetarin e dytë të Bordit Drejtues dhe Kryetar të Komitetit të Financave dhe Administrimit – ky komitet për tre vitet e ardhshme do të përfshijë, Kinën, Ekuadorin, Norvegjinë, Arabinë Saudite dhe SH.B.A. Austria dhe Afrika e Jugut do të jenë anëtarë ex-officio.

3. Zgjodhi SAI-n e Japonisë, Shteteve të Bashkuara dhe Federatës Ruse, si koordinatorët e Qëllimeve 1, 2, dhe 3; Monika Gonzalez-Koss, nga SAI i Austrisë, u rizgjodh si Drejtore e Planifikimit Strategjik.

KLSH

INTOSAI

REVISTA NDËRKOMBËTARE E AUDITIMIT TË JASHTËM PUBLIK

INTOSAI

ISBN : 978-9928-159-20-5